

LE MONDE. *shqip* diplomatique

100 LEKË, 1 EURO / MUJORE / 24 FAQE

Nr. 791 / Viti i 67 i botimit / Mars 2020

KORONAVIRUSI NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Pasojat e pritshme të një virusi të papritur

Në rritje e sipër, numri i të kontaminuarëve në Ballkanin Perëndimor është tashmë treshifor. Megjithë reagimin e shpejtë dhe masat e ashpra qeveritare, gjendja dhe sidomos pasojat mbeten të paparashikueshme, në shtetet me një sistem të rrënuar shëndetësor dhe me ekonomi të brishta, për shkak të tranzicionit tridhjetëvjeçar të politikave neoliberale.

NGA ARDIT RADA

Ndryshe nga Italia ose Spanja ku u prit shpërthimi i kontaminimeve, qeveritë e shteteve ballkanike reaguesh shpejt në ndërmarrjen e masave të ashpra në luftën ndaj koronavirusit. Epidemia filloi të përhapej nga fundi i muajit shkurt, me rastin e parë në Kroaci.

Sot numri i të infektuarve është treshifor në Ballkanin Perëndimor, ku kufijtë janë mbyllur, banorët janë izoluar pjesërisht dhe ku shumica e shteteve kanë shpallur gjendjen e emergjencës ose të jashtëzakonshme.

Në shtetet e pazhvilluara me një numër të lartë të shtetasve në mërgatë, konsiderohet se virusi është "importuar" para së gjithash nga

mërgimtarët, të ardhur për arsye të ndryshme në shtetet e tyre të prejardhjes.

Por, rreziku troket ende në derë dhe parashikimet për të ardhmen e afërt janë të zymta, duke marrë parasysh gjendjen e mjerueshme në të cilën gjenden sistemet shëndetësore, të degraduara nga tridhjetë vjet tranzicioni neoliberal, shkurtimeve buxhetore dhe eksodit masiv të punonjësve të paguar pak apo të papunë për një kohë të gjatë në vendet e tyre.

Dhe sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, mungesave të sistemit shëndetësor i janë bashkuar edhe kufizimet që vendosi Bashkimi Evropian për ta vështirësuar luftën me COVID-19.



©Nensi Bogdani

Në prag të humbjes së shpresës për ndihmë, kryeparlamentarët e Ballkanit Perëndimor i janë drejtuar me një letër Presidentit të PE David Sassoli dhe Presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Në letër kërkohet që vendet e Ballkanit të përjashtohen nga vendimi për të kufizuar eksportin e paisjeve mjekësore nga Bashkimi Evropian dhe të kenë akses në prokurimin e përbashkët me BE-në për këto mjete kaq të rëndësishme. "Të lejohen që një pjesë e fondeve të Programit IPA II dhe të gjitha

fondet e tjera në dispozicion nga burimet e BE-së të përdoren për të luftuar pandeminë COVID-19" – thuhet ndër të tjera në letërën zyrtare.


Por përtej shpresës nga institucionet e Brukselit, Shqipëria ka qenë e para që ka hedhur sytë nga Ankara zyrtare. Edhe pse Brukseli akordoi 50 milionë euro për Tiranën, kjo nuk ka mjaftuar. "Mbështetja e Turqisë do të jetë e pakursyer në luftën me armikun e padukshëm", thoshte Kryeministri Edi Rama, para se të publikonte.. / Faqe 2

PREJ NGA VIJNË KORONAVIRUSËT?

Ekologjia si mjet kundër pandemive

Edhe në shekullin XXI, metodat e vjetra duken për autoritetet kineze mënyra më e mirë për të luftuar epideminë e koronavirusit. Lëvizjet e qindra miliona njerëzve janë kufizuar. A ka ardhur koha ta analizojmë shkakun e shfaqeve të njëpasnjëshme të pandemive me një ritëm gjithnjë e më të shpejtë?

NGA SONIA SHAH*



Është një pangolin? Një lakuriq? Ose edhe një gjarpër, siç thuhet, para se të demantohej? Kush do të jetë i pari që do ta inkriminojë kafshën e egër që ka sjellur këtë koronavirus, të quajtur zyrtarisht Covid-19. Prej këtij

virusi janë kurthuar tani qindra miliona njerëz, të futur në karantinë ose të kontrolluar nga masat sanitare në Kinë dhe vende të tjera. Sigurisht se është e domosdoshme që të zbulohet ky mister, por duke spekuluar nuk mund të kuptojmë

që ndjeshmëria jonë në rritje ndaj pandemive e ka burimin më thellë: shkatërrimi i përshpejtuar i habitateve.

Që nga viti 1940, qindra mikroba patogenë janë shfaqur ose rishfaqur në zona ku në disa raste nuk kishin ekzistuar kurrë më parë. Ky është rasti me 'HIV'-in, 'Ebola'-n në Afrikën Perëndimore dhe 'Zika'-n në kontinentin amerikan. Shumë prej tyre (60%) kanë origjinë shtazore. Disa të tjerë nga kafshët shtëpiake ose blegtorisë, por shumica e tyre (më shumë se dy të tretat) nga kafshët e egra.

Por, kafshët nuk kanë faj. Edhe pse në shumë artikuj me fotografi thuhet se pikënisja e epidemive shkatërruese l gjindet tek fauna e egër, nuk është e vërtetë se këto... / Faqe 5

Koment / Faqe 11

Fushata
anti-Sanders
e mediave
mainstream

Vështrim

I rrëzuar, por jo i mposhtur

Nga Besnik Pula / Faqe 3

Më 26 mars, përderisa vendi po përballej me përhapjen e virusit Covid-19, Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash miratoi një mocion mosbesimi ndaj Qeverisë së drejtuar nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV). Mocioni ishte inicuar nga deputetët e partnerit

Editorial

Kurti, një rënie false anti-imperialiste

Nga Zgjim Hyseni / Faqe 4

Imperializmi është dominimi politik i ardhur si pasojë e proceseve të akumulimit të kapitalit. Fillon me mbivlerën e prodhuar në punishte, deri tek kapitali financiar. Kur ky proces i gjatë e gradual akumulimi mberin pikun, shfrytëzimi shndërrohet në

Opinion

Mos u dashuro me pushtetin as nga karantina

Nga Leart Kola / Faqe 9

Që në krye të herës, dua të theksoj, që nuk besoj në teoritë konspirative, në të cilat "fatkeqësitë" prodhohen nga njerëz okultë për t'i kontrolluar popullatat. Kapitalizmi konsumist na ka mësuar,

Intervista

Isa Qosja: Nuk di të mendoj "komercialisht"

Nga Ag Apolloni / Faqe 21-22

Mbi filmin që duhet të shërbejë si emancipim shpirtëror i njeriut. Konceptin "njeriu dhe natyra" si "huazim", apo përvjedhje të vetes. Ndërlidhjen e kinematografisë me letërsinë, idealitetin përmes simbolikës dhe ritualin neorealit si shprehje e gjendjes së

Një Brexit për asgjë?

NGA SERGE HALIMI

Vendimi britanik për t'u larguar nga Bashkimi Evropian vjen shumë vonë. Mund të ketë qenë një lajm i shkëlqyeshëm për Bashkimin Evropian, largimi i një shteti i cili e ka mishëruar njëkohësisht tregtinë e lirë që nga revolucioni industrial të shekullit XVIII, aleancën me Uashingtonin që nga “marrëdhënia speciale” anglo-amerikane të vulosur nga Winston Churchill, financarizimin që prej kur ekonomia dhe politika britanike janë të mbizotëruara nga City i Londrës, neoliberalizmin e egër që nga koha e Margaret Thatcher.

Një rikujtim gjithashtu se nuk jemi në burg. Meqenëse disa shtete munden ende të anëtarësohen, të tjerët edhe munden të jenë në gjendje të dalin një ditë. Në këtë drejtim, të paktën, të zgjedhurit britanikë, pasi vendnumëruan për një kohë të gjatë, respektuan verdiktin e popullit të tyre. Ky lloj leksioni demokratik nuk është i padobishëm në këto kohëra që po përjetojmë.

Sidoqoftë, mund të zhgënjehen ata që shpresojnë se largimi i Mbretërisë së Bashkuar do ta çlirojë Bashkimin Evropian, sidomos Gjermaninë, nga barrat e saj liberale dhe atlantiste.

«Komuniteti atlantik kolosal nën varësinë dhe drejtimin amerikan», nga i cili druhej gjenerali de Gaulle në vitin 1963, nuk ka më nevojë për britanikët për ta diktuar ligjin e tij në Kontinentin e Vjetër.

Sidomos që nga viti 2004, kur Bashkimi Evropian mirëpriti një duzinë shtetesh të reja, shumica e të cilëve sapo kishin dërguar ushtarët në Irak me kërkesë të Uashingtonit. Disa nga këta anëtarë të rinj që nuk janë ende në gjendje të flasin dy fjalë në një gjuhë tjetër përveç anglishtes. Më me dëshirë flasin fjalë të shkruara nga Departamenti Amerikan i Shtetit.

Ekgagjerim? Jo edhe aq, duke gjykuar nga reagimi i evropianëve ndaj “Planit të Paqes” izraelito-palestinez, të paraqitur më 28 janar, në Shtëpinë e Bardhë.

Menjëherë pas formulimit të propozimeve që e shkelin ligjin ndërkombëtar - aneksimin izraelit të Jeruzalemit dhe të Luginës së Jordanit, kolonizimin e Bregut Perëndimor - Uashingtoni përgatiti elementët e një komunikate që aletatët e tij duhej të përsëritnin për ta brohoritur entuziazmin e tyre. “*Falenderojmë Presidentin Trump për përpjekjet e tij për ta çuar përpara këtë konflikt shumë të vjetër*”; “*Një propozim serioz, realist dhe qëllimshëm*”; “*Shpresojmë që falë këtij vizioni, ky konflikt mund të gjejë zgjidhje*.”

Por, duke krahasuar këto “rekoman-dime” amerikane me reagimet e kancelarive perëndimore pas shpalljes së Planit, Le Figaro vërejtë «*shumë ngjashmëri në gjuhë, duke e theksuar - nëse do të kishte akoma nevojë - ndikimin e Uashingtonit në aleatët e tij*».

Si zakonisht, Britania e Madhe u tregua një nga më të shkathtët. Por disa shtete - të cilat mbeten anëtare të Bashkimit Evropian - garuan midis tyre për ta marrë rolin e pagallit të Shtëpisë së Bardhë. Dhe reagimi i Parisit befasoi. Vërtetë Franca nuk e “falenderoi Presidentin Trump”, por ajo... «përshëndeti përpjekjet e Presidentit Trump» !

A duhet të përfundojmë se sido që të jetë, pavarësia e Bashkimit Evropian nuk do të ndodhë, me ose pa Londrën?

KORONAVIRUSI NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Pasojat e pritshme të një virusi të papritur

Në rritje e sipër, numri i të kontaminuarëve në Ballkanin Perëndimor është tashmë treshifor. Megjithë reagimin e shpejtë dhe masat e ashpra qeveritare, gjendja dhe sidomos pasojat mbeten të paparashikueshme, në shtetet me një sistem të rrënuar shëndetësor dhe me ekonomi të brishta, për shkak të tranzicionit tridhjetëvjeçar të politikave neoliberale.

NGA ARDIT RADA

Ndryshe nga Italia ose Spanja ku u prit shpërthimi i kontaminimeve, qeveritë e shteteve ballkanike reagueshpejt në ndërmarrjen e masave të ashpra në luftën ndaj koronavirusit. Epidemia filloi të përhapej nga fundi i muajit shkurt, me rastin e parë në Kroaci.

Sot numri i të infektuarve është treshifror në Ballkanin Perëndimor, ku kufijtë janë mbyllur, banorët janë izoluar pjesërisht dhe ku shumica e shteteve kanë shpallur gjendjen e emergjencës ose të jashtëzakonshme.

Në shtetet e pazhvilluara me një numër të lartë të shtetasve në mërgatë, konsiderohet se virusi është “importuar” para së gjithash nga mërgimtarët, të ardhur për arsye të ndryshme në shtetet e tyre të prejardhjes.

Por, rreziku troket ende në derë dhe parashikimet për të ardhmen e afërt janë të zymta, duke marrë parasysh gjendjen e mjerueshme në të cilën gjenden sistemet shëndetësore, të degraduara nga tridhjetë vjet tranzicioni neoliberal, shkurtimeve buxhetore dhe eksodit masiv të punonjësve të paguar pak apo të papunë për një kohë të gjatë në vendet e tyre.

Dhe sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, mungesave të sistemit shëndetësor i janë bashkuar edhe kufizimet që vendosi Bashkimi Evropian për ta vështirësuar luftën me COVID-19.

Në prag të humbjes së shpresës për ndihmë, kryeparlamentarët e Ballkanit Perëndimor i janë drejtuar me një letër Presidentit të PE David Sassoli dhe Presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Në letër kërkohet që vendet e Ballkanit të përjashtohen nga vendimi për të kufizuar eksportin e paisjeve mjekësore nga Bashkimi Evropian dhe të kenë akses në prokurimin e përbashkët me BE-në për këto mjetet kaq të rëndësishme. “Të lejohen që një pjesë e fondeve të Programit IPA II dhe të gjitha fondet e tjera në dispozicion nga burimet e BE-së të përdoren për të luftuar pandeminë COVID-19” – thuhet ndër të tjera në letrën zyrtare.

Por përtej shpresës nga institucionet e Brukselit, Shqipëria ka qenë e para që ka hedhur sytë nga Ankara zyrtare. Edhe pse Brukseli akordoi 50 milionë euro për Tiranën, kjo nuk ka mjaftuar. “Mbështetja e Turqisë do të jetë e pakursyer në luftën me armikun e padukshëm”, thoshte Kryeministri Edi Rama, para se të publikonte fotot e një avioni shqiptar që ngarkohej në Turqi me ndihma dhe pajisje për stafin mjekësor. Më pas, një tjetër lajm mbërriti tekta Turqia i vuri Shqipërisë në dispozicion dhjetëra autoambulanca, lajm ky që sërish u dha nga Rama për shqiptarët.

I pyetur për Kinën, kryeministri i Shqipërisë u tregua i prerë mbrëmjen e së enjtes, 27 mars. Ai tha se nuk mund t'i kërkohej ndihmë një vendi tek i cili i gjithë bota ka çuar kërkesat e saj.

Ndryshe nga Shqipëria, Aleksandër Vuçiq dhe Serbia e kanë sulmuar ashpër Bashkimin Evropian. I zhgënjyer, presidenti serb tha se solidariteti i madh evropian është vetëm “një përrallë e shkruar”. Në këto kushte, vijoi Vuçiq, ai i ka shkruar një letër “mikut dhe vëllait” të tij të dashur, presidentit kinez, Xi Jinping, si i vetmi person dhe lider i të vetmit vend që mund të ndihmojë Serbinë.

Virusi që ka gjujzëzuar botën dha efekt krejt të rrallë në Kosovë, ku qeveria u rrëzua nga Kuvendi zyrtarisht për një lojë deklarata në lidhje me gjendjen e jashtëzakonshme. Edhe pse rastet janë në shtim dita-ditës, vendi u përball me krizën politike, pas mocionit ndaj qeverisë Kurti. Mbyllja e kufijve nuk ishte e mjaftueshme për të dhënë siguri. Ndërkohë që një e treta e shtetasve të Kosovës jetojnë jashtë vendit dhe nëse gjejnë mënyrë kthimi të organizuar nga shteti, sërish do t'u duhet të përballen me karantinën e detyrueshme.

Vendet e Ballkanit Perëndimor, e kanë lidhur prej së paku 30 vitesh mbijetësen e tyre me adhurimin ndaj Perëndimit dhe “nënshtrimin” pa kushte. Sot kur është e qartë se masat e marra nuk mjaftojnë dhe se Bashkimi



©Nensi Bogdani

MEGJITHË SHQETËSIMIN PARËSOR PËR SHËNDETIN, SYTË PO KTHEHEN EDHE NGA PASOJAT EKONOMIKE QË DO TË SHKAKTOJ PANDEMIA. NË SHTETET E DEZINDUSTRIALIZUARA TË BALLKANIT PERËNDIMOR, TREGTIA DHE SIDOMOS TURIZMI MBETEN MOTORËT KRYESORË TË EKONOMISË, SIDOMOS NË SHQIPËRI, MAL TË ZI OSE KROACI

Evropian mund të japë para, por jo pajisje, rrugët alternative nga lindja po konsiderohen çdo ditë e më tepër. Mbase diçka normale, ku bëhet fjalë për jetët e mijëra njerëzve. Sa për politikat gjeo-strategjike, ato me gjasë do të ndryshojnë pas kësaj lufte, që as në ëndrrat më të këqija nuk e kishte imagjinuar ndonjë banor i Tokës.

Megjithë shqetësimin parësor për shëndetin, sytë po kthehen edhe nga pasojat ekonomike që do të shkaktoj pandemia. Në shtetet e dezindustrializuara të Ballkanit Perëndimor, tregtia dhe sidomos turizmi mbeten motorët kryesorë të ekonomisë, sidomos në Shqipëri, Mal të zi ose Kroaci.

Në prag të fillimit të sezonit, shifrat flasin për 3% më pak të hyra se vitin e kaluar, pa llogaritur ndikimin që do ta ketë goditja e Italisë nga koronavirusi. Parashikimet e organizmave ndërkombëtare thonë se pasojat e përhapjes së COVID-19 do të ulin rritjen ekonomike të Shqipërisë, e cila sipas institucioneve financiare parashikohet të zbrësë në 2%. Para

situatës së tërmetit të nëntorit 2049 parashikimi për rritjen ekonomike për vitin 2020 ishte 4,1%, ndërkohë që pas tërmetit rritja e parashikuar zbriti në 3,4%.

Sot, shumë biznese janë mbyllur, shumë pak prej tyre po punojnë me kapacitete minimale. Konsumatorët kanë frenuar konsumin, përveç blerjeve të domosdoshme ushqimore. Ndërmarrjet eksportuese, pasi u goditën nga Italia, partneri kryesor tregtar i Shqipërisë, tashmë kanë probleme me vazhdimin e prodhimit për shkak të mosardhjes në punë të punonjësve.

Në një komunikatë zyrtare kryeministri i Shqipërisë njoftoi, se qeveria vë në dispozicion të situatës 370 milionë dollarë. Nga kjo shumë 25 milionë janë për shëndetësinë, për të përballuar rritjen e pritshme të numrit të të infektuarve; 100 milionë për kompanitë që nuk mund të paguajnë të punësuarit e tyre; 65 milionë për shtresat në nevojë dhe ata që nuk mund të punojnë për shkak të urdhrat për vetëizolim.

Si pasojë e përhapjes së pandemisë, rënia e remitenave nga mërgata priten të ndikojnë drejtpërdrejtë në stabilitetin social dhe parashikimet buxhetore të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Por pavarësisht planit për ta shpëtuar biznesin nga falimentimi, ka ende skepticizëm. Në daljet e tyre mediatike drejtues të sindikatave apo forumeve ekonomike shprehen se ‘pake-ta e luftës’ duhet vlerësuar, por është e pamjaftueshme.

Teksa e ardhmja për shëndetin e qytetarëve mbetet e panjohur, e sigurt është që kriza e koronavirusit do ta fusë ekonominë në një territor të pashkelur më parë, me gjasë më keq sesa një krizë.

RËNIA E QEVERISË KURTI

I rrëzuar, por jo i mposhtur

Mosgatishmëria e Kurtit për t'iu nënshtruar diktatit të Shtëpisë së Bardhë dhe kërcënimeve të partnerit të saj qeverisë mund të përshkruhen si kryeneçësi dhe deri dikund mund të jetë e tillë. Por, nga ana tjetër duket qartë se populli i Kosovës gradualisht po heq dorë nga stili dhe kultura politike që e kanë karakterizuar vendin përgjatë dy dekadave të fundit.

NGA BESNIK PULA

Më 26 mars, përderisa vendi po përballej me përhapjen e virusit Covid-19, Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash miratoi një mocion mosbesimi ndaj Qeverisë së drejtuar nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje (LVV). Mocioni ishte inicuar nga deputetët e partnerit qeverisë të Kurtit, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me kërkesë direkte të kryetarit të saj Isa Mustafa. Qeveria Kurti ra pas një periudhe të shkurtër 50 ditore në pushtet.

Ndonëse shkaku imediat për mocionin ishte shkarkimi nga Kurti i Ministrit të Brendshëm Agim Veliu nga radhët e LDK-së, hendeku politik midis Kurtit dhe LDK-së ka kohë që ishte thelluar shkaku i tarifës mbi mallrat me prejardhje nga Serbia. Kjo tarifë ishte vendosur nga qeveria e kaluar e Ramush Haradinajt, si kundërpërgjigje ndaj fushatës së vazhdueshme ndërkombëtare të Beogradit për të penguar anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare si UNESCO dhe Interpol, dhe për nxitjen e shteteve që tashmë e kanë njohur Kosovën si të pavarur për tërheqjen e njohjeve. Tarifa asokohe nuk ishte mirëpritur nga Bashkimi Evropian (BE), aleatët evropianë të Kosovës si Britania, Franca e Gjermania, e as nga administrata e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA).

Ndonëse gjatë kohës sa ishin në opozitë, Kurti dhe Mustafa kishin zhvilluar një bashkëpunim konstruktiv, si dhe gjatë fushatave përkatëse zgjedhore të vjeshtës 2019 kishin bërë të njohur interesimin e tyre për të bashkëqeverisur pas zgjedhjeve, procesi që rezultoi më pas dëshmoi se besimi midis dy partnerëve qeverisë nuk ishte edhe aq i thellë e as solid. Formimi i qeverisë zgjati me muaj të tërë, shkaku i mosmarrëveshjeve, por edhe protagonishtë të zëshëm brenda LDK-së – në veçanti ish-ministrit Veliu – që kundërshtonin hapur hyrjen në koalicion me Kurtin dhe LVV-në.

Veliu qysh herët u paraqit si një “spoiler” i koalicionit dhe futja e tij në përbërje të qeverisë ishte pak sa i papritur. Veliu nuk ishte kandidat në zgjedhjet nacionale, por anëtar kryesie në LDK dhe gëzon një bazë të fuqishme të mbështetjes në Podujevë, një komunë që konsiderohet “bastion” tradicional i kësaj partie, ku ai ishte kryetar komune. Kundërshtia e Velit gjatë periudhës së negociatave të koalicionit, por edhe mosnëgjurimi i Mustafës për ta shkatërruar koalicionin shkaku i tij, janë dëshmi e autoritetit politik që Veliu gëzon brenda LDK-së. Ajo po ashtu tregon për prioritetin e dhënë nga Mustafa dhe kryesia e LDK-së për mbrojtjen

e strukturave lokale dhe figurave përfaqësuese të tyre në zonat ku LDK qëndron relativisht mirë. Kujtojmë se LDK kishte shënuar sukses të konsideruar në zgjedhjet lokale të 2017-ës, që dëshmon për traditën e saj organizative në këtë nivel. Megjithatë, për zgjedhjet nacionale, LDK kishte konkurrar me një kandidat pa lidhje me strukturat lokale, deputeten e popullarizuar Vjosa Osmani. Për shumë vëzhgues, Osmani ishte arsyeja e suksesit relativ të LDK-së në zgjedhjet nacionale të 2019-ës. Osmani, nga pozita e saj si kryetare e Kuvendit (pozitë që ajo ka nxënë në bazë të ujdisë me LVV-në), kundërshtoi fuqishëm mocionin anti-qeveritar. Për një pjesë të mbështetësve të LDK-së, simpatizantë të Osmanit, vendimi i kreut të LDK-së për rrëzimin e qeverisë Kurti, sidomos në gjendje pandemie, ka qenë i gabuar, në mos edhe revoltues.

Por, loja politike në Kosovë është më e ndërlikuar se kaq. Faktor tjetër destabilizues në koalicionin e brishtë LV-LDK ka qenë presidenti Hashim Thaçi. Ndonëse kushtetuta e Kosovës parasheh një president ceremonial, Thaçi ka faktorizuar veten si bashkëbiseduesi kryesor i presidentit serb Aleksandar Vuçiq, në negociatat, herë formale, herë gjysëm-formale e herë jo-formale midis Kosovës dhe Serbisë. Deklaratat e Thaçit gjatë vitit 2018, se një marrëveshje me Serbinë duhet të mbështetet mbi një shkëmbim teritorësh midis Kosovës dhe Serbisë, kanë skandalizuar gjithë skenën politike në Kosovë dhe kanë qenë ndoshta motivi kryesor i përfirimit të LVV-së dhe LDK-së gjatë kohës në opozitë.

Përveç se është bashkëbiseduesi i preferuar i Vuçiqit, Thaçi është po ashtu partneri i preferuar i SHBA-ve dhe i emisarit të posaçëm të presidentit Donald Trump, Richard Grenell në procesin e negociatave, negociata këto që tashmë janë zhvendosur nga korniza e institucioneve të BE-së në hollet e Shtëpisë së Bardhë. Grenell ka qenë ai që është treguar jashtëzakonisht këmbëngulës për heqjen e tarifës ndaj mallrave serbe, duke instrumentalizuar proponentë dhe aleatë të administratës Trump, përfshirë edhe të birin e presidentit, Donald Trump Jr., për të lansuar publikisht kërcënime për pasojat e rënda ndaj Kosovës, nëse tarifa nuk hiqet menjëherë dhe pa kushte. Presioni i Grenell ishte drejtuar edhe ndaj LDK-së dhe personalisht Mustafës, aq sa Mustafa kishte deklaruar se pranon telefonata të përditshme nga Grenell. Ndërkohë që Kurti kishte refuzuar këtë kërkesë, duke këmbëngulur në mbajtjen e premtimit të tij elektoral, se tarifa do të hiqet



Kurti u rrëzua,
por nuk u
mposht dhe nuk
duket se ai dhe
partia e tij do të
bëhen faktorë të
anashkalueshëm
në skenën
politike
kosovare,
sado që këtë
ta dëshironin
Thaçi, Mustafa,
apo edhe Grenell

gradualisht dhe vetëm me vendosje të reciprocitetit tregtar dhe në këmbim të garancave se Serbia do ta ndalë fushatën e ç'njohjeve.

Presioni i Grenell përveç se ndryshoi menjëherë qëndrimin e Mustafës (i cili fillimisht ishte dakorduar me pozicionin elektoral të Kurtit), i dha edhe municion të mjaftueshëm atij dhe pjesës tjetër të opozitës që të fillojnë ta akuzojnë për antiamerikanizëm Kurtin dhe partinë e tij. Kështu, mospajtimi për tarifën u bë arsyeja formale e mocionit të mosbesimit ndaj Kurtit, ndaj edhe shumë vëzhgues, të brendshëm dhe ndërkombëtarë, përshkruajtën rrëzimin e Kurtit si rezultat i presionit amerikan.

Presioni amerikan është faktor i pamohueshëm që kontribuoi në prishjen e koalicionit në qeverinë Kurti dhe në destabilizimin politik të vendit në një situatë krize të precedent të pandemisë Covid-19 që nuk kursen as Kosovën. Mirëpo presioni amerikan njëkohësisht nuk ishte faktori përcaktues i këtij fati. Zhvillimet nxorën në pah një sërë gjërash. E para, u vu në pah brishtësia e koalicionit LVV-LDK dhe shkalla e mosbesimit midis dy këtyre subjekteve dhe proponentëve politikë të saj. Ky koalicion qëndronte mbi balanse shumë delikate dhe nuk u desht shumë për t'i nxjerr proponentët e saj nga salla e përbashkët qeveritare drejtistikave në kuvend, emisione televizive e rrjete sociale, për të zbrazë goditje të pamëshirshme mbi njëri-tjetrin.

E dyta, dolën në sipërfaqe përçarjet e thella brenda LDK-së. Mustafa ka ndërmarrë një risk shumë të madh me veprimin kundër qeverisë Kurti, meqë për hir të mbrojtjes së figurës së fuqishme lokale, por të padëshmuar në nivel nacional Veliu, përbuzi politikisht figurën e popullarizuar në nivel nacional Osmanit. Ndonëse një përçarje e LDK-së nuk duket në pah (shumica e deputetëve të LDK-së u rreshtuan me kryetarin e saj), ruajtja e disiplinës së brendshme mund të jetë bërë në dëm të perspektivës elektorale të kësaj partie. Sondazhet tashmë tregojnë se Mustafa është ndër figurat më pak të pëlqyera në Kosovë dhe është i pamendueshëm suksesi nacional i një partie që përfaqësohet publikisht me figura lokale dhe të paformuara, por ambicioze, si Veliu.

E treta, Kurti dëshmoi këmbëngulësinë në mbajtjen e kursit politik që kishte proklamuar gjatë zgjedhjeve. Ndonëse kjo këmbëngulësi i kushtoi me acarimin e marrëdhënieve

me administratën Trump dhe përfundimisht me prishjen me partnerin e saj qeverisë, ai mbetet figurë popullore në Kosovë. Nuk ka dyshim se po të mbaheshin zgjedhjet sot, ai dhe LVV sërisht do të dilte partia e parë, në mos me një marginë edhe më të lartë se që kishin më tetor 2019. Mosgatishmëria e Kurtit për t'iu nënshtruar diktatit të Shtëpisë së Bardhë dhe kërcënimeve të partnerit të saj qeverisë mund të përshkruhen si kryeneçësi dhe deri dikund mund të jetë e tillë. Por, nga ana tjetër duket qartë se populli i Kosovës gradualisht po heq dorë nga stili dhe kultura politike që kanë karakterizuar dy dekadat e fundit këtë vend. Kjo kulturë e vjetër politike bazohet, në një anë, në mbajtjen e pushtetit përmes dhunës, korrupsionit dhe klientelizmit lokal e familjar, dhe në anën tjetër në nënshtrimin e pakontestuar ndaj “kërkesave” nga faktorë të fuqishëm diplomatikë. Përvoja e hidhur e viteve të fundit të kosovarëve, me premtime të shkelura nga faktorë si BE-ja, po edhe shembulli që dha Kurti me një qeverisje relativisht efektive dhe profesionale (sidomos në raport me krizën e pandemisë), hapin një kapitull tjetër në politikën kosovare. Kurti u rrëzua, por nuk u mposht dhe nuk duket se ai dhe partia e tij do të bëhen faktorë të anashkalueshëm në skenën politike kosovare, sado që këtë ta dëshironin Thaçi, Mustafa, apo edhe Grenell. Në ditët dhe muajt në vijim, Kosova i është hedhur një fati të mjegullt, të paqartë e të rrezikshëm kushtetues, politik, ekonomik e të shëndetit publik. Por, në afat të mesëm e të gjatë, Kosova vetëm mund të shpresojë se Kurti – me qasjen, nëse jo me bindjet apo edhe stilin e tij – do të fillojë të shërbejë si një model për një gjeneratë të re liderësh edhe në partitë e tjera kosovare.

(Autori është profesor-asistent i shkencave politike në Virginia Tech, SHBA)

RËNIA E QEVERISË KURTI

Kurti, një rënie false anti-imperialiste

Kryeministri Kurti nuk e duronte dot që në marrëveshjen historike me Serbinë të shkonte pas presidentit Thaçi, një armik i përbetuar i tij. Dhe bëri çfarë di të bëjë më së miri. Shkarkoi ministrin e partnerit qeverisë me reputacionin më të ulët, për ta inskenuar kështu një komplot të të korruptuarëve.

NGA ZGJIM HYSENI

Imperializmi është dominimi politik i ardhur si pasojë e proceseve të akumulimit të kapitalit. Fillon me mbivlerën e prodhuar në punishte, deri tek kapitali financiar. Kur ky proces i gjatë e gradual akumulimi mberrin pikun, shfrytëzimi shndërrohet në dhunë e pushtim. Sasia shndërrohet në cilësi thuhej dikur...

Kosova e vogël ka zënë të bëhet fusha ku shpërfaqet plasartja e Perëndimit si Pax Americana. Kosova, sikur Ballkani është nën hegjemoninë ekonomike të Gjermanisë. Përveç që jemi treg, po bëhemi gjithnjë e më shumë furnizues për fuqinë punëtorë të munguar gjermane. Shumë profesione: nga marangozi, tek punonjësi i administratës, nga inxhinieri tek mjeku e infermieri, përgatiten e shkollohen, për të nisur punë atje. Gjermania i gëzon e i shfrytëzon ata me zero kosto. Politika e saj, madje shtyn drejt profesioneve që i duhen ekonomisë gjermane. Kemi edhe universitete në shërbim të tregut gjerman.

Në anën tjetër, Ballkani fatkeqësisht vazhdon të mbetet ende çështje e sigurisë. Ky fakt i i bën Shtetet e Bashkuara faktorin vendimtar në të gjitha vendet përveç Serbisë. Kujtojeni Maqedoninë dhe rolin vendimtar amerikan në rrëzimin e Gruevskit nga pushteti,

zhvillim ky që mundësoi marrëveshjen për emrin e Maqedonisë Veriore. Mali i Zi është e njëjta histori. Pas disa tentimeve direkte të Rusisë, anëtarësimi në NATO i tij i ka mbyllur mundësitë ndikimeve tjera. Në Kosovë si askund tjetër vjen në shprehje roli përfundimtar e përmbarues amerikan në secilin proces politik. Kjo sigurisht, duke pasur parasysh edhe historikun e bombardimeve të NATO-së, që për shqiptarët e Kosovës ishte shpëtim nga zhbërja katastrofale.

Një ditë para mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë Kurti e kemi parë publikisht dhe hapur këtë luftë influencash. Gjermania dhe Franca i dërguan demarsh kryetarit të LDK-së për ta tërhequr mocionin, kurse Shtetet e Bashkuara e mbështeten atë hapur dhe prerë.

Por, diçka thelbësore na mungon deri tash. Cili ishte shkaku i mocionit të mosbesimit? Ky shkak lidhet me dialogun Kosovë-Serbi dhe një marrëveshje përfundimtare të paqes midis dy vendeve. Këtu na duhet një parantezë. Një marrëveshje e paqes midis Kosovës dhe Serbisë, mund t'i duhet Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, ose ndonjë fuqie tjetër, por, mbi të gjitha kjo i duhet popujve tanë. Imperializmi do të vallëzojë këndëjpari për sa kohë mbajmë pa nevojë konflikte të stisura. Qasja e politikës



Kurti hoqi dorë nga të gjitha parimet e politikat e tij, nga kritika për mënyrën e shtetndërtimit të Kosovës, deri tek taksa progresive. Asgjë të tillë nuk kishte programi qeverisë që u miratua pak dita para rrëzimit. Qytetarët nuk e kanë humbur një qeveri të majtë apo transformuese. Për më tepër, ai u rrëzua nga çështja që as nuk e kishte problematizuar në fushatë

kosovare karshi dialogut ka qenë e papërgjegjshme dhe dritëshkurtër. Ajo është karakterizuar nga instrumentalizimi i skajshëm i çështjes për sulme ndaj njëri – tjetrit. Kështu, ajo është maksimalizuar për rezultate elektorale, por secilit fitues i është kthyer bumerang pastaj.

Kryeministri Kurti u zgjodh nga votuesit në zgjedhjet e jashtëzakonshme pas dorëheqjes së pararendësit të tij për të njejtën arsye: dialogu me Serbinë. Por, fushata e Kurtit karshi kësaj çështjeje ishte eskapist. Në vend se të mendonte

mbi një strategji dhe projekt për dialogun me Serbinë, ai u tha atyre se ky nuk është fare problem. Gjithë çfarë na duhet është lufta ndaj korrupsionit. Kurti hoqi dorë nga të gjitha parimet e politikat e tij, nga kritika për mënyrën e shtetndërtimit të Kosovës, deri tek taksa progresive. Asgjë të tillë nuk kishte programi qeverisë që u miratua pak dita para rrëzimit. Qytetarët nuk e kanë humbur një qeveri të majtë apo transformuese. Për më tepër, u rrëzua nga çështja që as nuk e kishte problematizuar në fushatë.

Si shpjegohet kjo? Kemi të bëjmë me një tension midis dy superegosh. E para është populliste, përgjigje ndaj disponimit popullor. Kjo përkthehet në qendëzimin e luftës antikorruption. Korrupsioni nuk shpjegohet më përmes kritikës ndaj modelit neoliberal si lubrifikant i tij, por si luftë kundër hajnave që lidhen me një parti ose dy parti, që vijnë nga krahina të caktuara e që u përkasin niveleve të ndryshme kulturore. Në anën tjetër, kemi një komunikim me superegosh që dikton një rol historik të udhëzuar nga shkenca. Ky është subjekti që ontologjizohet nga garanca e domosdoshmërisë historike.

Kurti nuk kishte një plan as projekt për dialogun me Serbinë. Kjo temë, atij i ka shërbyer vetëm për të shpallur tradhtarë. Madje edhe u bë gati, i dha të gjitha indikacionet se do të bëhet pjesë e procesit, bashkë me amerikanët. Por, rrugës doli një pengesë. Lidhjet e Presidentit Hashim Thaçit me diplomacinë

amerikanë ishin të forta, sa për të mos ia lënë atij rolin kryesor. Kështu, kryeministri nuk e duronte dot që në marrëveshjen historike me Serbinë të shkonte pas presidentit Thaçi, një armik i përbetuar i tij. Dhe bëri çfarë di të bëjë më së miri. Shkarkoi ministrin e partnerit qeverisë me reputacionin më të ulët, për ta inskenuar kështu një komplot të të korruptuarëve. Sigurisht se komplotit do t'i printe Presidenti Hashim Thaçi, që po e kërkon shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme për ta dërguar ushtrinë në veriun e vendit të banuar me serbë, për të nxitur konflikt atje. Gjithë kjo për ta përligjur ndarjen e vendit.

Kjo është historia e Kosovës së vogël në një kohë erërash nga të gjitha anët. Ortodoksia bolshevike është bërë popullizëm i dobët post-modern, kurse anti-imperializmi në një luftë pa mëshirë për t'u bërë aleati i vetëm i perandorisë.

Popullizmi dhe e majta e vjetër nuk janë përgjigje ndaj imperializmit. Kjo sepse ato bazohen tek koncepti i sovranitetit, kurse burimet maksimale të tij janë ato të shtetit-komb. Çfarë na duhet është përgjigja internacionaliste. Prandaj, na duhet marrëveshje me Serbinë. Ajo duhet të jetë e përhershme dhe duhet të jetë e tillë që nuk lë asgjë të hapur. Kështu mund të shohim diçka të re në horizont: e majtë, demokratike dhe internacionaliste.

(Autori është nënkryetar i Partisë Socialdemokrate në Kosovë)



PREJ NGA VIJNË KORONAVIRUSËT?

Ekologjia si mjet kundër pandemive

Edhe në shekullin XXI, metodat e vjetra duken për autoritetet kineze mënyra më e mirë për të luftuar epideminë e koronavirusit. Lëvizjet e qindra miliona njerëzve janë kufizuar. A ka ardhur koha ta analizojmë shkakun e shfaqeve të njëpasnjëshme të pandemive me një ritëm gjithnjë e më të shpejtë?

NGA SONIA SHAH*

A është një pangolin? Një lakuriq? Ose edhe një gjarpër, siç thuhet, para se të demantohej?

Kush do të jetë i pari që do ta inkriminojë kafshën e egër që ka sjellur këtë koronavirus, të quajtur zyrtarisht Covid-19. Prej këtij virusi janë kurrthuar tani qindra miliona njerëz, të futur në karantinë ose të kontrolluar nga masat sanitare në Kinë dhe vende të tjera. Sigurisht se është e domosdoshme që të zbulohet ky mister, por duke spekuluar nuk mund të kuptojmë që ndjeshmëria jonë në rritje ndaj pandemive e ka burimin më thellë: shkatërrimi i përshpejtuar i habitateve.

Që nga viti 1940, qindra mikroba patogjenë janë shfaqur ose rishfaqur në zona ku në disa raste nuk kishin ekzistuar kurrë më parë. Ky është rasti me ‘HIV’-in, ‘Ebola’-n në Afrikën Perëndimore dhe ‘Zika’-n në kontinentin amerikan. Shumë prej tyre (60%) kanë origjinë shtazore. Disa të tjerë nga kafshët shtëpiake ose blegtorisë, por shumica e tyre (më shumë se dy të tretat) nga kafshët e egra.

Por, kafshët nuk kanë faj. Edhe pse në shumë artikuj me fotografi thuhet se pikënisja e epidemive shkatërruesel gjindet tek fauna e egër, nuk është e vërtetë se këto kafshë janë veçanërisht të infektuara me patogjenë vdekjeprurës, të cilët lehtë mund të na kontaminojnë. Në realitet, shumica e mikrobeve jetojnë brenda tyre pa i dëmtuar. Problemi qëndron diku tjetër: me shpyllëzimin, urbanizimin dhe industrializimin e shfrenuar, ju kemi mundësuar këtyre mikrobeve të depërtojnë dhe të përshtaten në trupin e njeriut.


RREZIQET E FERMAVE BLEGTORALE PËR RRIJTJE INDUSTRIALE

Shkatërrimi i habitateve kërcënon me zhdukje shumë specie², bimësh medicinale dhe kafshësh, të cilat janë përdorur gjithmonë për farmakopenë. Speciet të cilat kanë mbijetuar duhen medoemos të vendosen në pjesën e mbetur të habitatit, e cila është zvogëluar nga vendbanimet njerëzore. Si pasojë kemi një probabilitet të rritur të kontaktit të afërt dhe të përsëritur me njerëzit. Mikrobet që jetojnë në këto specie do të kalojnë tani në trupin tonë, ku nga beninjë që ishin, do të shndërrohen në patogjenë vdekjeprurës.

Ebola është një shembull shumë ilustrativ. Në një studim të vitit 2017 thuhet se ky virus është shfaqur në masë më të madhe në zonat e Afrikës perëndimore dhe qendrore, ku kohët e fundit ka pasur shumë shpyllëzime. Origjina e virusit ishte lokalizuar në specie të ndryshme të lakuriqëve. Kur prehen pyjet, lakuriqët vijnë e vendosen në pemët e kopshteve tona dhe fermave tona. Shumë lehtë mund të imagjinohet se çfarë ndodh pastaj: mund të ndodh që njeriu konsumon pështymën e lakuriqit duke kafshuar një frut, ose, ndërsa përpigjet të largojë dhe të vrasë këtë mysafir të padëshiruar, t’i ekspozohet mikrobeve që gjinden në indet e tij. Kështuqë shumë virusa, që barten nga lakuriqët, por që mbeten të padëmshme në organizmat e tyre, depërtojnë tek njeriu - për shembull Ebola, por edhe Nipah (veçanërisht në Malajzi ose Bangladesh) ose Marburg (veçanërisht në Afrikën Lindore). Ky fenomen quhet “kalimi i barrierës së specieve”. Nëse ngjan shpesh ky fenomen, mikrobet e kafshëve do të përshtaten në trupin tonë dhe do të evoluojnë për t’u bërë patogjenë.

E njëjta gjë vlen edhe për sëmundjet që shkaktohen nga mushkonjat, tani që është krijuar një lidhje në mes shfaqjes së epidemive dhe shpyllëzimit – por në ketë rast më shumë ka të bëjë me transformimin e tyre sesa me humbjen e habitatit. Kur prehen drunjtë, zhduken rrënjët dhe shtresa e gjetheve të thata. Uji dhe sedimentet rrjedhin më lehtë mbi tokën e zhveshur, ku depërton tani më lehtë dielli, duke formuar hapësira të favorshme për shumimin e mushkonjave që bartin malaria-n. Sipas një studimi të bërë në dymbëdhjetë vende, në zonat e shpyllëzuara ka dy herë më shumë mushkonja bartëse të patogjenëve njerëzor, sesa në pyjet e paprekura.

Shkatërrimi i habitateve bëhet gjithashtu duke ndryshuar numrin e disa specieve, duke rritur kështu riskun e përhapjes së agentëve patogjenë. Një shembull: virusi i Nilit Perëndimor i cili bartet nga zogj migrues. Në 50 vitet e fundit në Amerikën e Veriut, popullsia e zogjëve ka rënë për më shumë se 25% , për shkak të humbjes së habitatit dhe për shkak të shkatërimeve të tjera³. Por të gjitha speciet nuk goditen në të njëjtën mënyrë. Të ashtuquajturat zogjë specialistë (të habitatit), siç janë qukapiku apo specia rallidae, janë goditur më shumë sesa zogjët gjeneralistë, si për shembull robinët apo sorrat. Derisa të parët rrallë bartin virusin Nil Perëndimor, kategoria e dytë është një vektor bartës i shkëlqyer. Prandaj kemi një prani të madhe të virusit te shpendët vendor në rajon dhe kështu një probabilitet në rritje të thumbimit të zogut të infektuar nga mushkonja, e cila pastaj do ta thumbon njeriun⁴.



KJO DUKURI E MUTACIONIT TË MIKROBEVE TË KAFSHËVE NË PATOGJENE NJERËZORE NUK ËSHTË E RE, POR TANI PO PËRSHPEJTOHET. SHFAQJA E SAJ E PARË DATON NGA REVOLUCIONI NEOLITIK, KUR NJERËZIT FILLUAN TË SHKATËRROJNË HABITATET E EGRA PËR TË ZGJERUAR TOKËN E KULTIVUAR DHE PËR T’I ZBUTUR KAFSHËT E EGRA PËR NEVOJAT E TYRE. NË KËMBIM, KAFSHËT IU DHANË DISA DHURATA TË HELMUARA: LOPËT NA KANË SJELLUR FRUTHIN DHE TUBERKULOZIN, DERRAT KOLLËN E MIRË, DHE ROSAT NA KANË SJELLUR GRIPIN

Fenomeni është i njëjtë edhe për sëmundjet që i bartin rriqrat. Zhvillimi urban i copëton pak nga pak pyjet në Amerikën veri-lindore, duke i larguar kështu kafshët të cilat ndihmojnë në rregullimin e popullatës së rriqrave, për shembull opossumin, kurse në të njëjtën kohë speciet shumë më pak efektive në këtë rrafsh vazhdojnë të shumohen, për shembull miu me këmbë të bardhë apo dreri. Si rezultat, sëmundjet që barten nga rriqrat përhapen më lehtë. Në mesin e tyre, sëmundja Lyme, e cila u shfaq për herë të parë në Shtetet e Bashkuara në vitin 1975. Gjatë njëzet viteve të fundit janë identifikuar shtatë agent patogjenë të rinj që barten nga rriqrat⁵.

Rreziku i shfaqjes së sëmundjeve nuk rritet vetëm nga humbja e habitateve, por edhe nga mënyra se si zëvendësohen ato. Për ta kënaqur oreksin e tij mishngrënës, njeriu ka zhveshur një zonë me sipërfaqe të barabartë me atë të kontinentit afrikan⁶, për të ushqyer dhe të majmur bagëtinë. Këto kafshë do të kalojnë pastaj në rrjete ilegale tregtare ose në tregje të kafshëve të gjalla (*wet markets*) dhe aty do të bashkëjetojnë speciet të cilat ndoshta nuk do t’ishin takuar kurrë në natyrë. Kështuqë mikrobet shumë lehtë mund të kalojnë nga njëri në tjetrin. Një situatë e tillë, e cila kishte gjeneruar në vitet 2002-2003 koronavirusin si përgjegjës për epideminë e sindromës së rëndë akute të frymëmarrjes (SARS), është ndoshta burimi i koronavirusit të panjohur që na sulmon sot.

Por ka shumë më tepër kafshë që evoluojnë brenda sistemit tonë të bujqësisë industriale. Qindra mijëra kafshë të vendosura njëra mbi tjetrën presin të dërgohen në thertore: kushte ideale këto për t’i shndërruar mikrobet në patogjenë vdekjeprurës. Për shembull, viruset e gripit të shpendëve, të bartur nga shpendët ujorë, bëjnë kërdi në fermat e mbushura me pula të mbyllura. Pas mutacioneve, ky virus bëhet shumë më virulent - një proces

aq i parashikueshëm sa që mund të riprodhohet në laborator. Njëri nga këto, H5N1, bartet tek njeriu dhe vret më shumë se gjysmën e të infektuarve. Në vitin 2014, në Amerikën e Veriut, janë therrur dhjetëra miliona shpendë për ta ndaluar përhapjen e një virusi tjetër⁷.

Në grumbujt e jashtëqitjeve të bagëtive, mikrobet me origjinë shtazore gjejnë rrugë të tjera për ta infektuar njeriun. Toka bujqësore nuk mund të thithë sasinë enorme të jashtëqitjeve për pleh, atëherë shpesh ato barten në gropa të padepërtueshme - një vend i përshtatshëm për zhvillimin e bakteries *Escherichia coli*. Më shumë se gjysma e kafshëve të mbyllura për t’u majmur në stallat industriale amerikane e bartin këtë bakterie, e cila në trupin e tyre nuk bën dëm⁸. Por, tek njerëzit, *E. coli* shkakton diarre të përgjakshme, ethe dhe mund të shkaktojë dështim akut renal. Dhe pasi që shpesh ndodh që mbeturinat e kafshëve të derdhen në ujë e pijshëm dhe në ushqimin, 90,000 Amerikanë infektohen çdo vit.

Kjo dukuri e mutacionit të mikrobeve të kafshëve në patogjene njerëzore nuk është e re, por tani po përshpejtohet. Shfaqja e saj e parë daton nga revolucioni neolitik, kur njerëzit filluan të shkatërrojnë habitatet e egra për të zgjeruar tokën e kultivuar dhe për t’i zbutur kafshët e egra për nevojat e tyre. Në këmbim, kafshët iu dhanë disa dhurata të helmuara: lopët na kanë sjellur fruthin dhe tuberkulozin, derrat kollën e mirë, dhe rosat na kanë sjellur gripin.

Procesi vazhdoi gjatë përhapjes së kolonizimit evropian. Në Kongo, gjatë ndërtimit të hekurudhave dhe qyteteve nga kolonët belgë, një lentivirus i bartur nga specia ‘macaque’ e këtij vendi u përshtat në trupin e njeriut. Në Bangladesh, britanikët u futën në zonën e gjerë të lagësht të Sundarbanëve për të zhvilluar kultivimin e orizit, duke i ekspozuar banorët ndaj bakterieve ujore

që gjenden në këtë ujë të njelmhtë. Pandemitë e shkaktuara nga këto zhvillime koloniale janë ende aktuale. Lentivirusi në specien macaque është shndërruar në HIV. Bakterja ujore e Sundarbanëve tani njihet si kolera dhe deri tani ka shkakuar shtatë pandemi. E fundit ndodhi në Haiti.

Për fat të mirë, pasi që nuk kemi qenë viktima pasivë të këtij procesi, mund të bëjmë shumë për ta zvogëluar rrezikun e shfaqjes së këtyre mikrobeve. Mund t’i mbrojmë habitatet e egra në mënyrë që mikrobet mos të barten tek njeriu, por të qëndrojnë te kafshët, siç propozon Lëvizja One Health⁹.

Mund të mbikëqyrim me vëmendje mjediset ku ka më shumë gjasa që mikrobet e kafshëve të shndërrohen në patogjene njerëzore. Ato që duken më të prirura për t’u përshtatur me organizmin tonë duhet të eliminohen para se të shkaktojnë ndonjë epidemi. Studiuesit e programit Predict, të financuar nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (Usaid) e kanë bazuar veprimtarinë e tyre në këtë strategji për dhjetë vitet e fundit. Ata tashmë kanë identifikuar më shumë se nëntëqind viruse të reja të lidhura me aktivitetin njerëzor në planet. Në mesin e tyre gjenden lloje të panjohura më parë të koronavirusit, të ngjashme me virusin e SARS-it¹⁰.

Tani jemi të rrezikuar nga një pandemi e re dhe jo vetëm për shkak të Covid-19. Në Shtetet e Bashkuara, përpekjet e administratës Trump që industritë përpunuese dhe të gjitha aktivitetet industriale të lirohen nga të gjitha rregulloret do ta përkeqësojnë humbjen e habitateve, duke promovuar bartjen e mikrobeve nga kafshët te njeriu. Në të njëjtën kohë, qeveria e SHBA-ve i zvogëlon shanset tona për t’i zbuluar mikrobet para se të përhapen: në tetor 2019 vendosi të ndërprej programin Predict. Në fillim të shkurtit 2020, njoftoi gjithashtu se do ta zvogëlojë për 53% kontributin në buxhetin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Sipas epidemiologut Larry Brilliant: “*nuk mund të shmanget shfaqja e viruseve, por mund të shmangen epidemitë*.” Sidoqoftë, do të kursehem nga epidemitë vetëm nëse jemi po aq të vendosur për ta ndryshuar politikën sa që kemi qenë për ta ç’rregulluar natyrën dhe jetën e kafshëve.

* Gazetare. Autore e *Pandemic: Tracking Contagions, from Cholera to Ebola and Beyond*, Sarah Crichton Books, New York, 2016, et de *The Next Great Migration: The Beauty and Terror of Life on the Move*, Bloomsbury Publishing, Londër, i cili do të botohet në 2020. Ky tekst është botuar në *The Nation*

1 Kai Kupferschmidt, «This bat species may be the source of the Ebola epidemic that killed more than 11,000 people in West Africa», *Science Magazine*, Washington, DC – Cambridge, 24 janar 2019.
2 Jonathan Watts, «Habitat loss threatens all our futures, world leaders warned», *The Guardian*, Londres, 17 nëntor 2018.
3 Katarina Zimmer, «Deforestation tied to changes in disease dynamics», *The Scientist*, New York, 29 janar 2019.
4 Carl Zimmer, «Birds are vanishing from North America», *The New York Times*, 19 shtator 2019.
5 BirdLife International, «Diversity of birds buffer against West Nile virus», *ScienceDaily*, 6 mars 2009, www.sciencedaily.com
6 «Lyme and other tickborne diseases increasing», Centers for Disease Control and Prevention, 22 prill 2019, www.cdc.gov
7 George Monbiot, «There’s a population crisis all right. But probably not the one you think», *The Guardian*, 19 nëntor 2015.
8 «What you get when you mix chickens, China and climate change», *The New York Times*, 5 shkurt 2016. Në Francë, gripi i shpendëve ka prekur fermat gjatë dimrit 2015-2016 dhe ministria e bujqësisë vlerëson se ekziston një rrezik këtë dimër për zogjtë me prejardhje nga Polonia.
9 Cristina Venegas-Vargas et al., «Factors associated with Shiga toxin-producing *Escherichia coli* shedding by dairy and beef cattle», *Applied and Environmental Microbiology*, vol. 82, n° 16, Washington, DC, gusht 2016.
10 «What we’ve found», One Health Institute, https://ohi.sfi.ucdavis.edu

MËSIMET E KRIZËS SË KORONAVIRUSIT

Shteti, tregu dhe e fundit krizë e tillë

Epidemia e tanishme na ka ndihmuar të pajtohemi me brishtësinë tonë dhe të kuptojmë po ashtu se kjo brishtësi është rezultat i një sistemi që nuk mund të mbahet tutje. Ne thjesht nuk mund të shkojmë përpara drejt rreziqeve të panjohura dhe në rritje të së ardhmes, me një sistem shtetëror dhe treg, që pretendojnë se nuk ishim të përgatitur për diçka të tillë.

NGA ARTAN SADIKU*

Epidemia e koronavirusit ka ngritur shumë çështje sociale dhe politike të cilat nuk mund thjesht të injorohedhe gjatë kohërave ekstreme ne të cilat po jetojmë tani. Ato janë të rëndësishme sepse shumë prej tyre, në një shkallë të caktuar, përcaktojnë se si po merrmi me këtë epidemi dhe si do të jetojmë pasi që ajo të zhduket. Një nga aspektet politike më të dukshme të kësaj krize është rishfaqja e shtetit si agjent përfundimtar i dhënies së përgjigjes ndaj epidemisë së koronavirusit.

Dhe që në fillim dua të sqaroj se kjo nuk është koha e përshtatshme, për ata që anojnë për prirje më shumë anarkike, për ta luftuar shtetin. Përkundrazi, duhet të pranojmë se tani kemi nevojë për shtetin dhe se ky duhet të jetë ‘shërbimi’ i fundit që e pranojmë prej tij. Edhe pse mund të analizojmë se në çfarë nivele është e gabuar përgjigja e shtetit ndaj krizës epidemike, ne kemi nevojë për shërbimin e tij, për shkak se ky i fundit duhet ta hajë supën e vet helmuese që e ka gatuar për shoqërinë. Kështu, duke e shtyer atë në vetëvrasjen e tij, e cila, është një thirrje për të gjithë ne, për t’i organizuar veprimet tona autonome që paralelojnë me ato të shtetit. Duke vepruar kështu, ne nuk duhet t’i kufizojmë përpjekjet tona kolektive vetëm në plotësimin e boshllëkut të lënë nga shteti, por të punojmë për të gjetur mënyra krijuese dhe inovative, për të zëvendësuar sistemin ekzistues mosfunksional të shërbimeve, të shkatërruara nga aleanca shtet-treg.

Kështu që nuk kemi nevojë as për nënvlerësim dhe as për ekzagjerim të situatës së tanishme të epidemisë, por që përkundrazi t’i analizojmë kushtet materiale reale që shpalosen në mes të kësaj krize dhe të ndërtojmë strategji për veprim, pa fetishizuar ose heqje dorë të menjëhershme nga shumë teori dhe praktika, për ndërtimin e komuniteteve të reja të solidaritetit dhe të kujdesit.

Kriza aktuale globale nga koronavirusi ka mundësuar që një e vërtetë të manifestohet, e vërteta e komunitetit. Kjo e vërtetë po bëhet gjithnjë e më e pranishme, jo për shkak të veaktualizimit - ajo ka qenë pëherë aktuale, por ngase veprimet e dështuara të shtetit na kanë sjellë përpara një hapësire të gjerë me mundësi të reja. Madje në mes të krizës së koronavirusit, shteti po rrit në mënyrë drastike mobilizimin e tij për t’na penguar që ta aktualizojmë të vërtetën e komunitetit. Ky aktualizim i ka shanset më të mira për të fituar luftën me virusin. Bllokimet, karantinat dhe orët policore janë metoda që ndryshojnë

në shkallën e kufizimit të njerëzve, duke bllokuar kështu efektivisht potencialin e shoqërisë për mobilizimin dhe ndihmën e ndërsjellë. Megjithatë, e vërteta e komunitetit sjell ende karakteristikat e saj: solidaritet, kujdes, të ndarjes me tjetrin dhe ndjenjën e përkatësisë së përbashkët.

Mbingarkesa e sistemit të prishur

Në vend që ta kemi një trajnim të shpejtë dhe masiv të miliona njerëzve në të gjithë botën për të ndihmuar në ndërtimin e një infrastrukture masive mbështetëse për trajtimin e të sëmurëve dhe grupeve të tjera të prekura nga virusi, ne jemi përballur me ndërhyrjen e shtetit për të legjitimuar veten si kujdestar të fundit. Pavarësisht se kjo do të rezultojë në më shumë vdekje dhe pasoja të tjera, nga ato ekonomike, tek ato sociale dhe politike. Nëse kjo prerogativë hiqet nga shteti, ajo që do të mbetet është vetëm shfaqja e forcës brutale.

Akti i shtetëzimit të spitaleve private nën pretekstin e koronavirusit do ta rrisë me siguri aftësinë e shtetit në trajtimin e epidemive në një periudhë të shkurtër kohore, por do ta ndihmojë gjithashtu atë ta ruajë karakterin e tij anti-social, monopolizimin e shëndetësisë, ndërkohë që është i pa aftë për ta kryer obligimin e tij.

Problemi me mbingarkimin e sistemit shëndetësor të shkatërruar qëllimisht vjen si rezultat i koncesioneve të gjata që i janë bërë tregut të shëndetësisë. Konfirmimi dhe policimi i lirisë së lëvizjes së njerëzve është vazhdim i politikës së mbrojtjes së atyre koncesioneve. Për aq kohë sa njerëzit vazhdojnë të vdesin në spitale dhe jo në rrugë, shteti mund ta transferojë fajin në shkencën mjekësore dhe jo në kufizimet e veta. Politika e ‘rrafshimit të kurbës’ e cila fitoi legjitimitet universal brenda natës ka për qëllim të kryejë funksionin e mirëmbajtjes së monopolit të vdekjes, të mbyllur brenda institucioneve shtetërore. Në momentin që vdekja do të ndodhte masivisht në rrugë, ajo do të ishte vdekja e vet shtetit. Pavarësisht se rrugët, nëse nuk boshatisen nga njerëzit e trajnuar, në të vërtetë mund të shpëtonin shumë jetë.

I vërtetë është argumenti i joefikasitetit të shtetit në ofrimin e shërbimeve që u përdor për privatizimin e shumë sektorëve të tij, por tani dihet që shërbimet e tregut privat janë edhe më të këqija. Përballja me katastrofat e reja të ardhshme, që vijnë nga lidhja e shtetit me tregun kapitalist,



**KRIZA AKTUALE GLOBALE
NGA KORONAVIRUSI
KA MUNDËSUAR QË
NJË E VËRTETË TË
MANIFESTOHET, E
VËRTETA E KOMUNITETIT.
KJO E VËRTETË PO
BËHET GJITHNJË E
MË E PRANISHME,
JO PËR SHKAK TË
VEKTUALIZIMIT -
AJO KA QENË PËHERË
AKTUALE, POR NGASE
VEPRIMET E DËSHUARA
TË SHTETIT NA KANË
SJELLË PËRPARA NJË
HAPËSIRE TË GJERË ME
MUNDËSI TË REJA**

do të kërkojë një organizim kolektiv horizontal për shpërndarjen e njohurive dhe teknologjive të lëshuara nga patentat dhe monopolet. Një nga hapat më të shpejtë në këtë pikë është gjenerimi i një thirrje kolektive globale për një intelekt të përgjithshëm, të çliruar nga interesa të veçantë të tregjeve dhe të shtetekombeve. Të gjithë e mbajmë mend Aaron Schwartz që lëshoi falas mijëra materiale shkencore në internet dhe që tani është i vdekur sepse e burgosi shteti. Fati i tij është një kujtesë për funksionin e lidhjes shtet-treg, për t’i kufizuar njohuritë, të cilat janë thelbësore për t’i luftuar rreziqet e zakonshme.

Ruajtja e shoqërisë së policuar

Ndërsa jemi dëshmitar të një zhvendosjeje të papritur të autoritarizmit në shoqëritë që e kanë përqafuar individualizmin e lirë si vlerë më të lartë, mund të rrëshqasim në argumentin logjik të dukshëm të së keqes së nevojshme. Kjo mund të duket përgjigja e pyetjes, se si e njëjta shoqëri e individëve të lirë kërkon tashmë diçka kolektive: një karantinim kolektiv. Por, domosdoshmëria e shtetit për të ndërhyrë në parandalimin e keqbërësve, ata që duke mos e kufizuar lëvizjen e tyre shoqërore mund të dëmtojnë shumë të tjerë; vjen si rezultat i mungesës së ndjenjës së përkatësisë dhe

përgjegjësisë ndaj komunitetit. Individualizëm i lirë karshi komunitetit, ai që është gjithmonë subjekt i autoritarizmit dhe policimit.

Duke u larguar nga autoritarizmat e mëparshëm ‘socialist’ që praktikonin shtypje në emër të komunitetit, urgjentet që i shohim këto ditë tentojnë shtypjen e komunitetit në emër të individëve. Regjimet ‘socialiste’ kishin individët në shënjestër. Praktikatat aktuale të karantinimit synojnë komunitetet. Ndërsa dyjat janë anti-shoqërore në matricat e tyre shtetërore-ideologjike, shtypja e tanishme vjen si një domosdoshmëri ‘natyrore’, e cila nuk shfaq ndonjë pretendim ideologjik. Megjithëkëtë, kjo është rezultat dhe domosdoshmëri e drejtpërdrejtë e ideologjisë së shpallur të tregut të individëve që konsumojnë lirshëm.

Një komunitet është gjithmonë antidota për policinë. Individualizmi ndërton çështjen për domosdoshmërinë e policisë. Nëse pas kësaj krize kthehemi në normalitetin e individualizmit të lirë të tregut, do t’na duhen ndërhyrje të pafundme policie në krizat e ardhshme që na presin. Kështu që nëse zgjedhim të njëjtën rrugë, ne duhet të jemi të gatshëm të përballemi me një tendencë në rritje të fshirjes së një spektri të gjerë të drejtave dhe lirive.

Kthimi në normalitet, pasi zhduket kriza, do të thotë vazhdimësi në mungesë të vetorganizimit dhe se gjithçka do t’i dorëzohet hierarkisë së shtetit. Shteti do të marrë sërish vendime për shoqërinë në vend se t’i shërbejë asaj. Në një emergjencë të tillë globale, si bëhet që shteti i cili është historikisht një ngjarje aksidentale pretendon legjitimitetin për t’i monopolizuar përpjekjet për t’u marrë me krizën e cila kërkon përpjekje masive popullore. Dhe e gjithë kjo ndodh pas dekadash që shteti zgjat shërbimet e tij në favor të tregut fitimprurës.

Ndërsa pothuajse asnjë luftë në historinë e njerëzimit nuk është fituar duke qëndruar në shtëpi, karantinimet aktuale që janë përhapur si veprim më efektiv, shfaqin një mungesë mahnitëse të alternativave, që vërteton sesa të kufizuar jemi në gjetjen e zgjidhjeve, kur ato mbeten në mëshirën e shtetit.

Normalizimi i tregjeve destruktive

Dy drejtimet kryesore të vepërimit të elitave politike dhe të shteteve në duart e tyre, në trajtimin e trazirave ekonomike nga pandemia; kanë qenë ose ta mbajnë procesin e vazhimit prodhimit ose ta ndalojnë atë për një periudhë të shkurtër kohore në mënyrë që të shpëtohen burimet e saj – fuqia punëtore, për një rifillim të shpejtë më pastaj.

Aspekti i kohës është ndoshta faktori më i rëndësishëm në vendimet e marra nga shtetet për trajtimin e epidemisë dhe për shërbimin e tyre të vazhdueshëm në tregun kapitalist. Fakti që asnjë masë e vetme serioze kufizuese, si ato që po shohim tani për ta trajtuar mjedisin dhe krizën e ndotjes që vret po ashtu miliona njerëz, tregon se shtetet dhe tregjet janë në rregull me një kohë të zgjatur të një shkatërrimi jetëgjatë. Një sëmundje e papritur masive e punëtorëve mund ta dëmtojë seriozisht procesin e prodhimit, kështu që është më mirë të keni një pushim të shkurtër nga procesi i prodhimit dhe të huazoni pak kohë nga e ardhmja, e cila do të paguhet me ndihma masive për korporatat që i shohim duke u shpalosur në tërë botën.

Bllokimet, karantinat dhe orët policore, të vendosura nën rrethanat aktuale, janë masa për të mbrojtur punëtorët si asete kapitali dhe jo për t’i mbrojtur ata në trupat e tyre si individë të shëndetshëm, organe që janë gjithnjë e më shumë të ekspozuar ndaj orarit teknologjikisht të zgjatur të punës, duke jetuar në qytete të ndotura, rritjes së pasigurisë dhe uljes së mbrojtjes të kujdesit shëndetësor.

Masat aktuale të ndërmarra nga qeveria nuk janë gjë tjetër veçse përpjekje për t’i normalizuar të njëjtat tregje që me veprimet e tyre degraduan kapacitetet kolektive për menaxhimin e krizës. Dhe ajo që ata po përpiqen të normalizojnë është një treg global që po shkonte tashmë drejt kolapsit. Organizata Botërore e Tregtisë ka deklaruar tashmë se deri në vitin 2019 rritja e tregtisë globale ishte më e ulët në një dekadë. Kriza e tanishme e shtyu atë më shpejtë në kolapsin e saj të pashmangshëm.

Teksa ekziston një shqetësim i mirëfilltë se miliona punëtorë janë larguar nga puna si rezultat i krizës ekonomike nga pandemia, kjo gjithashtu mund të shihet si një potencial i madh për t'i mobilizuar punëtorët global të vetëorganizuar në proceset e prodhimit jopërfuturës. Rëndësia e atyre punëtorëve që do të pushohen nga puna është tani më e lartë se në çdo kohë tjetër në historinë e vonshme. Mjekët, infermierët, zjarrfikësit, punëtorët në sektorin e ushqimit, punëtorët e transportit, drejtuesit e kamionëve dhe të tjerët, janë profesionet që nevojiten me të vërtetë në mënyrë që të përgatitemi më mirë për sfidat e ardhshme; jo bankierët dhe politikanët e korruptuar. Në mes të kësaj epidemie, mënyrat sesi merremi me sfidat e së ardhmes nuk pushojnë së formuari, ashtu si edhe lufta e klasave dhe dinamike e saj në shoqëri.

Po e shohim tani sesi po sakrifikohen nga shteti mjekët dhe infermierët, heronjtë e këtyre kohërave, për shkak të tkurrjes së qëllimshme të sektorit të shëndetit publik. Por, përqendrimi dhe lokalizimi i punëtorëve të viktimizuar nuk është aspak një strategji e re e kapitalizmit të tregut dhe shtetit. Nëpërmjet veprimeve të tyre, miliona punëtorë në të gjithë botën po sakrifikohen çdo ditë përmes prodhimit të materialeve toksike për pajisjet që përdorim në jetën tonë të përditshme. Epidemia zbuloi vetëm mjekët si një shembull i thjeshtë që flasin për një tendencë të përgjithshme. Kështu, në vend që ta vlerësojmë heroizmin e mjekëve dhe infermierëve, duhet të luftojmë të shpëtojmë këdo, kudo, që vihet në punë, në kushte të ngjashme. Lufta përmes angazhimit kundër shtetit dhe tregut kapitalist gjen motivim të mjaftueshëm në faktin se të lartpërmendurat s'kanë ide për të tashmen e aq më pak për të ardhmen. Shohim sesi shtetet, duke pasur parasysh të gjitha vlerësimet logjike dhe të dhënat empirike që vërtetojnë të kundërtën, vazhdojnë të fusin para pa mbarim në shpëtimin e tregut kapitalist nga rënia drejt së cilës po shkonte gjithësi.

Zbatimi i masave shtrënguese sociale përmes popullizmit

Mes përmes rrjeteve sociale shohim sesi individët e karantinuar po shpikin mënyra të pakuptimta për ta kaluar kohën e tyre në shtëpi. Në vend që të shpikim metoda për t'i ndihmuar të sëmurët dhe ata në nevojë, ndërsa zgjatë kjo pandemi, shteti na mban larg nga realizimi i këtij potenciali kolektiv. Në vend që t'i ndihmojmë fqinjët, jemi duke u ndarë nga ta, duke u detyruar të bëhemi spiunë të sjelljes së tyre potencialisht të rrezikshme. Rreziku i paraqitur nga kjo pandemi për shëndetin dhe standardin e jetesës së miliona njerëzve është shumë i madh tani për të mbetur vetëm në menaxhim të shteteve.

Ky lloj shtrëngimi shoqëror, nuk është asgjë tjetër veçse një version i masave shtrënguese të zbatuara pas rrëzimit financiar 2008/09. Të dhënat e pas vitit 2008 tregojnë qartë se shtrëngimet shkaktojnë mjerim social e ekonomik dhe vdekje të shumta. Ndërsa shtrëngimi i mëparshëm u implementua përmes masave financiare, ky aktual po implementohet përmes policisë dhe në disa raste qesharake - ushtrisë. Kjo flet vetëm për shtrirjen e përkushtimit të shtetit për ta vendosur epërsinë e tij hierarkike përmes një kombinimi të metodave në varësi të situatës.

Në kapjen e tij të horizontit të mundësive kolektive dhe shtypjes pasuese, shteti po gjeneron një formë të kthyer mbrapshtë të popullizmit. Një popullizëm nga poshtë-lart që pasqyron gjendjen e shoqërisë nën (ri)paraqitjen e drejtpërdrejtë të shtetit si autoriteti i vetëm legjitim për t'u marrë me krizën epidemike. Ky status i shtetit, i kombinuar me elementin e panikut dhe histerisë, i shtyen masat të kërkojnë të gjitha llojet e gjërave nga shteti, si bllokime

Masat policore të ndërmarra nuk po ndeshen me baza logjike, por përkundrazi mbështeten në idenë abstrakte që shteti e di se çfarë bën. Në një organizim të ndryshëm shoqëror, mjekët do të ishin ata që marrin rolin kryesor, ata që gëzojnë gjithashtu një besim më të lartë në mesin e njerëzve. Atëherë ekspertiza e tyre do të ishte shumë më efektive në luftën kundër virusit nëse nuk do të ndeshesh nga ndërmjetësimi popullist i politikës së shtetit.

më të rrepta, orë më të gjata policore dhe madje grumbullimin e ilaçeve që s'janë provuar akoma e që luftojnë koronavirusin. Për të gjitha këto kërkesa, shteti përgjigjet duke dhënë sa më shumë që është e mundur, duke u siguruar masave një sens (fals) të sigurisë në periudha të vështira.

Kështu, kjo situatë siguron një moment të përsosur popullist për shtetin, i cili ndërsa karantinon më shumë njerëz, bëhet edhe më popullor si strukturë. Kjo edhe është arsyeja pse në paraqitjet publike të politikanëve të shtetit, ata përqendrohen në masat e policisë dhe jo në dinamikën e virusit, sepse thjesht dimë shumë pak për të. Edhe me kaq pak njohuri, masat policore të ndërmarra nuk po ndeshen me baza logjike, por përkundrazi mbështeten në idenë abstrakte që shteti e di se çfarë bën. Në një organizim të ndryshëm shoqëror, mjekët do të ishin ata që marrin rolin kryesor, ata që gëzojnë gjithashtu një besim më të lartë në mesin e njerëzve. Atëherë ekspertiza e tyre do të ishte shumë më efektive në luftën kundër virusit nëse nuk do të ndeshesh nga ndërmjetësimi popullist i politikës së shtetit.

Ekzistojnë gjithashtu një varg pyetjesh mbi efektivitetin e shkencës sipas modelit aktual të interesave të drejtuara nga tregu në kërkim dhe inovacion. Çështja nuk është të vihen

në dyshim gjetjet shkencore, përkundrazi, si do ta përdorim tonë potencialin të sotshëm shkencor dhe çfarë e shtyen inovacionin. Në cilat hapësira është planifikuar dhe prodhuar teknologjia, dhe për cilat qëllime? Për sa kohë që fitimi i drejton të gjitha këto, ne duhet ta marrim shkencën si një mjet thjesht teleologjik në duart e atyre që i zotërojnë burimet e zhvillimit të tij.

Natyra e kësaj krize dhe e katastrofave të tjera në të ardhmen, siç është ajo mjedisore, është mjaft komplekse dhe ka nevojë për një bashkim të forcave kolektive përmes teknologjive të reja aktuale dhe të mundshme. Metodat arkaike të shtrëngimit dhe ushtrimit të fuqisë nuk janë të përshtatshme për t'i adresuar sfidat me të cilat po përballemi sot. Një ushtri e pajisur mirë me njerëz me teknologji dhe trajnim të duhur, mund të shpëtojë shumë më tepër jetëra, se policia dhe ushtria e vendosur aktualisht në rrugët tona.

Ndërtimi i komuniteteve të qëndrueshme të së ardhmes

Epidemia e tanishme na ka ndihmuar të pajtohemi me brishtësinë tonë dhe të kuptojmë po ashtu se kjo brishtësi është rezultat i një sistemi që nuk mund të

mbahet tutje. Ne thjesht nuk mund të shkojmë përpara drejt rreziqeve të panjohura dhe në rritje të së ardhmes, me një sistem shtetëror dhe treg, që pretendon se nuk ishim të përgatitur për diçka të tillë. Është pikërisht mosgatitshmëria që duhet të merret në ballë të debatit për krizën epidemike. Nuk ishim të përgatitur sepse shtetet tona dhe tregjet kapitaliste nuk janë të dizajnuara për t'u përgatitur dhe për ta planifikuar për të ardhmen. Sepse ata nuk e shohin të ardhmen si një perspektivë për një mirëqenie kolektive të njerëzve. Në të kundërtën, ata e shohin atë si një bankë për të marrë hua kohën, si një potencial për t'u shfrytëzuar për përfitim.

Për t'u bërë të qëndrueshëm në të ardhmen, duhet të ndërtojmë komunitete të qëndrueshme të cilat janë pengesa të vetme të maksimumit të potencialeve tona kolektive. Sfidat e ardhshme të cilat shpërndahen nëpër lokacione të ndryshme në një hapësirë globale të mbushur me faktorë të shumtë. Ato bashkëveprojnë për të gjeneruar një situatë të përgjithshme, bëjnë thirrje për një vetëmenaxhim lokal të potencialeve tona dhe një shkëmbim global të njohurive dhe inovacionit përtej kufizimeve të paraqitura nga interesat globale të kapitalit. Njohuritë dhe burimet për zgjidhjen e rreziqeve përkatëse në të ardhmen janë shumë të vlefshme për shëndetin dhe mjedisin tonë, që të lejohen ta kenë një çmim tregu.

Mënyra në të cilën u futëm në këtë krizë mund ta përcaktojë kryesisht mënyrën e daljes nga ajo. Mësimet që i kemi marrë pas krizës së vitit 2008 tregojnë se nuk mund të ketë kthim në "normalitet" pa një çmim masiv të paguar nga miliona punëtorë dhe popuj të tjerë të shtypur. Në vitin 2008 kemi hyrë në krizë me një hendek të madh në ndarjen e klasave dhe zgjidhja ishte një luftë e klasave e kryer përmes masave shtrënguese për të varfërit dhe ndihmat për të pasurit.

Dinamika e krizës së kësaj epidemie në ndërthurjen e shtetit dhe tregut kapitalist nuk është një territor i paeksploruar. Në fakt, përcaktohet nga dinamika e fuqisë që vendos për rrugën e saj jashtë kësaj situatë. Vendosja e policisë nga shteti është një masë për t'i betonuar vendimet të cilat merren në emër të tregut kapitalist. Por, gjithashtu tregon kufizimet e të dyjave, kufizimet të cilat policohen dhe financohen për ta mbajtur larg potencialin e zhdukjes masive të hapësirës së tyre të spekulimeve. Hapjen e derës për atë potencial po e siguron vet shteti dhe tregu kapitalist. Pushimi i shkurtër i synuar me prodhimin për përfitim, që do ta mundësonte një rifillim të shpejtë, mund të zgjatet edhe mëtej. Duke e pasur parasysh interesin popullist të shtetit për t'i përmbushur kërkesat popullore në këtë moment, mund ta kërkojmë kolektivisht një periudhë shumë më të gjatë të këtij pushimi. Një i tillë që do ta kryejë të njëjtin rol si një pauzë teatrale, në vend që të zbrazë hapësirën, rritë tensionin.

(*Autori është filozof dhe teoricien nga Shqipëria)



SI E BLEU RESPEKTIN E TIJ ALEKSANDËR VUÇIQI?

Autokrati serb që përkëdhelet nga Brukseli

I formuar në shkollën e “skifterëve” nacionalistë, z.Aleksandër Vuçiq qeveris Serbinë me dorë të hekurt. Vetëkënaqësia e liderëve evropianë ndaj tij shpërfaq hendekun midis parimeve të shpallura nga Bashkimi Evropian dhe zbatimit të tyre, me kusht që qeveritë e Evropës Qendrore t'i respektojnë normat e neoliberalizmit dhe ndarjen e re ndërkombëtare të punës në kontinent.

NGA JEAN-ARNAULT DÉRENS
DHE LAURENT GESLIN*



prill 2018 me një dënim prej dhjetë vjetësh të cilat u mbuluan me kohën e paraburgimit paraprak.

Shesheli u rritkhy në krye të SRS-së, por kjo parti e marginalizuar shërben tanimë më së shumti si një mbulesë në krahun e djathtë të z.Vuçiq. Nga ana e tij, SNS-ja fitoi respekt duke u përfshi më 2016 në Partinë Popullore Evropiane (EPP), që përbashkon partitë konservatore të kontinentit, përfshirë partinë franceze «Les Républicains».

Duke e qeverisur vendin e tij me një dorë të hekurt, z.Vuçiq përzgjedhi neoliberalizmin e egër.

Në këtë fushë, ai gjen një partnere ideale në persoanalitetin e znj.Ana Bërnabiq, të emëruar kryeministre në qershor 2017. Duke qenë nga një familje e njohur në Beograd me prejardhje pjesërisht kroate, haptazi lezbike, Bërnabiqi studioi administratën dhe biznesin në Shtetet e Bashkuara, pastaj komunikimin në Universitetin Britanik të Hull-it, para se të punonte për delegacionin serb në USAID, agjencionin e bashkëpunimit amerikan.

Kjo *executive woman*, biografia e së cilës portretizon një imazh të favorshëm modern, krenohet se udhëheq “qeverinë më liberale në historinë e Serbisë”. Sapo erdhi në pushtet, ajo u përball me një grevë në fabrikat e veturave të Kragujecit, të rimarrë nga prodhuesi italian Fiat. Ajo i akuzyoi punëtorët grevistë se ishin vetëm “egoistë” të cilët rrezikonin t’i dekurajonin investitorët e huaj dhe se ishin “shumë të paguar”, pasi që pagat e tyre ishin pak mbi mesataren e vendit, më pak se 500 euro në muaj

Konvertimi pro-evropian i z.Vuçiq, shkalla e sinqeritetit e të cilit mbetet një pyetje pa përgjigje, përputhej mrekullisht me pritjet e vendeve perëndimore. Dukej në të vërtetë e rrezikshme të lejohej zhvillimi i një të djathtë ekstreme serbe në armiqësi të hapur ndaj Bashkimit Evropian, përderisa z.Vuçiq dukej se ishte personi më i duhur për ta zgjidhur statusin përfundimtar të Kosovës, të perceptuar si çelës i stabilitetit të Ballkanit.

Njohja zyrtare e pavarësisë së ish-krahinës së saj është një pilulë e hidhur për t'u gëlltitur nga Beogradi, por kush më mirë se një nacionalist për ta bërë këtë, pa pasur druajtje për akuzat për tradhti kombëtare?

Më 2018, z.Vuçiq ishte shumë i përfshirë me homologun e tij kosovar Hashim Thaçi, në kërkimin e një kompromisi që presupozonte edhe shkëmbime teritorësh midis dy vendeve. Ky opsion duket se është hedhur poshtë përkohësisht. Duke e menduar veten të domosdoshëm për çështjen e Kosovës, z.Vuçiq është i bindur se veprimet autoritare të regjimit të tij nuk do të jenë kurrë subjekt i kritikave serioze nga partnerët e tij perëndimorë.

Vizitat pompoze të Vlladimir Putin të Beograd, si ajo e janarit 2019, i lejojnë atij të kujtoj se ai ka edhe një strategji alternative gjeopolitike, duke e rimarrë kështu pozitën e barazpeshave midis botës perëndimore dhe BRSS, e cila e kishte siguruar përparimin e Jugosllavisë për një kohë të gjatë. Politika e barazpeshës që Beogradi pretendon ta

orkestrojë midis Moskës dhe Brukselit është megjithatë shumë iluzore, sepse Bashkimi Evropian mbetet bindshëm partneri i tij kryesor tregtar, me 62% të këmbimeve tregtare, kundrejt më pak se 7% për Rusinë.

Aleancat e sotme për të nesërmen evropiane

Por, situata serbe nuk është asgjë e jashtëzakonshme. I njëjti autoritarizëm mbretëron në Malin e Zi fqinj. Që nga viti 1991, z.Gjukanoviq ndërro funksionet e Kryeministrit dhe Presidentit të Republikës. Partia e tij Socialiste Demokratike (DPS), tani anëtare e Internacionales Socialiste, është trashëgimtarja e drejtpërdrejtë e Lidhjes së Komunistëve Malazez. Pra, në pushtet që nga viti 1945...

Protestat opozitare në Mal të zi përgjatë vitit 2019 kanë burimin e tyre në rastet e korrupsionit, por qeveria malazeze e di po ashtu se mund të llogarisë në mungesën e një alternative politike dhe në mbështetjen e vendosur të partnerëve të saj ndërkombëtarë.

Përderisa Mali i zi u bashkua me Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) në vitin 2017, Gjukanoviqi paraqitet si një mbrojtës i Perëndimit përballë kërcënimit rus, shumë të mbivlerësuar në Ballkan. Kërcënim i konkretizuar gjatë një përpjekje shumë misterioze të një grushtshteti më 16 tetor 2016. Mbi të gjitha, kjo i mundëson z.Gjukanoviq ta diskreditojë opozitën e tij dhe të paraqitet si garantuesi i vetëm i demokracisë dhe i “rrugës evropiane” të Malit të Zi.

Liderët serbë dhe malazezë konsiderohen kështu si shtyllat e stabilitetit rajonal dhe aleatët më të mirë të Perëndimit. Të dytë kërkojnë që vendet e tyre të anëtarësohen në Bashkimin Evropian, një perspektivë që duket se po largohet pasi që Franca bllokoi kandidaturat e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut më 18 tetor. Pozicioni i Macron shihet si një goditje në të gjithë procesin e integritetit të Ballkanit Perëndimor.

Por status-quoja nuk i pengon domosdoshmërisht dy njerëzve të fuqishëm të Beogradit dhe Podgoricës. Në këmbim të vetëkënaqësisë së tyre, vendet e Evropës Perëndimore e dinë që mund të mbështeten tek ata për t'i ruajtur kufijtë e Ballkanit përballë migrantëve dhe refugjatëve.

Më 4 dhe 5 Shtator, z.Vuçiq ishte mysafiri i nderit i një forumi mbi demografinë në Budapest. Ai nuk harroi ta falënderojë mikëpritësin e tij, kryeministrin hungarez Viktor Orbán: «Marrëdhëniet tona janë më të mira se kurrë falë z.Orbán. Ju siguroj se do të mbetemi miq besnikë tuajin dhe të vendit tuaj.» Hungaria po bën fushatë aktive për integrimin e Serbisë në Bashkimin Evropian. Përtej çështjes së refugjatëve, për të cilën Beogradi dhe Budapesti nuk kanë vështirësi të pajtohen, shtetet e Ballkanit janë objekt i gjithë vëmendjes së qeverive konservatore të Evropës Qendrore të grupit të Vishegradit, të cilët shpresojnë të sigurojnë sa më shumë aleatë ideologjikë në ditën kur këto vende do të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian.

Çdo të shtunë, që nga fillimi i dhjetorit 2018, mijëra serbë dalin në rrugë për ta kundërshtuar “diktaturën” e Presidentit Aleksandër Vuçiq, kontrollin ngulfatës që e ushtron regjimi i tij mbi drejtësinë ose mediat. Kjo valë proteste filloi pas rrahjes nga persona të panjohur të z.Borislav Stefanoviq, udhëheqësit të partisë së vogël, Lëvizja e Majtë e Serbisë (PLS), përderisa ai përgatitej të fliste në publik në Krushec më 23 nëntor 2018.

I nisur nga Beogradi, mobilizimi protestues u përhap shpejt në shumë qytete të vendit, duke u përforcuar nga grupet lokale të cilët kundërshtonin konfiskimin e të gjitha levave të pushtetit nga kuadrot e Partisë Përparimtare Serbe (SNS) së Vuçiqit.

Që nga zgjedhjet e vitit 2012, partia e z.Vuçiq (SNS) ka vazhduar ta zgjerojë kontrollin e tij mbi shoqërinë dhe institucionet. Ajo gëzon një shumicë absolute në Kuvendin Republikan dhe në Kuvendin e Krahinës Autonome të Vojvodinës. Në nivelin lokal dhe përmes lojës së aleancave, vetëm njëra nga 168 komunat e Serbisë (qyteti Shabac) shpëton ende nga kontrolli i plotë ose i pjesshëm të Vuçiqit.

Një ditë pas së shtunës të dytë të protestave, më 9 dhjetor 2018, kreu i shtetit bëri të ditur qëndrimin e tij të prerë: ai nuk do ta ndryshonte politikën e tij “edhe nëse pesë milion njerëz” dilnin në rrugë në një vend prej 7 milion banorësh.

Në mungesë të strategjisë, lëvizja protestuese nuk vonoi së zbehuri. Muajt e fundit, ajo tubonte vetëm një grup të vogël militantësh. Vuçiqi e bëri mjaltnin e tij nga ndarja e partive opozitare dhe nga besueshmëria e vogël që ato gëzonin në opinionin publik.

Ushtrimi i pushtetit nga partitë sotme opozitare në vitet 2000 u karakterizua me raste të shumta të korrupsionit, por edhe me tronditjen e krizës së vitit 2008 dhe masave shtrënguese të vendosura për Serbinë, veçanërisht nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Presidenti serb e di se mund të llogarisë në mbështetjen e “partnerëve” të tij, të cilët nga Federata Ruse në Shtetet e Bashkuara, nuk i japin asnjë rëndësi lëvizjeve protestuese opozitare.

U desh që partitë e opozitës të angazhohen bashkërisht për bojkotimin e zgjedhjeve parlamentare të pranverës

2020 që Bashkimi Evropian ta provoi një ndërmjetësim të kujdesshëm në tetor 2019. Por, misioni i drejtuar nga eurodeputeti demokristian gjerman David McAllister synonte më pak t'ia kujtonte regjimit të z.Vuçiq disa parime themelore të shtetit të së drejtës, e më shumë të bindte opozitën që të marrë pjesë në zgjedhjet që është pothuajse e sigurt se do t'i humb: qeveria ruan kontrollin hegjemonik mbi mediat publike, mbi tabloidët mediatik dhe televizionet private, të cilat i përkasin të gjitha oligarkëve të afërt me regjimin, por edhe mbi listat zgjedhore. Dhe zgjedhjet pa opozitë do ta jepnin një imazh të vobektë të Serbisë, e cila konsiderohet një nxënës i mirë në procesin e integriteteve evropiane. Serbia ka hapur negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian më 2013 dhe mund të jetë një nga anëtarët e ardhshëm të Bashkimit Evropian, me kusht që procesi i zgjerimit të mos jetë i ngrirë për kohë të gjatë.

Shtylla e stabilitetit rajonal

Gjatë vizitës së tij shtetërore në Beograd në korrik 2019, e para e një Presidenti francez që nga ajo e Jacques Chirac më 2001, z.Emmanuel Macron nuk pati asnjë kritikë publike për mikëpritësin e tij. Kjo mbështetje e çuditshme ndaj sundësit të ri të Beogradit nuk është ndonjë befasi në lidhje me biografinë e tij.

I lindur më 1971, z.Vuçiq fillon karrierën politike më 1993 në radhët e Partisë Radikale Serbe (SRS) të Vojislav Sheshelit, lideri i së djathtës ekstreme nacionaliste. Vuçiqi shquhet me deklaratat si ajo nga foltorja e Kuvendit të Beogradit më 20 korrik 1995, disa ditë pas masakrës së mijëra boshnjakëve në Srebrenicë: «Do të vramë një qind myslimanë për një serb të vvarë». Sot, ai thotë se kjo deklaratë ishte një «gabim rinor».

Ky kuadër i ri i së djathtës ekstreme e fitoi postin ministrit të informimit në qeverinë e unitetit kombëtar të formuar më 1998, me nxitjen e Presidentit Sllobodan Millosheviq, kur shpërthyen luftimet e para në Kosovë.

Pas rënies së Millosheviqit më 5 tetor 2000, SRS-ja e Sheshelit bëhet forca kryesore opozitare që i kundërshtonte udhëheqësit e rinj “demokrat” të Serbisë. Përderisa z.Sheshel burgoset nga Tribunali Penal Ndërkombëtare në Hagë (ICTY) më 24 shkurt 2003, për t'iu përgjigjur akuzave për krime lufte dhe krime kundër

njerëzimit, përgjatë konflikteve në Kroaci dhe Bosnje, dyshja e krijuar nga z.Vuçiq dhe z.Tomisllav Nikoliq udhëheqin partinë.

Asokohe, SRS-ja kundërshtonte drejtësinë ndërkombëtare dhe çdo përafrim të Serbisë me Bashkimin Evropian. Mbështetja e saj në popull rritej aq shpejt sa edhe zhgënjimi me demokratët në pushtet, të bllokuar nga konfliktet e brendshme dhe të paafte për ta ndryshuar me shpejtësi situatën politike, ekonomike dhe sociale.

Tomisllav Nikoliq dështoi për pak në rrethin e dytë të zgjedhjeve presidenciale në maj 2008, me 48% të votave kundër kandidatit demokrat Boris Tadiq. Në vitet 2000, kuadrot e SRS nuk pranoheshin ende në qarqet diplomatike perëndimore në Beograd. Franca është shteti i parë anëtar i BE-së që ua hap dyert e ambasadës së saj. Disa kontakte më të fshehta vazhdojnë duke i sugjeruar z.Vuçiq dhe z.Nikoliq të shkëputen nga mentori i tyre Sheshel dhe nga SRS-ja. Takimi vendimtar u zhvillua në Ritz në Paris, në nëntor 2008, në prani të kryeministrit malazez Millo Gjukanoviq i cili ishte vet dikur dishepull i Millosheviqit para se të bënte një pikë kthese pro-perëndimore më 1996.

Ndërmjetësues, si biznesmeni Stan-ko “Cane” Subotiq, ishin gjithashtu të pranishëm, siç e dëshmojnë disa dëshmitarë të drejtpërdrejtë. Disa ditë më vonë u shfaq një parti e re, si fraksion i SRS: Partia Përparimtare Serbe (SNS), një parti konservatore dhe pro-evropiane.

Në vitin 2012, kjo parti erdhi në pushtet duke bërë koalicion me Partinë Socialiste të Serbisë (SPS), përderisa z.Nikoliq u zgjodh President i Republikës. SNS-ja e fitoi vet shumicën e mandatave në parlament më 2014 dhe z.Vuçiq u bë Kryeministër. Në prill 2017, Vuçiqi pasoi “bashkëpunëtorin” e tij në krye të shtetit, duke u zgjedhur në rrethin e parë me 55% të votave.

Serbia është një sistem parlamentar ku pushteti ekzekutiv ndahet midis kreut të shtetit dhe kreut të qeverisë. Por, duke e ruajtur udhëheqjen e partisë, z.Vuçiq ndërton një sistem ku gjithçka kontrollohet nga ai. Në ndërkohë, z.Nikoliq e shfrytëzoi të drejtën e tij për pensionim.

Sa i përket z.Sheshel, ai u lirua përkohësisht për shkaqe shëndetësore më 2014. I liruar në shkallë të parë nga Haga në mars 2016, Shesheli u dënua në shkallë të dytë të apelit në

Mos u dashuro me pushtetin as nga karantina

Fjala kyçe në këto kohë të vështira është gjithmonë SOLIDARITET (gjithmonë kam qenë kurioz çka mendon Edi kur përmend këtë fjalë). Deri tani në fakt nuk kemi parë asnjë nismë “solidare”, por vetëm një grusht rregullash, që ndalojnë njerëzit të dalin nga shtëpitë e tyre. Nëse do donim vërtet të ishim solidarë do diskutonim si do rimbursuonim punën e atyre, që punojnë në të zezë, që janë shumë e do jenë më të prekurit.

NGA LEART KOLA*

Që në krye të herës, dua të theksoj, që nuk besoj në teoritë konspirative, në të cilat “fatkeqësitë” prodhohen nga njerëz okulte për t'i kontrolluar popullatat. Kapitalizmi konsumist na ka mësuar, që nuk ka nevojë për llozha sekrete apo urdhëra të fshehtë, mjaftojnë supermarketet për të na vënë të gjithë në rresht për një, si në ushtri. Megjithatë, historia politike na mëson që në rastet e goditjeve të forta shoqërore, qofshin ato luftëra, pandemi globale, apo dhe përmbajtje apokaliptike, vetë njerëzit kanë shtyrë një sistem drejt autoritarizmit. Në fund të fundit siç do thoshte dhe Hannah Arendt: “Çdo organizim njerëzor qoftë ai social apo politik, ndërtohet mbi bazën e aftësisë së njeriut për të dhënë e mbajtur premtime”. Demokracia është në vetvete një marrëdhënie dakordësimi për respektimin e një premtimi, që i kemi dhënë njëri-tjetrit për ta ruajtur të paprekur parimin e funksionimit institucional të demokracisë, sidomos në kohët kur trafiku në qytet rregullohet me ushtarë të armatosur.

Ditët e karantinës, mund të jenë një kohë e mirë për reflektim, sidomos për të ardhmen e përbashkët politike dhe sociale. Njerëzit, deri tani janë të thirrur të marrin pjesë në një cirk imazhesh, kjo bëhet dhe më lehtë kur ata janë të izoluar individualisht. Gjendja e panikut, që stimulohet dhe më shumë nga komunikimi zyrtar, që bërtet “pa panik” nga kanalet e komunikimit, kujdeset që kjo kohë të kalojë pa nxjerrë mesime të rëndësishme për situatën, që po jetojmë, por vetëm të besojmë në atë që na thuhet dhe të lajmë duart. Kaq. Ku ka më bukur, përgjegjësia e qytetarëve në demokraci, qenka të rinë në shtëpi dhe të lajnë duart, mos të flasin se kështu përhapin panik, e kryesisht të degojnë dhe të binden... Mbase është e drejtë, por nuk mund të rri pa menduar Camus kur thotë “rezistenca ndaj padrejtësisë (lexo propagandës) është i vetmi akt që i bën mirë shëndetit mendor të individit”. Në këto kushte, një informim pak më i specializuar se komunikimet e sikletshme të Ramës, që kumton vendime nëpërmjet selfieve nga shtëpia e tij si një BABA-PADRON, që prekin thelbin e demokracisë, është imperative nëse jemi duke komunikuar për të mirën e përbashkët.

PRIVATIZIM I PRONËS

Në fakt dhe përtej aktualitetit të koronavirusit, mandati i dytë i Ramës, më shumë se qeverisje, ka qenë një koleksion krizash. Disa prej tyre kanë qenë institucionale, si dalja e opozitës nga parlamenti dhe bojkotimi i zgjedhjeve lokale, disa të tjera kanë qenë kriza sociale, si protesta e



studentëve, apo ajo e banorëve të Unazës së Re, të cilët kundërshtojnë projektin e zgjerimit të rrugës dhe kompensimin e qeverisë. Të tjera dhe më tragjike kanë qenë ato natyrore, si tërmeti i shtatorit të 2019-ës dhe ai vdekjeprurës i nëntorit të po atij viti që shënoi mbi 50 viktima. Në mes të debatit për rindërtimin pas tërmetit, ja edhe kjo pandemi globale, që godet jo pak dhe Shqipërinë, shpresojmë me sa më pak viktima.

Sado të ndryshme të kenë qenë këto kriza, që janë përplasur mbi qeverinë nga studentët tek banorët e unazës, nga tërmeti tek punëtorët, përgjigja e qeverisë ka qenë gjithmonë e njëjta: PRIVATIZIM i pronës apo parasë publike në formën e tenderi apo PPP. Ça e bën dhe më dëshpëruese këtë “përgjigje” për të gjithë problemet është edhe fakti se zakonisht kjo zgjidhje është dhënë në kushte emergjence.

Kriza e universitetit, e cila prodhoi protestën më të madhe studentore, për ta kundërshtuar favorizimin, që qeveria socialiste i bën strukturave private universitare duke rritur tarifën e studimit në publik u mbyll me një PPP 120 milion euro, që do ndërtoi kampusin universitar. Paradoksalisht, ajo çfarë ishte protesta e parë në historinë e Shqipërisë në mbrojtje të publikes i shërbeu privatit për të tërhequr shifrën më të lartë të dhënë ndonjëherë nga një qeveri dhqiptare.

Tërmeti, një tjetër katastrofë, që angazhoi jo vetëm Shqipërinë, por dhe shumë vende të tjera në ndihmë të familjeve u përmbyll në një natë tragjikomike ku zbuluam emocionet dhe dashurinë

e Edit për Botën, por asnjë informacion më shumë për kushtet me të cilat u mor kjo shifër. Sidoqoftë, edhe pse nuk e dimë si u mor e kuptuam qartë se si do të shpenzohet, për çudinë e askujt me një TENDER. Paradoksi i dytë është që si në rastin e studentëve, “heronjtë” ishin ata që punonin për “publikën” dhe përfitimet më pas i kanë ata që kanë prioritet aktivitetin personal privat të kompanive, që do përfitojnë nga këto tendera. Vlonjati që u shpall hero publikisht, sepse me duart e tij shpëtoi tre jetë nuk ia doli që një pjesë të fondeve t'i çonte edhe për institucionet publike të zjarrfikësve apo policies. Ato do shpenzohen në bashkëpunim me privatën.

Deri tani në fakt nuk kemi parë asnjë nismë “solidare”, por vetëm një grusht rregullash, që ndalojnë njerëzit të dalin nga shtëpitë e tyre. Nëse do donim vërtet të ishim solidarë do diskutonim si do rimbursuonim punën e atyre, që punojnë në të zezë, që janë shumë e do jenë më të prekurit.

PLANI (JO)SOLIDAR

Kur je në karantinë ke kohë të mendosh e sidomos të kujtosh kohën kur qeveria socialiste erdhi me premtimin e një shëndetësie falas, universale dhe publike. Por, në fakt ishte sektori i parë ku u aplikua doktrina e shokut ekonomik nëpërmjet privatizimit masiv, të shprehur jo vetëm në favorizimin e paturpshëm të spitaleve private, që në shumicën e rasteve edhe fizikisht gjenden në hapësirat e spitaleve shtetërore (të cilët këtë bujari e shkëmbyen me lajmërimi publike, që ndalonin rreptësisht mjekët e tyre të vizitonin të sëmurët në kohën e pandemisë, ku u desh më pas ndërhyrja me një rregull special nga ana e qeverisë, që ata me pahir të vendosnin hapësirat e tyre në funksion publik), por mbi të gjitha me një privatizim selektiv nëpërmjet formës së partneritetit publik-privat. Teori kjo e dështuar, që në kohën kur kryeministri ynë ishte akoma i ri dhe Margaret Thatcher idhtarja e kësaj forme e të bërit ekonomi-politike të vjetër.

Nuk e di sa po mendonin për këtë ata që dolën mbrëmë (14 Mars në orën 17:30) në ballkon për t'i duartrokitur mjekët heronjë (të spitalit publik) që janë në linjën e parë të rrezikut?

Fjala kyçe në këto kohë të vështira është gjithmonë SOLIDARITET (gjithmonë kam qenë kurioz çka mendon Edi kur përmend këtë fjalë). Deri tani në fakt nuk kemi parë asnjë nismë “solidare”, por vetëm një grusht rregullash, që ndalojnë njerëzit të dalin nga shtëpitë e tyre. Nëse do donim vërtet të ishim solidarë do diskutonim si do rimbursuonim punën e atyre, që punojnë në të zezë, që janë shumë e do jenë më të prekurit. Mund të mendonim se si do t'ia bëjmë me energjinë elektrike apo ujin, që duhet të paguajnë njerëzit të cilët janë të detyruar me urdhër të rinë në shtëpi? Nëse nuk mundemi për të gjithë,

të paktën për shtresat në nevojë, le ta ndajmë të gjithë këtë kosto, meqë jemi solidarë. Por nëse dhe kjo nuk bëhet, të paktën, të mos shtohen kostot me kamata për mungesë të pagesave, sepse kjo do ishte vërtetë absurde. Ditën e parë, që u shpall karantina, kafet ishin bosh, por rradhët për të paguar ujë e drita ishin plot. U fol për kreditë në një formë të ndrojtur, çka bëhet me kreditë? Do i shtymë? Nëse kalon afati i pagesave, banka ka të drejtë ta marrë pronën tënde, por nëse qeveria të kërkon ose me saktë të urdhëron të rrish brennda, atëherë si zgjidhet kjo punë?

Çfarë plani ka qeveria solidarë për taksat, tatimet, humbjet, që familjet e varfra e të vetëpunësuarit, ata që punojnë me medijtë, biznesi i vogël dhe i mesëm ka në këto kushte? Të paktën të kenë të njëjtin trajtim si biznesi i madh për dividendin, ku qeveria dhe Partia Socialiste e bën natën-ditë për ta plotësuar kërkesën e tyre. Këto janë disa shqetësime të hedhura aty, pa u menduar shumë, por jam i sigurtë, që kjo situatë prodhon dhjetra pyetje të kësaj natyre, të cilat presin përgjigje.

Nuk do ulesha për të shkruar këtë artikull, nëse në fakt nuk do dëgjoja një komunikim të Edit, siç i pëlqen atij ta thërrasin, kur i bënte thirrje popullit të mos hante shumë dhe të bënte yoga në mëngjes. Ai në fakt është treguar i sinqertë e ka vite që na lajmëron mbi faktin se nuk lexon më gazeta dhe nuk sheh më televizor. Që gjithçka që di për jetën publike në Shqipëri ja komunikojnë punonjësit e tij në mënyrë të përmbledhur, por kjo është vërtetë të jesh totalisht i shkëputur nga realiteti që qeveris. Problemi i mbiushqimit nuk ekziston për 1/20 e banorëve të Shqipërisë (dhe këtu po tregohem pro-qeveritar). Në fakt ekziston problemi i kundërt, mungesa e tij. E sa për yogan, nuk e kam idenë për çfarë po flet.

*Autori është drejtor i Institutit të Studimeve Sociale dhe Humane në Tiranë

TËRHIQET UASHINGTONI, MOSBESIM NË TREGJET FINANCIARE

E djathta latino-amerikane në qorrrokak

Për një kohë të gjatë, konservatorët e Amerikës Latine kërkuar ngushëllim në teorinë e cikleve. Pas fazës së dominimit të së majtes, mendohej një tjetër fazë që do t'u ofronte mundësi për ta shtjelluar programin e tyre. Por, ndonjëherë realiteti ndryshon nga teoria. E kthyer në pushtet në disa vende të rajonit, e djathta liberale kërcënohet nga kundërshtimet e shumta.

NGA RENAUD LAMBERT

Në vitin 2016, revista ekonomike meksikane *Expansión* psherëtinë nga lehtësimi: «Amerikë Latine: lavjerrësi kthehet në të djathtë». Argjentina sapo zgjedhi biznesmenin Mauricio Macri; industrialisti Pedro Kuczynski vendoset në pallatin presidencial në Peru dhe në Brazil, z.Michel Temer arriti ta largoj Partinë e Punëtorëve nga pushteti. Shpejtë, kampi konservator zgjerohet edhe mëtej: në vitin 2017, në Ekuador me përmbysjen e Lenin Moreno i cili ishte zgjedhur me premtimin se do ta vazhdonte politikën e majtë të paraardhësit të tij Rafael Correa, por që bëri të kundërtën. Dhe në vitin 2018, me zgjedhjen e biznesmenit kilian Sebastián Piñera.

E djathta latino-amerikane frymon siguri për një kohë. Gjatë fushatës që

e solli z.Macri në pushtet, një gazetar e pyeti atë në lidhje me inflacionin: si do të planifikon të luftojë kundër kësaj të keqeje që ç'rregullon shpesh ekonominë lokale? Kandidati shikon në qiell me një psherëtimë të gjatë: ai do të preferonte një pyetje më të denjë për aftësitë e tij. Më në fund pranon të përgjigjet: “Inflacioni është demonstrim i paqftësisë për të qeverisur. Gjatë presidencës time, as nuk do të flitet për të». Katër vjet më vonë, Buenos Aires shënon nivelin më të lartë të erozionit monetar në Amerikën Latine pas Venezuelës (më shumë se 50% në vitin 2019). Varfëria është në rritje, borxhi jashtë kontrollit, rritja ekonomike në gjysmë-shtizë. Gjatë zgjedhjeve të vitit 2019, z. Macri duhet ta dorëzojë shallin presidencial pas konstatimit të dështimit.

“Qeveri e luksit”

Situata nuk është për t'u lavdëruar as në vendet e tjera. Ekuadori, Kili, Kolumbia, Bolivia: disa vjet, nganjëherë disa muaj, pas marrjes së detyrës, udhëheqësit konservatorë përballen me protestat më të mëdha në historinë më të re të Amerikës Latine, protesta të cilat shquhen nga mobilizimi i fraksioneve të mëdha të klasës së mesme. Në pamundësi për ta shuar zjarrin, pushteti përgjigjet me një valë represive të cilën nuk e kishte përjetuar rajoni që nga fundi i diktaturave. Në Kolumbi, pas demonstratave të 21 nëntorit 2019, presidenti Iván Duque vendosi orë policore në Bogotá dhe në Cali. Në Ekuador, më shumë se një duzinë njerëzish vdiqen nga dhuna e forcave të rendit midis 3 dhe 13 tetor 2019. Që nga rrëzimi i z.Evo Morales në nëntor 2019, ushtarakët dhe policët kontrollojnë qytetet kryesore të Bolivisë. Në Kili, ka pasur kaq shumë raste vdekjesh, torturash dhe përdhunimesh nga forcat e armatosura, sa që është hapur një hetim kundër z. Piñera për krime kundër njerëzimit. Dhe qetësia nëpër rrugët e Brazilit shpjegohet më pak nga entuziazmi i vendit për politikën e kursimit të imponuar nga presidenti Jair Bolsonaro, sesa nga vendimi i qeverisë për t'i dhënë imunitet ushtarakëve që hapin zjarr ndaj protestuesve të mundshëm.

Si të shpjegohet një katrahurë kaq e shpejtë? Për z.Piñera, çështja është e qartë: “Një dorë e huaj po punon” (26 dhjetor 2019). Nuk ka nevojë të tregohet cila dorë: sikur ta mbante një gotë, ajo do t'ishite e mbushur me vodkë. Në janar 2020, Departamenti i Shtetit e forcon këtë analizë dhe publikon dokumente që sugjerojnë se

agjentët rusë po punojnë në destabilizimin e rajonit, veçanërisht përmes Twitterit. New York Times, që nuk njihet zakonisht për rusofili, shpërfaq dyshimet e saj: “Analizat e bëra (...) nuk tregojnë se llogaritë e internetit që nxiten mobilizimet në Amerikën latine janë të lidhura me qeverinë ruse”.

Amerika Latine i përngjan më shumë një bregdeti nga i cili deti do t'ishite tërhequr se një kukulleje, spangot e të cilës fillojnë në Moskë. Në mesin e viteve 2000, në një kontekst të rritjes së fortë ekonomike kineze, qeveritë progresive përfituan nga përmbytja e likuiditetit. E fuqishme, vala i mbuloi antagonizmat shoqërore, pa i mënjeluar ato. Deti ngritej, duke i larguar të gjitha anijet; disa ngriteshin për herë të parë.

Pabarazia? Në një raport të botuar në vitin 2014, organizata joqeveritare Oxfam vuri në dukje se pasi kishin arritur nivelin më të lartë në vitin 2000, “pabarazitë pësuan ulje midis viteve 2002 dhe 2011” falë veprimt të qeverive “që favorizuan masa progresive, siç janë rritja e shpenzimeve publike për shëndetësi, arsim, pensione, asistencë sociale, punësim dhe mbrojtje të pagës minimale”. Dhe për të përfunduar: “Përvoja e Amerikës Latine tregon se ndërhyrja publike mund ta ketë një ndikim vendimtar në pabarazi.”

Në të njëjtën kohë, *Financial Times* organizon një pritje në Lancaster

Zbatita ndodhi pesëmbëdhjetë vjet më vonë. Ulja e kërkesës për lëndë të parë shkaktoi uljen e ujërave, e cila u përshpejtua mëtej nga politikat e kursimit të së djathtës. Pak nga pak u shfaqen dy përbindësia. Askush nuk e injoronte ekzistencën e tyre edhe kur e majta ishte në pushtet; por në kohë të bollëkut ishin të fshehur në sipërfaqe. Emri i tyre? “Korrupsioni” dhe “pabarazia”, dy fjalë në gojën e të gjithë protestuesve.

Korrupsioni? Në Brazil, grushtshteti parlamentar i orkestruar nga e djathta tradicionale për ta shkaktuar largimin e presidentes Dilma Rousseff në vitin 2016 spërkati të gjithë klasën politike dhe lehtësoi zgjedhjen e z.Bolsonaro. Megjithatë premtimin e tij për t'i zhdukur malverzimet e jetës politike të vendit, kalorësi i bardhë i së djathtës ekstreme ngarkohet për afëra të ndryshme.

Në Peru, z.Kuczynski i cili e kishte quajtur ekipin e tij “qeveria e luksit” dha dorëheqje në vitin 2018 pas shumë skandaleve. Tani, ai lëngon në burg, me fatin e njëjtë sikurse paraardhësi i tij Ollanta Humala (2011-2016) për të njëjtat arsye. Një fat që arrihen ta shmangnin dy presidentet e mëparshëm peruan, Alejandro Toledo (2001-2006) duke u arratisur dhe Alan García (2006-2011) duke bërë vetëvrasje.

Shah-mat

Palace, në Londër, për ta kremtuar një pikë kthese të kohës: lindja e Aleancës së Paqësorit që përbashkon Kilin, Perunë, Kolumbinë dhe Meksikën (e qeverisur nga krahut e djathtë) rreth një programi i cili evokon një libër të shenjtë neoliberal të viteve 1990. Në tribunë, gazetari John Paul Rathbone përmban me vështirësi kënaqësinë e tij: “Derisa disa shtete e kanë varrosur konsensusin e Uashingtonit në rajon, disa vende tjera guxojnë t'i thojnë “stop” (...) dhe të angazhohen sërish për mosndërrhyrjet e shtetit”. Pjesëmarrësit ekspozojnë projektet e tyre sikurse recitohen lutjet: hapja e ekonomisë, heqja e tarifave doganore, integrimi i qendrave financiare. “Si gazetar”, përfundon Rathbone,

“rrallë kam pasur mundësi të marrë pjesë në një konferencë për Amerikën Latine, ku njerëzit ndajnë arsyen e besimeve të tyre liberale. Pa dyshim se ky është një zhvillim që duhet të na gëzojë.”

Disa vjet më vonë, premtimet e Lancasterit drejtojnë politikën qeverisëse në shumicën e vendeve. Ministri brazilian i ekonomisë Paulo Guedes, një ish-tregtar, synon të përfitojë nga zgjedhja e z.Bolsonaro në vitin 2018 për ta “përhapur në vendin e tij fuqinë e ideologjisë së tregtisë së lirë, të cilën e ka studiuar në Universitetin e Çikago-së në vitet '70”. Duke e komentuar veprën e gjeneralit kilian Augusto Pinochet në rrafshin ekonomik, ai shpjegon: “Ka qenë një transformim i mrekulueshëm. (.) Thatcher dhe Reagan e kishin kuptuar mirë.”

Problemi i vetëm: Presidenti i Shteteve të Bashkuara nuk quhet më Ronald Reagan, por Donald Trump. Kritika ndaj tregtisë së lirë ishte një nga pikat kryesore gjatë fushatës që e solli atë në pushtet. Kur thotë “Amerika e para”, ai nuk flet për rajonin, por për Shtetet e Bashkuara. Më 2 dhjetor 2019, një nga tweetet e tij shkatërroi shpresat e oborrtarëve të tij të jugut: “Brazil dhe Argjentina bëjnë prej ca kohësh zhvlerësime masive të monedhës së tyre, gjë që nuk është e mirë për fermerët tanë. Prandaj, kam vendosur t'i rivendos tarifën për çelikut dhe aluminin që Shtetet e Bashkuara importojnë nga këto vende. Me efekt të menjëhershëm». Konservatorët e Amerikës Latine po prisnin gomë shpëtimi; z.Trump i fundosi.

Sa i përket tregjeve financiare, simpatia që kanë a priori për liderët liberalë zhduket sapo kërcënohen interesat e tyre. Kështu, mund të pritej nga investitorët që të lehtësojnë jetën e z.Macri duke ujtur ekonominë argjentinase të kapitalit kur rrezikoi të thahej nga viti 2017. Por, në bursë, ideologjia ka më pak rëndësi se kthimi i investimeve: kur biznesmeni në pushtet ndikon të humbni para, asgjë nuk e dallon atë nga një sindikalist i thjeshtë. Pa mbështetjen e Uashingtonit apo Wall Street-it, kutia e veglave liberale rezulton papritmas të jetë boshe.

Midis viteve 2014 dhe 2020, Amerika Latine regjistroi normën e saj më të ulët të rritjes që nga viti 1950: 0.5%, kundrejt rreth 2.5% në vitet '80, që njihen si “dekada e humbur”. Ndërsa popullsia vazhdon të rritet, pasuria për kokë banori zvogëlohet për 4% midis viteve 2014 dhe 2019. Varfëria rritet, pabarazitë fillojnë të rriten përsëri dhe bie standardi i jetesës së klasës së mesme që u formua në vitet 2000.

Por nuk mjafton errësimi i treguesve ekonomik që të harrojnë njerëzit. “Përparimet sociale-edhe pse shpesh të moderuara, gjatë qeverive progresive dhe të majta, paraqesin një problem të madh për të djathtët tani në fuqi”, thotë historiani brazilian Valter Pomar. Prandaj, sigurisht, ndodh kalimi në anën tjetër të klasës së mesme, e cila papritmas kërcënohet nga humbja e statusit të saj. “Në vitet 1990, udhëheqësit konservatorë e kishin shyer klasën e mesme (që nuk ishte viktimë e parë e neoliberalizmit) ta pranojë atë duke i shpjeguar se ishte një hap i nevojshëm për demokratizimin e një rajoni që ishte duke dalur nga diktatura”, thotë Pomar. Me pak fjalë, kutitë e votimit për ne, bistoritë për të tjerët. “Por situata ka ndryshuar. Sot, neoliberalizmi jo vetëm që i zhyt të gjithë në varfëri, por nuk ka më asgjë për të ofruar». Bistoritë u shndërruan në hanxharë, kutitë e votimit në shkopinj.

A duhet të konkludojmë se partitë e majta do të përfitojnë nga kriza aktuale? Asgjë nuk është më pak e sigurt: në rrugë, protestuesit thërrasin më shumë parulla «largimesh» se *Internacionalen*. Prandaj Amerika Latine gjindet në një situatë ‘shah-mat’. Në krahun e djathtë, trashëgimtarët e një neoliberalizmi të vjetruar, ekonomikisht të paefektshëm dhe pa legjitimitet. Në krahun e majtë, grupime ndonjëherë të diskredituara nga skandalet e korrupsionit, shpesh të rraskapitura nga ushtrimi i pushtetit dhe në përgjithësi të akuzuara se duke u përpjekur ta ndryshojnë botën pa guxuar vërtetë ta trondisin atë, ngjallën po aq zhgënjime sa shpresë.

Por parti të majta të udhëhequra nga rruga? Situata mund të duket shpresëdhënëse. Duke komentuar telashet e regjimeve, të cilat i ka kundështar, sekretari i parë i Partisë komuniste kubane Raúl Castro thotë: “Rajoni duket si një fushë e thatë. Shkëndija më e vogël mund ta shkaktoj një zjarr i cili do t'i kërcënohet interesat kombëtare të të gjithëve”.

Në Bolivi, si dhe përmes disa shtresave të qeverisë së z.Bolsonaro, sapo ka dalur në sipërfaqe e djathta që kishte qëndruar e heshtur deri tani. Ultrafetare, reaksionare, anti-intelektuale. Vizioni i saj i botës përkon me respektin për shkrimet e shenjta. Nevoja për ta bindur popullsinë për virtytet e tregut është lërë anash: tani çështja është gjuetia e heretikëve. Përdorimi i forcës nuk është më një pranim i dobësisë, por një metodë për ta rivendosur rendin, për t'i pas-truar stallat e Augias. Një rrymë që bartë ide të ngjajshme, sapo ka fituar zgjedhjet legislative në Peru. Vallë do të kthehet ky sistem agonik i cili prodhon pabarazi dhe korrupsion kah fanatikët e tillë për të siguruar mbijetesë?

© José Damasceno - Courtesy Thomas Dane Gallery, Londër



PANIKU NË MESIN E ANALISTËVE AMERIKANË

Klithmat kundër Bernie Sanders

Gjatë garës për kandidaturat në zgjedhjet presidenciale amerikane, rezultatet e mira të z.Bernie Sanders, përkrahës i “socializmit demokratik”, shkaktuan befasi në establishmentin e Partisë Demokratike që po lufton për ta nxjerrur një kandidat shumë më të moderuar. Establishmenti mund të llogaris në armiqësinë e mediave kundër senatorit Sanders.

NGA JULIE HOLLAR*

Paniku shpërtheu në mediat kryesore në Shtetet e Bashkuara, që nga fillimi i zgjedhjeve për kandidaturën e Partisë Demokratike. Në New York Times, ekonomisti dhe kolumnisti Paul Krugman risolli një praktikë të përdorur më 2016, e cila barazon kandidatin “demokrat socialist” Bernie Sanders dhe z.Donald Trump. Po aq të shqetësuar sa demokratët konservatorë dhe centristët janë edhe republikanët neokonservatorë, ithtarë të luftërave perandorake dhe të “gjithçka tjetër përveç Trump”.


“Bernie nuk mund të fitojë”, shkruan David Frum në *The Atlantic* (27 janar, 2020). “Fushata ‘à la Trump’ e Bernie Sanders është shkatërruese për demokratët”, pohon Jennifer Rubin nga *Washington Post* (27 janar 2020). Think tanku blerist Third Way i financuar nga Wall Street është shumë i angazhuar, me mbështetjen e medias, për ta frenuar ngritjen e Bernie Sanders.

Ai dërgoi një “paralajmërim” për votuesit e Iowa: «Për shkak të neglizhencës së mediave, nuk keni parë ndonjë analizë të vërtetë të së kaluarës dhe ide rë rrezikshme të kandidatit në krye të sondazheve.» Pasi një listë e gjatë e sulmeve që zoti Trump mund të përdorte kundër zotit

Sanders; një listë e hartuar më lehtë pasi anëtarët e këtij think-tanku ndajnë me republikanët shumë kritika drejtuar kandidatit demokrat, veçanërisht për faktin se ai pretendon se është socialist dhe se propozimi i tij për sigurime shoqërore në vend të sigurimeve private (“Medicare for all”) do të ishte jopopullor.

Mediat shtrinë tepihun e kuq për sulme ndaj Sanders. *Washington Post* së fundmi i besoi Third Way një faqe nga rubrika e saj e “opinioneve” në mënyrë që të mund të përhapte tezën e saj se “programi i Bernie Sanders e bën atë krejtësisht të pazgjedhshëm” (15 janar 2020).

Po kështu, *USA Today* hapi rubrikat e tij: “Demokratët po luajnë me zjarr duke e mbështetur Bernie Sanders. Idetë e tij mund ta frikësojnë elektoratin e moderuar i cili do të vijë në peshorë” (29 janar 2020). Think Tanku kontribuoi gjithashtu në shkarkimin e fundit të artikujve të qendrës, të nënshkruar edhe nga z. Rahm Emanuel, ish-këshilltar i afërt i z.Barack Obama në Shtëpinë e Bardhë, apo nga z. James Carville, strateg i fushatës elektorale fitimtare të z.William Clinton në 1992. Burimet e establishmentit bëjnë pretendime të pabaza që gazetarët ribotojnë pa komente.



“KËMISHAT BRUNE”

Shpesh e gjejmë idenë që z.Sanders i ka shpëtuar kritikës dhe kontrollit të rreptë nga kundërshtarët e tij dhe gazetarët. «Është më në fund koha të zgjohen demokratët dhe që mediat të fillojnë me bërë punën e tyre duke kundërshtuar një pretendent serioz për presidencën», thotë Matt Bennett nga Third Way. Në *Politico*, ai madje thotë: «Mediat e lejojnë të mbizotërojnë pa ndëshkueshmëri.

E lëjnë t'i shmanget pyetjeve të vështira.»

Me këtë lloj përfundimi nuk pajtohen megjithatë të gjithë edhe në redaksitë e lajmeve. *Washington Post* botoi dy artikuj në të njëjtën ditë duke nxjerrë përfundime të kundërta: “Bernie Sanders përballet me ofansivën e rivalëve” dhe “Rivalët e Sanders nuk e pengojnë shumë rrugëtimin e tij” (26 janar 2020).

Në të dytën, David Weigel shënonte se disa kritika nuk kishin ndikuar shumë: shumë votues “qëndruan të pandikueshëm” kur z. Joseph Biden dhe senatorja e moderuar e Minesota, znj. Amy Klobuchar, akuzuan z. Sanders se po e “vë në dyshim trashëgiminë e Obamës”.

Dhe Weigel sqaron: “Të gjithë rivalët e Sanders marrin kohë, ndonjëherë me kërkesë të votuesve të shqetësuar, për të shpjeguar se si do t'i financojnë projektet e tyre pa e flakur buxhetin. Nuk bëjmë kështu lloj pyetjesh për Sanders. Ai kalon muaj me radhë në sallat e komunave duke i kërkuar votuesve të flasin për problemet e tyre, për shpenzimet e tyre të kujdesit

shëndetësor, borxhin e tyre studentor, për të shpjeguar se vetëm padrejtësia e politikave ekonomike është burimi i të gjitha këtyre problemeve.”

Siç e vuri në dukje David Sessions, “ideja që Sanders po lundron drejt një fitoreje të garantuar në zgjedhjet për kandidim, pa pasur përballë askë dinjitoz që t'i parashtrijë pyetje në lidhje me bilansin e tij ose pranueshmërinë e tij, është një gjurmë e zgjedhjeve për kandidim të vitit 2016, kur Hillary Clinton dhe përkrahësit e saj acarroheshin që ai mbeti kaq gjatë në garën për kandidaturën e demokratëve. Sipas tyre, popullariteti i Sanders ishte vetëm një mirazh për shkak të mungesës së analizave kritike “(The New Republic, 28 janar 2020).

Në realitet, kandidati ishte subjekt i vëmendjes së vazhdueshme dhe i armiqësisë së pakursyer të mediave katër vjet më parë, gjatë zgjedhjeve të fundit të demokratëve, kur ai përballej me znj.Clinton.

Një tjetër kënd sulmi është të diskreditohet fushata e tij duke pretenduar se mbështetësit e tij janë kryesisht burratë bardhësek-sistë dhe veçanërisht agresivë >>



« në rrjetet sociale. Kjo kritikë, e lindur edhe gjatë fushatës 2016, vazhdon pavarësisht mungesës së argumenteve përtej anekdotave.

Gazetarët, si pothuajse të gjithë, e dinë që Interneti është plot me gjuhë të urrejtes nga të gjitha palët, jo vetëm nga një nëngrup i vogël i mbështetësve të senatorit Sanders. «Çdo opinion polemik i shprehur në internet, rikujtoje më 2016 gazetari Glenn Greenwald, për shembull një kritikë ndaj tenorëve të Partisë Demokratike si Hillary Clinton dhe Barack Obama, do të çojë në mënyrë të pashmangshme në një përmytje zemërimi dhe fyerjesh...Të pretendosh se sjelljet fyese ose mizogjene janë karakteristika të veçantë e simpatizuesve të Sanders është një gënjeshtëri dhe manipulim (The Intercept, 31 janar 2016). Një studim i botuar në mars 2016 madje tregonte se mbështetësit e z.Sanders perceptoheshin si më pak “agresivë dhe kërcënues në internet” (16%), se ata të znj.Klinton (30%) dhe shumë më pak se ata të z.Trump (57%).

Sidoqoftë, mediat i përmbahen eshtrave të tyre. Më 27 janar, *New York Times* ia kushtoi ballinën një hetimi të ndjekjes penale: “Bernie Sanders dhe ushtria e tij në internet: në fillim të fushatës së tij për vitin 2020, senatori i Vermontit i kujtoi përkrahësve të tij se ai dënonte sjelljet agresive. A është faji i tij nëse shumë prej tyre nuk e dëgjojnë?” (27 janar 2020).

Sipas të përditshmes, kandidati kishte ushqyer “helmin” e mbështetësve të tij. Deklarata të tilla si: “Unë nuk shkoj në Hamptons [një zonë e pasur periferike ku jeton borgjezia e Nju Jorkut] për të mbledhur para nga miliarderët”. Disa ditë më parë, *Daily Beast* (22 janar 2020) titulloi: “Përkrahës të rinj meshkuj të Bernie janë të egër, arrogantë dhe po e dëmtojnë fushatën e Sanders”.

Në një rast të ngjashëm, NBCNews i barazoi ata me aktivistët pro-Trump: “Ata kanë një taktikë të famshme të përbashkët: *Militantët e Sandersit veprojnë duke pretenduar se janë progresistët e vërtetë të Internetit. Por taktikat e tyre të ngacmimit janë gjithçka përpos progresiste*” (19 janar 2020).

Këto artikuj të njëanshëm ngrisin pa dallim kërcënime me vdekje dhe shembuj të fyerjeve që nuk janë vërtet

të këqija. Kështu, *New York Times* përfundon aktakuzën e tij me këtë “provë”: «Ju milionerët duhet të kuptoni se shumë prej nesh kanë vërtet nevojë që Bernie Sanders t’i fitoj këto zgjedhje presidenciale, thotë një mbështetës i z.Sanders. Ne nuk mund të rrimë të qetë». Ose, lidhur me disa karrige që dyshohet se u rrëzuan gjatë një tubimi në Nevada: «Dhuna është shmangur, siç duket, por pati disa mosmarrëveshje të vogla». Nuk i duhet më shumë gazetarit yll të NBC për t’i krahasuar aktivistët e senatorit Sanders me “këmishat brune”.

Zonja Hillary Clinton zbriti po ashtu në arenë e armatosur deri në dhëmbë. Në *Hollywood Reporter* (21 janar 2020) i cili e pyeti nëse ajo do ta mbështeste z.Sanders nëse ai fitonte kandidaturën, ajo dha një përgjigje duke sugjeruar që ajo do të bënte çdo gjë për ta kundërshtuar një hipotezë të tillë: «Nuk do të thellohem për momentin. Ne jemi akoma në një fazë shumë dinamike të kandidaturave. Unë do të thoja, megjithatë, se nuk bëhet fjalë vetëm për të, por për kulturën që e rrethon. Ekipën e tij. Mbështetësit e tij potencial. Përdoruesit e internetit që e mbështesin atë dhe sulmet e tyre të vazhdueshme kundër shumë kundërshtarëve të tij, veçanërisht grave ... Unë mendoj se nuk është në interesin tonë të biem në të njëjtin kurth, gjegjësisht të bëjmë fushatë duke ofenduar dhe sulmuar. Ndoshta përpigjeni të distancoheni nga kjo, por ose nuk e dini se çfarë po bën ekipi juaj dhe mbështetësit e fushatës, ose ju mbyllni syrin dhe dëshironi të sulmohen Kamala [Harris, senatore nga Kalifornia që hoqi dorë nga kandidimi i saj] ose Elizabeth [Warren]. Unë mendoj se kjo është një sjellje për t’u marrë parasysh kur merrni vendimin tuaj.»

Menjëherë në *Washington Post*, Jennifer Rubin rrëmbeu këtë citim për të pretenduar se z.Sanders kishte një “makinë lufte” të ushqyer nga një “mizogjeni që po zbulohet” e cila «po kthehet në mbështetje» (21 janar 2020).

“Makina e vërtetë e luftës” nuk është ajo - imagjinare - e vendosur nga senatori Sanders për t’i rrëzuar kundërshtarët e tij, por ajo që po e ngrit elita e demokratëve dhe lidhjet e tyre të shumta në media, me qëllim të eliminimit të tij. Pa sukses, për momentin.



Fushata anti-Sanders e mediave mainstream

Gjashtëmbëdhjetë artikuj armiqsor ndaj z.Bernie Sanders në gjashtëmbëdhjetë orë! *Washington Post* do ta ketë të vështirë të përputhet me performancën e tij të katër viteve më parë. Që nga ajo kohë, kandidati i së majtës amerikane nuk ka bërë asgjë për ta fituar simpatinë e mediave. Ata e urrejnë, ai e di. Madje edhe bën shaka.

Këto ditë, në mënyrë rituale, ai pyeti mbështetësit e tij: «A e dini sa tatime ka paguar Jeff Bezos vitin e kaluar?». «Zero!», përgjigjen ata, në një këmbim përsosmërisht të rrjedhshëm. Senatori Sanders vazhdon: «Unë e flas tërë kohën, dhe pastaj pyes veten pse *Washington Post*, i cili i përket Jeff Bezos, gjithashtu pronar i Amazon, nuk shkruan artikuj të mirë për mua. Vërtet nuk e di pse.»

Por artikujt nuk janë më mirë diku tjetër. Ndoshta për të njëjtat arsye: një pronar i mediave që fiton shumë para e kupton se nuk do ta kursente programi fiskal i z.Sanders.

Dhe pastaj, të deklarosh ihtar i socializmit, qoftë edhe “demokratik”, nuk është përsheptuesi më i mirë i karrierës në televizion.

Sam Donaldson ishte për dekada me radhë gazetari më i famshëm në televizionin ABC. Ai sapo ka mbështetur Michael Bloomberg.

Përballë z.Sanders, të mbështesësh një miliarder shumë më tepër të djathtë është mënyra e vetme, beson ai, për ta mundur pastaj z.Donald Trump dhe për të siguruar që Amerika do të mbetet «vendi që shkëlqen në breg për të cilën fliste Ronald Reagan dhe që e zbehte tërë botën nga zilia».

Pasardhësi i Donaldson në ABC është George Stephanopoulos, ish-zëdhënësi i Presidentit William Clinton në Shtëpinë e Bardhë (1993-2001). Ai ishte atëherë i bindur që krijimi i një takse mbi pasurinë të paralajmëruar nga z.Sanders ishte jopopullore sa që kundërshtoi një nga të ftuarit e tij që ia dëshmonte të kundërtën. Dhe pastaj, duke pranuar përfundimisht gabimin e tij, ai përfundoi: “Kjo tregon se unë jetoj në Manhattan. Kjo taksë nuk është e popullarizuar këtu” (20 tetor 2019). Stephanopoulos fiton 15 milion dollarë në vit nga ABC News.

Një tjetër yll televiziv, gjithashtu demokrat, Christopher Matthews punon në kanalin MSNBC. «Më kujtohet lufta e

ftohtë. Besoj se nëse do të kishin fituar [Fidel] Castro dhe të kuqtë, do të kishte pasur ekzekutime në Central Park dhe se unë do të isha në mesin e të dënuarve përderisa do të duartrokisnin të tjerët.» Kush për shembull? “Unë nuk e di se kënd e mbështeste Bernie përgjatë atyre viteve ose edhe çfarë nënkupton ai me “socializëm”.”

Që kur zoti Sanders filloi të fitojë zgjedhje për kandidaturën, z.Trump i pëlqen të rikujtoj udhëtimin e Sandersit në Moskë më 1988 në muajin e tij të mjalit.

Por, në këtë regjistër, ish-presidenti/kryeshefi ekzekutiv i Goldman Sachs, z.Lloyd Blankfein, një demokrat klintonian, shpërfaqet edhe më i ashpër. Më 12 shkurt ai postoi në Twitter: “Sanders është po aq polarizues sa Trump dhe ai do ta falimentoj ekonominë tonë. Ai përqesh ushtrinë tonë. Nëse do të isha rus, këtë herë, unë do ta zgjidhja Sanders.”

Preferenca e Moskës është e panjohur në rast të një përballje midis biznesmenit njujorkez dhe senatorit Sanders në nëntorin e ardhshëm. Por tashmë dihet se për gazetarët amerikanë, të cilët i urrejnë po aq njërin sa tjetrin, kjo përballje do të ishte një rrugëtim kryqëzues.

TEZAT E VERBËRA TË DY LIBRAVE TË SUKSESSHËM

Faktet e rreme rreth xhihadizmit

Presidenti Emmanuel Macron e paralajmëroi më 18 shkurt rrezikun e “separatizmit islamik” që kërcënon qytetet franceze. Ai pretendon ta luftoj atë duke e zvogëluar numrin e imamëve të huaj dhe duke e kontrolluar më rreptësisht mësimin e arabishtes. Frika nga fundamentalizmi islamik dhe lidhjet e saj të supozuara me xhihadizmin vazhdon të nxis polemika.

NGA LAURENT BONELLI DHE FABIEN CARRIÉ*

Media kryesore ju pëlqen të organizojnë debate intelektualë, në momentin që ato ofrojnë shpjegime të thjeshta dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimet shoqërore. Ato rreth xhihadizmit zënë një vend të privilegjuar.

Kjo mund të shpjegohet me një “radikalizim të Islamit”, siç e argumenton politologu Gilles Kepel, ose përkundrazi me një “islamizim të radikalitetit”, siç e thotë kolegu i tij Olivier Roy.

Dy libra të rinj rinxiten këtë debat si një ndeshje boksi, që do të shënonte “fitoren” e së parës mbi të dytën (*Le Figaro*, 17 janar 2020).

Nëpërmjet intervistave me xhihadistë të burgosur dhe monografite e disa komunave (përfshirë Toulouse, Aubervilliers, Mantes-la-Jolie, Argenteuil në Francë, dhe Molenbeek në Belgjikë), këto ese përshkruajnë themelimin e “ekosistemeve islamike”, të përbërë nga faltoret, restorantet hallall, internet-kafetë, shkollat fetare, shoqatat kulturore ose sportive.

Në duart e “salafo-xhihadistëve”, këto hapësira të shoqërizimit mendohet se ushqejnë një “logjikë të shkëputjes me shoqërinë globale dhe institucionet e saj”, thotë libri i botuar nga Bernard Rougier. Ato mendohet se përbëjnë hapësirën parapërgatitore për akte të dhunshme dhe/ose ngjallin vullnetin për t’u anëtarësuar në Organizatën e Shtetit Islamik (ISIS).

Sa për burgjet, ato qenkan bërë “*fabrikat*”, “*inkubatorë*” të përdorur nga xhihadistët “për t’i përhapur idetë e tyre në qytete dhe lagje nga ku burojnë dhe ku do të kthehen shokët e tyre nga burgu”, mund të lexojmë në shkrimet e Hugo Micheron.

Këto fenomene janë injoruar nga autoritetet - termat “paranojë” dhe “verbëri” përsëriten rregullisht - dhe janë bërë të mundshme nga bashkëvetërimi i zyrtarëve të zgjedhur vendorë që janë pa vetëdije ose të motivuar nga interesat elektorale, si dhe nga intelektualët dhe aktivistët e shqetësuar nga “*islamofobia*”.

X KA SHKUAR NË KËTË XHAMI..

Këto teza kanë ngjallur interes të madh në media, duke gjykuar nga numri i artikujve, intervistave, transmetimeve radio-televizive që ju kanë kushtuar atyre. Suksesi i tyre është më pak për shkak të saktësisë së tyre shkencore sesa në kornizën ideologjike që ata ofrojnë.

Duke i injoruar studimet e sociologjisë politike, atë të lëvizjeve shoqërore ose historisë shoqërore, këto libra rehabilitojnë një “histori të ideve” të vjetër, ku individët veprojnë kryesisht në bazë të fuqisë së tekstit ose të fjalës.

Sikurse shkrimet e Karl Marksit që shpjegojnë përvojat komuniste dhe shkrimet e Iluminizmit mbi Revolucionin Francez, shkrimet e Ahmed Ibn Hanbal (780-855), Mohamed Ben Abdelwahhab (1703-1792) ose Sejjid Qotb (1906-1966) mundësojnë analizën mbi xhihadizmin, pohon Rougier.

Kepel dhe Rougier janë specialistë të debateve teologjike në botën muslimane. Ata janë profesionalistë të prirur të besojnë në fuqinë e fjalëve dhe të japin përvoja konkrete (nga konflikti në Afganistan deri në themelimin e ISIS e sulmet e 11 shtatorit 2001) mbi zhvillimet doktrinale.

Kjo i bën ata të pandjeshëm lidhur me arsyet se përse ideologjia arrin ta imponojë veten tek disa individë të veçantë, e posaçërisht me veprimet e tyre për ta përshtatur me mjedisin e tyre shoqëror, kulturor dhe politik.

Demonstrimi i drejtohet atëherë lehtësisht një regjistrat epidemiologjik. Idetë dhe viruset do të përhapeshin në të njëjtën mënyrë. «*Që shpërndarja të bëhet*, shkruante André Siegfried, *një nga baballarët themelues të shkencës politike franceze, do të duhet domoshmërisht një një vektor dhe një mjedis pritës.*» Puna e militantëve të caktuar me përvojë do të rrisë “*mundësinë e ngjites*” (Rougier) ; e do të mund të shihet se disa “*celula burimore*” ishin në gjendje të “*ndaheshin në mënyrë që të rriteshin paralelisht në të dy anët e Evropës dhe Lindjes së Mesme*” (Micheron).

Në këtë kontekst, veprimet e aktivistëve reduktohen në një strategji globale për të cilën do të mendohej diku tjetër dhe nga të tjerët (Osama bin Laden, Abu Moussab Al-Zarqawi ose Abu Bakr Al-Bagdadi, në varësi të kohës) dhe të cilën ata do të përpiqen të përmushin.

Përderisa celulat xhihadiste që kishin goditur në Evropë nga fillimi i viteve 2000 - me përjashtim të dukshëm të autorëve të sulmeve të 13 nëntorit 2015 në Paris - duket se ishin të vetorganizuara dhe autonome. Ky vizion instrumental u jep këtyre figurave të mëdha të xhihadit një fuqi pothuajse demiurgike në territoret ku ata nuk kishin ndërlidhje midis tyre.

Të dhënat në terren të paraqitura nga Micheron dhe Rougier kanë një vizion policor të historisë. X



QË IDETË TË LLOGARITEN DUHET QË SHUMË FORCA SOCIALE T’I MBËSHTESIN ATO, QË ATO TË MUND TA NJOHIN VETEN NË TO. SHPËRFAQJA DOGMATIKE E PASTËRTISË POLITIKE OSE FETARE KA KUPTIM NË LUFTËRAT MIDIS GRUPEVE TË VOGLA PARAROJË, TË CILAT PËR MË TEPËR DËNOJNË PËRÇARJET E PËRHERSHME

ka shkuar në një xhami të tillë. Aty thuhet se ka takuar Y, i cili vetë ishte në kontakt me Z në Siri, etj. Kësisoj ata ndërtojnë një rrjet marrëdhëniesh që shpie në mënyrë të pashmangshme në qendrën e supozuar të prodhimit ideologjik. Kjo është mënyrë e vjetër e të menduarit.

Në vitet 1970 dhe 1980, kërkohet dora e Moskës pas veprimeve të Brigadave të Kuqe Italiane, Fraksionit të Ushtrisë së Kuqe Gjermane ose Action Direct në Francë. Për historianin Carlo Ginzburg, kjo mendësi ka një “*gabim logjik*” sepse kjo “*do të thotë në heshtje (dhe padrejtësisht) rrëshqitje nga rrafshi i mundësisë së thjeshtë në atë të pohimit të kryer; nga kushëzimi tek treguesi*”.

Kjo pjerrësi strategjike mund të shihet edhe në rolin që i atribuohet “*ekosistemeve islamiste*”.

Këto funksionojnë ndonjëherë si përshpejtues i kalimit në dhunë, ndonjëherë si një projekt autonom që synon të ndërtojë “*enklava komunitare*” qëllimi i të cilit do të ishte një “*secesion me ngjyrim fetar*”, siç shkruan Micheron.

Megjithatë, në Evropë, të paktën, asgjë nuk e mundëson krijimin e një lidhje shkaku midis pranisë së disa grupeve fetare në një territor dhe angazhimit të dhunshëm. Kur gjurmohet trajektoret e xhihadistëve, shohim se disa prej tyre me të vërtetë kalojnë nëpër këto organizata, nga të cilat më pas shkëputen, duke i perceptuar si shumë të moderuara; por ka edhe të tjerë që nuk kanë absolutisht asnjë lidhje me ato organizata.

Janë format e emulimit brenda grupeve të vogla të bashkëmoshatarëve ose të rrjeteve familjare që dëshmojnë vendimtare. Përndryshe, Marseja, e konsideruar nga shërbimet e Ministrisë së Brendshme si bastioni kryesor i salafistëve francezë, është kursyer kryesisht nga xhihadizmi, duke e mbështetur tezën se kjo lloj strukture mund të funksionojë gjithashtu si “*tampon*”, duke kufizuar dhunën politike.

Në të njëjtën mënyrë, përqendrimi i autorëve në aktivistët më të bindur i bën ata të mbivlerësojnë shumë ndikimin e tyre në zhvillimin e lagjeve të varfëra dhe të përvetësojnë këndvështrimin e tyre pa ndonjë distancë kur e japin analizën e tyre për situatën. Si leninistë të pashpallur, ata besojnë në rolin e pararojave, të cilët, përmes “*bindjes*”, “*presionit*” ose “*frikësimit*”, hasin në “*pak kundërtënie lokale dhe madje edhe më pak kundërshtime të sinqertë*” (Rougier).

Nëse i besojmë të dhënave të shërbimeve të inteligjencës, nga 2.600 lokalitete fetare myslimane, 130 cilësohen si “*radikale*” më 2018, ose 5% (Le Figaro, 27 dhjetor 2018). Në faltore shërbejnë imamët me frymëzime doktrinale të ndryshme dhe konkurruese. Disa dërgohen nga vendet e emigracionit (veçanërisht Algjeria dhe Turqia). Por ata zgjidhen zgjidhen kryesisht nga bashkësia lokale e besimtarëve.

Autoriteti i tyre varet në masë të madhe nga aftësia e tyre për t’iu përgjigjur kërkesave të ndryshueshme, madje edhe kontradiktore, të cilat zakonisht kanë të bëjnë më pak me dogmen sesa me dilemat e përditshme në lidhje me çiftin, familjen ose jetën profesionale. Të thirrur për t’i zgjidhur, ata kanë më shumë të ngjarë të kërkojnë përshtatje “*të pranueshme fetare*” me shoqërinë në të cilën ata jetojnë sesa të mbrojnë separatizmin fetar.

Sigurisht, nuk është e rrallë që ata të sfidojnë në këtë terren nga individë ose grupe të vogla dogmatike. Por ata më pas përballen me armiqësinë - nganjëherë muskulore - të shumicës së besimtarëve, dhe rrallëherë arrijnë ta kthejnë situatën në dobi të tyre.

Proceset gjyqësore të të rinjve që u nisën për në Siri janë të shumta raste njerëz që kërkojnë diku tjetër atë që nuk mund ta gjejnë këtu. Kjo do të thotë se mbetet e vështirë të konkullohet ringjallja e fesë myslimane në qarqet e caktuara të varfëra nga roli i thjeshtë i pararojave militante.

Për ta kuptuar, përkundrazi, duhet të kthehemi në transformimet e thella që kanë përjetuar këto universe, përgjatë dyzet viteve të kaluara. Varfërimi, por edhe përkëqësimi gradual i shërbimeve publike, rënia e kornizës asociative dhe politike, shterimi i premtimeve kolektive të emancipimit (Marshi për barazi dhe kundër racizmit në 1983) prodhojnë «*socializime gjeneratash*» të ndryshme, të vëzhgueshme edhe brenda vëllazërisë.

Këto zhvillime mundësojnë dhe i bëjnë të besueshme identifikimet me Islamin, duke i ofruar njëkohësisht respektim dhe ndjenjë e përkatësisë kolektive. Në këtë proces, disa zëdhënës u shfaqën ose u forcuan, duke u përpjekur t’i japin jetë një «*ne*» myslimane në hapësirën politike. Ato janë pak mobilizuese në nivel shtetëror (Unioni i Demokratëve Myslimanë Francezë, për shembull, mori rezultatin e tij më të mirë në zgjedhjet evropiane të vitit 2019 me 28.500 vota, ose vetëm 0.13% të votave). Këto mobilizime shfaqen me frekuencë më të madhe në nivel lokal. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin ose rinovimin e faltoreve dhe shpesh për çështjet shkollore (përrjashtimet, ushqimin në menza).

Të shohësh në këto nisma një “*projekt të gjallë dhe koherent ideologjik, që mbart një identitet të ri kolektiv, që ka për funksion strategjik grupimin e popullsive heterogjene nën autoritetin e vetëm të referentit islamik*” (Rougier) do të thotë të harrosh shpejt karakterin shumë konkurrues të çdo projektit përfaqësues të një grupi dhe efektet e kësaj konkurrence në vetë ideologjinë.

Që idetë të llogariten duhet që shumë forca sociale t’i mbështesin ato, që ato të mund ta njohin veten në to. Shpërfaqja dogmatike e pastërtisë politike ose fetare ka kuptim në luftërat midis grupeve të vogla pararojë, të cilat për më tepër dënojnë përçarjet e përhershme.

Nga ana tjetër, çdo organizatë që dëshiron ta zgjerojë bazën e saj është e shtyer në transaksione dhe koncesione që e detyrojnë të bëjnë kompromise me integritetin e linjës së saj.

Zhvillimi drejt një Islami “konsensual dhe jo hakmarrës” i fraksioneve të caktuara të Unionit të Organizatave Islame të Francës (UOIF), të cilat dëshirojnë të njihen si ndërmjetës nga autoritetet lokale, shkon padyshim në këtë drejtim.

Por këto rregullime nuk janë të mjaftueshme për ta krijuar një grup, edhe për shkak se trajektoret dhe përvojat e myslimanëve janë të larmishme në Francë, madje edhe në mjediset dhe lagjet e varfëra.

Përkundër të gjitha pabarazive që i godasin ata, këta të fundit nuk jetojnë në izolim në krahasim me pjesën tjetër të shoqërisë franceze. Injorimi i marrëdhënieve të shumta ndërlidhëse (nga arsimit në shërbimet publike përmes botës së punës) për t’u alarmuar nga një “*separatizëm*” i supozuar i bën dëshirat e pakicës dhe më radikalëve një përshkrim të realitetit. Kjo përbën njëkohësisht një gabim në analizë dhe një pakujdesi politike.

QËNDRUESHMËRIA E VIZIONIT KOLONIALIST

Izrael-Palestinë, një plan lufte

I hartuar nga Uashingtoni pa përfshirjen e palestinezëve, plani i Donald Trump për paqen në Lindjen e Mesme plotëson kërkesat kryesore të Izraelit. Përveç ratifikimit të aneksimit të të gjitha kolonive, si dhe të Luginës të Jordanit (dispozitë kjo në kundërshtim me rezolutat e Kombeve të Bashkuara), «marrëveshja e shekullit» e privon një shtet të mundshëm palestinez nga çdo atribut të sovranitetit.

NGA ALAIN GRESH *

Më 28 janar 2020, në Shtëpinë e Bardhë, Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu, i vetëm në tribunë afër Presidentit amerikan të cilin e dëgjon me ëndje, shfaq një pamje të lumtur. Z.Donald Trump zbulon më në fund «marrëveshjen e shekullit» përpara një auditori të përvetësuar: një audiencë hebrenjesh ultranacionalistësh ose fetarë dhe të krishterë ungjillorë në ekstazë, të cilët bashkohen shpirtërisht në një zjarr mistik kur përmenden Bibla, vendet e shenjta të judaizmit dhe mrekullinë që përfaqëson ekzistenca e Izraelit.

Simbioza është e plotë midis dy vendeve: kur Presidenti Trump përshëndet një nga arkitektët e planit, z.David Friedman, duke thënë «ambasadori juaj», nuk është shumë e qartë se a e përcakton si ambasador amerikan në Jeruzalem ose si ambasador i Izraelit në Uashington.

Gjatë kësaj ceremonie flitet shumë për palestinezët. Sigurisht, pasi që bëhet fjalë edhe për të ardhmen e tyre dhe për tokat e tyre. Por, jo vetëm se nuk është i pranishëm asnjë nga përfaqësuesit e tyre, por edhe Plani është hartuar pa ta. Plani është përpiluar nga amerikanët - të gjithë sionistë të bindur - dhe nga izraelitët, që në rastin më të mirë i injorojnë kërkesat palestineze dhe në rastin më të keq i përçmojnë ato, siç edhe e konfirmon dhënia e një të tretës së Bregut Perëndimor për Izraelin. Ky lloj manifestimi i lartë na rikthen një shekull mbrapa, në një kohë kur derisa popujt vendorë



Derisa Uashingtoni i ka dhënë Tel-Avivit të drejtën për të aneksuar pjesë të mëdha të territoreve të pushtuara pas luftës së qershorit 1967 - kolonitë, pa përjashtim, si dhe Luginën e Jordanit - shteti palestinez do të mbulojë vetëm dy të tretat e Bregut Perëndimor, që është një koncesion i jashtëzakonshëm sipas “vizionit Trump”.

nuk kishin mundësi të jepnin mendimin e tyre, diplomatët me kostume dhe kapela të larta e copëtonin Lindjen e Mesme si djath.

Kështu, më 2 nëntor 1917, Arthur James Balfour, Ministër i Punëve të Jashtme të Perandorisë Britanike, e zotonte Palestinën duke nënshkruar një letër ku shpallte se: «Qeveria e Madhërisë së saj po konsideron me mirësi [të krijoj] një Shtëpi kombëtare për popullin hebre». Më pak e cituar, pjesa e dytë e këtij premtimi për lëvizjen sioniste veçonte: «Kuptohet se asgjë nuk do të bëhet që do të mund t'i cenojë (...) të drejtat civile dhe fetare të komuniteteve johebraike që ekzistojnë në Palestinë.» Pavarësisht nga kjo klauzolë, 90% e popullsisë privohet nga drejtat politike

dhe kombëtare. Si dje, ajo nuk pyetet as sot, si dje as sot nuk i njihet identiteti kombëtar. Ky vizion ka një emër: kolonializëm. Mjerë të mposhturit!

Në vitin 1917, norma ishte e tillë. Perandoritë britanike dhe franceze mund të besonin se ishin të përjetshme dhe depozitues të së drejtës së pakontestueshme për ta caktuar fatin e popujve “inferiorë” të Azisë ose Afrikës. Një shekull më vonë, sistemi kolonial u shemb, duke lënë kujtime të mira vetëm tek disa nostalgjikë të kësaj “detyre të civilizimit” që e kërkonte Jules Ferry, apo të “barrës së njeriut të bardhë”, siç kremtonin vargjet e Rudyard Kipling.

Megjithatë, çdo paragraf i «vizionit» të propozuar më 28 janar nga Presidenti Trump

shpërfaq të njëjtën mendësi. Sigurisht se Presidenti amerikan nuk mund ta injorojë faktin se nuk jetojmë sot në epokën koloniale. Kjo edhe është arsyeja pse ai pretendon se pozicioni i tij është i barazpeshuar, pasi që përfshin të drejtën e palestinezëve për ta pasur shtetin e tyre. Asgjë e re: Presidenti George W. Bush ia kishte njohur këtë të drejtë më 25 qershor 2002 dhe vetë z.Netanyahu e kishte pranuar këtë ide gjatë një fjalimi në vitin 2009. I kishte përcaktuar kornizat, të njëjtat që janë përfshirë në planin Trump: shteti i ardhshëm palestinez, pavarësisht nga sipërfaqja dhe ndarja e tij, nuk do ta ketë asnjë atribut të shtetit, duke filluar nga sovraniteti.

Për t'u arsyetuar, hartuesit shpjegojnë, pa dashje me hu-

mor, se «sovraniteti është një koncept i përpunueshëm [«amorfo»] i cili ka evoluar me kalimin e kohës. Me ndërvarësi në rritje, çdo komb zgjedh të ndërveprojë me kombet e tjera duke bërë marrëveshje që vendosin parametra thelbësorë për secilin». Parim paradoksal kur vjen nga dy shtete që pretendojnë të veprojnë vetëm sipas interesave kombëtare të tyre vetanake!

Shteti palestinez i demilitarizuar nuk do ta ketë asnjë kontroll mbi kufijtë e tij, as mbi hapësirën e tij ajrore ose detare. Edhe tunelet dhe urat që do t'i lidhin enklavat e ndryshme që supozohet ta sigurojnë «vazhdimësinë e territorit palestinez» do të jenë nën mbikëqyrjen e Izraelit. Dhe çdo vendim i palestinezëve do të kushtëzohet me «sigurinë e Izraelit».

Derisa Uashingtoni i ka dhënë Tel-Avivit të drejtën për të aneksuar pjesë të mëdha të territoreve të pushtuara pas luftës së qershorit 1967 - kolonitë, pa përjashtim, si dhe luginën e Jordanit - ky shtet palestinez do të mbulojë vetëm dy të tretat e Bregut Perëndimor, gjë që është sipas “vizionit Trump” një koncesion i jashtëzakonshëm “Tërheqja nga një territor i pushtuar në një luftë mbrojtëse

është një gjë e rrallë historike. Duhet pranuar që shteti i Izraelit tashmë është tërhequr nga të paktën 88% e territorit që e pushtoi në vitin 1967. Ky vizion parashikon bartjen e territoreve të rëndësishme nga shteti i Izraelit - territore mbi të cilat vendi kishte pretendime legjitime ligjore dhe historike, të cilat janë pjesë e atdheut stërgjyshor të popullit hebre. Në mendësinë e z.Trump dhe z.Netanyahu, një hajn që ju ka vjedhur 300 euro dhe ju premtonte se do t'ju kthejë 200 euro, tregon shpirtbardhësinë e tij.

Sepse edhe në këtë 'ban-tustan' të ardhshëm (që do të njihet si shtet vetëm pas katër viteve, me kusht që Izraeli ta jap dritën e gjelbër), palestinezët do të duhet t'i respektojnë kërkesat e zotërve të tyre. Një shembull i vetëm përmbledh logjikën e planit të detyrimit ndaj veprës. Që nga pushtimi i vitit 1967, palestinezët nuk mund t'i ndërtojnë lirshëm shtëpitë e tyre. Qindra shtëpi të tyre shkatërrohen nga ushtria izraelite me pretekste të ndryshme. Edhe nëse në "shtetin" e tyre të ardhshëm, autoritetet palestineze do të mund të lëshojnë leje ndërtimi, banesat që gjinden "në zonat ngjitur me kufirin midis shtetit të Izraelit dhe shtetit të Palestinës, përfshirë kufirin midis Jeruzalemit dhe Al-Qods, do t'i nënshtrohen përgjegjësisë kryesore të shtetit të Izraelit në çështjet e sigurisë". Mjafton të shikohet harta për të kuptuar që nuk do të ketë zona që nuk janë "ngjitur me shtetin e Izraelit".

Natyrisht se këto kufizime bëhen në emër të "sigurisë" (një fjalë që paraqitet 167 herë në tekst, ose mesatarisht dy herë në faqe), por vetëm të Izraelit. Vendi ka ushtrinë më të fuqishme në rajon; ka armën bërthamore; forca e saj ajrore mund ta bombardojë Libanin, Sirinë, tani Irakun dhe natyrisht Gazën. Në vitin 2019, 133 Palestinezë u vranë, prej të cilëve 28 të mitur, krahasuar me 10 izraelitë, prej të cilëve një i mitur. Megjithatë, dokumenti Trump shpjegon se "është joreale të kërkojë nga shteti i Izraelit të bëjë kompromise në çështje të sigurisë që mund ta rrezikojnë jetën e qytetarëve të tij".

Në rishkrimin e tij të historisë, teksti përmend vetëm «luftërat mbrojtëse, disa prej të cilave të llojit ekzistencial,



Ndarjet palestineze, diskreditimi i dy pushteteve - në Ramallah si seli e autoritetit palestinez dhe në Gaza i kontrolluar nga Hamasi - e komplikojnë organizimin e një përgjigje. Pas kërcënimit për ta pezulluar koordinimin e sigurisë me Izraelin, Presidenti Mahmoud Abbas është kthyer sërish mbrapa. Ai mbyllet në palëvizshmëri vetëm se me disa veprime diplomatike, duke shpresuar se plani do të vdesë nga vdekja e tij e bukur, në mungesë të bashkëbiseduesve palestinezë

të bëra nga Izraeli». Mbrojtës edhe pushtimi i njëanshëm i Egjiptit në vitin 1956? Lufta e vitit 1967 e denoncuar asokohe nga gjenerali de Gaulle, sepse Izraeli kishte «*gjuajtur i pari*»? Pushtimi i Libanit në vitin 1982?

Shprehja *Vae victis!* ("Mjerë të mposhturit!") mund të përmbledhë "vizionin Trump". Edhe pas paqes nuk do të lirohen të burgosurit politikë palestinezë, nëse kanë kryer krime gjaku, ose edhe nëse thjesht kanë komplotuar për t'i kryer ato. Refugjatët nuk do të mund të kthehen në shtëpitë e tyre, nuk do të dëmshpërblehen dhe do të mund të vendosen në shtetin palestinez vetëm se me pëlqimin e Izraelit. Udhëheqësia palestineze do të duhet gjithashtu ta "edukoj" popullin e tij për t'i dhënë fund "gjuhës së urrejtjes" (që nuk ekziston në Izrael, natyrisht).

Në fund, palestinezët do të duhet ta njohin Izraelin si "shte-

tin-komb të popullit hebre", duke legjitimuar vizionin sionist të historisë, idenë se ata janë ndërhyrës në këtë tokë biblike - duke brishtësuar gjendjen e afro dy milion "palestinezëve të vitit 1948", shpesh të quajtur "arabë izraelitë", qytetarë të rendit të dytë në një shtet hebre. Një shkëmbim territorësh do t'i shtyjë gjithashtu 400,000 prej tyre jashtë kufijve, duke e fuqizuar ëndrrën e "pastërtisë etnike" që po rritet në Tel Aviv.

Në një artikull tingëllues të titulluar "Mos e quani këtë plan paqeje", z.Daniel Levy, një ish-negociator izraelit i Marrëveshjeve të Oslo-s, shkruan: "Ekziston një dallim midis kapitullimit dhe një plani të paqes. Por edhe kushtet e kapitullimit kanë më shumë të ngjarë të jenë të qëndrueshme nëse ndërtohen në mënyrë që ta ruajnë një lloj dinjiteti të palës së mposhtur". "Vizioni" i propozuar nga Uashingtoni është një "plan urrejtje", përfundon ai.

Në historinë e re, presidentët amerikanë kanë propozuar shpeshherë "plane paqeje" - prej Planit të Ronald Reagan në vitin 1982 deri tek Plan i George H. Bush në vitin 1991. Me z.Trump, për herë të parë, një nga këto plane përjashton në mënyrë eksplicite tekstet e miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), në veçanti rezolutën 242 të Këshillit të Sigurimit të nëntorit 1967, ku deklarohet "*papranueshmëria e marrjes së territoreve me luftë*". Ndoshta ai nuk do t'i mbijetojë banorit aktual të Shtëpisë së Bardhë. Por, përveç se e njëjta përfundimisht Jeruzalemin si "*kryeqyteti i përjetshëm dhe i pandashëm*" të Izraelit (një vendim që një president i ardhshëm do ta ketë të vështirë ta shfuqizojë), ai angazhohet gjithashtu (edhe para zgjedhjeve të nëntorit në Shtetet e Bashkuara) për themelimin e një komisioni amerikano-izraelit i cili do t'i përcaktoj saktësisht kufijtë e territoreve që Izraeli do të mund t'i aneksojë me pëlqimin e Uashingtonit.

Në këtë kontekst, çfarë mund të bëjnë palestinezët? Ata e kanë pranuar refuzimin unanimit të Planit nga Lidhja Arabe, nga Organizata e Bashkëpunimit Islamik dhe nga Bashkimi Afrikan. Shumë zëra publikë kanë shprehur pakënaqësinë e tyre, si në Marok, ku dhjetëra mijëra protestues kanë kundërshtuar planin. Por pak kryeqytete arabe kundërshtojnë hapur Shtetet e Bashkuara, dhe disa të tjerë, veçanërisht në Gji, do të donin t'i bashkangjiten atyreve, siç shihet nga prania e ambasadorëve të tyre në prezantimin e Planit Trump. Disa qeveri perëndimore, përfshirë ajo e Francës,

kanë "*përshendetur përpjekjet e Presidentit Trump*", duke iu bindur një urdhërit paraprak ... madje edhe para se ta studionin dokumentin. Dhe palestinezët nuk kanë fituar mbështetje të mjaftueshme në Kombet e Bashkuara për miratimin e një rezolute nga Këshilli i Sigurimit që madje pa e dënuar planin së paku do të kujtonte parime një mijë herë të miratuara në dekadat e fundit.

Ndarjet palestineze, diskreditimi i dy pushteteve - në Ramallah si seli e autoritetit palestinez dhe në Gaza i kontrolluar nga Hamasi - e komplikojnë organizimin e një përgjigje. Pas kërcënimit për ta pezulluar koordinimin e sigurisë me Izraelin, Presidenti Mahmoud Abbas është kthyer sërish mbrapa. Ai mbyllet në palëvizshmëri vetëm se me disa veprime diplomatike, duke shpresuar se plani do të vdesë nga vdekja e tij e bukur, në mungesë të bashkëbiseduesve palestinezë.

Në vitin 1989, historiani amerikan David Fromkin botoi një libër me titull «Një paqe për t'i dhënë fund çdo ide paqeje». Aty studioi mënyrën sesi fuqitë evropiane kishin copëtuar Lindjen e Mesme dhe ia kishin dorëzuar Palestinën kolonizimit hebre, në dëm të aspiratave të popujve të saj. Ai vuri në dukje se «*fantazma kryesore britanike për Lindjen e Mesme - sipas të cil-it ky rajon dëshiron të qeveriset nga Britania e Madhe ose me ndihmën e saj - është përplasur me murin e gurtë të realitetit*». Kjo «fantazmë» ka shkaktuar miliona vdekje. Një shekull më vonë, «vizioni» i z. Trump bazohet në të njëjtin iluzion dhe premtonte të njëjtat pasoja.

NË Ç'MASË MUND TË BËHET "PASTRIMI", SI NDRYSHON AUTORITARIZMI?

Prej Algjerisë në Sudan, përgjigjet ndaj "pranverës arabe"

Në vitin 2019, lëvizjet protestuese në botën arabe ishin në frymën e revoltave të viteve 2011-2012. Pothuajse një dekadë më vonë, opozita kërkon ende shpartallimin e pushteteve në vend, por pa sukses, për shkak të mungesës së strukturave politike. Në Gji, si në Magreb dhe në Lindjen e Mesme, religjioni nuk i përcakton më rivalitetet gjeopolitike.

NGA HICHAM ALAOUI*

Sizmologët e njohin mirë këtë fenomen: tërmetet shpesh shkaktojnë më pak dëme se dridhjet që ndodhin pas tyre. "Pranvera Arabe" e viteve 2011-2012 shkaktoi çarje të thella në sistemet autoritare që qeverisnin rajonin, duke treguar fuqinë e lëvizjeve popullore kur ato thejnë murin e frikës. Dridhja më e madhe në vitin 2019, me një valë protestash që tronditi shumë pushtete në vend.

Trazirat aktuale në Algjeri, Egjipt, Irak, Jordani, Liban dhe Sudan paraqesin amplifikimin logjik të "pranverës arabe". Po dëshmohet përsëri se këto shoqëri që ballafaqohen ende me padrejtësitë ekonomike dhe politike nuk e pranojnë kapitullimin. Sigurisht se kundërshtarët e tyre (regjimet despotike) mbeten po ashtu të vendosur për ta mbajtur pushtetin dhe përpiqen të përshtaten me të pakënaqurit për të mbijetuar.

Të dhënat strukturore nuk kanë ndryshuar që nga kryengritjet e viteve 2011-2012 dhe kjo po nxit pakënaqësi. E dhëna e parë është rinia. Një e treta e popullsisë është nën 15 vjeç dhe një e treta tjetër midis 15 dhe 29 vjeç. Në dhjetëvjeçarin

e fundit, në botën arabe gjenerata më e re, më e madhja në rrafshin demografik dhe me nivelin më të lartë të arsimit, ka arritur moshën e rritur. Kjo grupmoshë karakterizohet gjithashtu nga përfshirja e saj e thellë në mediat sociale dhe nga zotërimi i teknologjive në internet.

Konstantja e dytë është ekonomike. Zhvillimi i rajonit mbetet anemik. Papunësia dhe shkalla e varfërisë janë përkeqësuar në shumicën e shteteve, përveç se në monarkitë e pasura të Gjirit. Sipas Bankës Botërore, 27% e arabëve të rinj janë të papunë, më shumë se në çdo rajon tjetër të botës. Dëshira për të emigruar, kryesisht për shkak ekonomike, ka arritur nivele historikisht të larta. Në raportin e fundit të barometrit arab në vitin 2018, një e treta ose më shumë nga të intervistuarit në Algjeri, Irak, Jordani, Marok, Sudan dhe Tunizi deklarojnë se dëshirojnë të largohen nga vendi i tyre. Në Marok, 70% e të rinjve 18-29 vjeçar ëndërrojnë të largohen. Qeveritë cinike nuk bëjnë asgjë për ta ndaluar këtë hemorragji sepse në këtë mënyrë edhe i heqin qafe të rinjtë që mund të protestojnë kundër gjendjes së tyre materiale.

Pushtete që do të shkojnë deri në fund

Arsyeja e tretë strukturore që ushqen pakënaqësinë e përgjithshme: nuk ka progres në mënyrën e qeverisjes. Mungesa e politikave dhe praktikave demokratike - përveç në Tunizi - ka rezultuar në rritjen e marginalizimit të popullatës. Shumë qytetarë besojnë se korrupsioni është endemik. Punësimi dhe përfitimi i shërbimeve efektive janë çështje favorizuese, të cilat marrin për bazë anëtarësimin në rrjetet klienteliste, në dëm të ekselencës meritokratike.

Strukturat mbeten të njëjta, por mënyra e protestimit tani përfshin tendencën të reja. Së pari, lëvizjet popullore kanë kuptuar se rrëzimi i pushtetarëve nuk e garanton ndryshimin e regjimit. Dhe veçanërisht kur zonat e rezervuara mbeten të kontrolluara nga institucionet ushtarake dhe kur nuk ndryshojnë rregullat e lojës politike. Kështu që protestuesit nuk po kërkojnë zgjedhje të reja të nxituara. Aktivistët algjerianë

dhe sudanezë nuk dëshirojnë që të përsëriten gabimet e revolucionit egjiptas të vitit 2011. Ata kërkojnë shpartallimin e të gjitha komponenteve të sistemit autoritar.

Për më tepër, protestuesit janë më të vetëdijshëm për dobitë dhe mangësitë e teknologjisë së informacionit. Në të kaluarën, rrjetet sociale janë përdorur për ta anashkaluar censurën dhe për ta shmangur represionin shtetëror. Tani, këto rrjete janë mjet për ta shprehur angazhimin dhe për të zhvilluar beteja kundër shtetit, virtuale por të përhershme, përmes krijimeve artistike, humorit apo kritikave të ashpra, për t'i delegjitimuar drejtuesit dhe institucionet. Një disidencë e tillë po zhvillohet veçanërisht në Algjeri dhe Liban - ku lëvizjet protestuese kanë dalur edhe në rrugë - por gjithashtu edhe në vendet që perceptohen nga perëndimi si më të qeta, për shembull Maroku apo Jordania. Mediat sociale në botën arabe nuk shfrytëzohen më vetëm për t'i ikur realitetit, por janë shndërruar në një mjet konfrontimi midis shtetit dhe një pjese të shoqërisë. Por, pengesa kryesore për protestuesit:



Sudani dallohet nga vendet e tjera arabe: shoqëria civile është plot vitalitet. Ekziston një rrjet shumë aktiv i shoqatave profesionale dhe aktivistët shprehin gatishmëri për t'i sjellur udhëheqësit ushtarakë në tryezën e bisedimeve. Për dekada të tëra, në këtë vend, sindikatat, organizatat joqeveritare etj, janë të gatshëm të përfshihen në jetën politike.

edhe pushteti po përdor rrjetet e internetit për të shpërndarë propagandën dhe për t'i identifikuar dhe pastaj ndëshkuar, kundërshtarët më aktiv.

Dhe në fund, aktivistët janë larguar edhe më shumë nga ideologjitë e mëdha. Gjatë "Pranverës arabe" ishte veçuar zhgënjimi nga "izmet" e mëdha: panarabizmi, islamizmi, socializmi, nacionalizmi. Tani lëvizjet masive nuk i besojnë premtimeve utopike; ata preferojnë betejat e përditshme për ta përmirësuar qeverisjen e shtetit të tyre. Përgjigja ndaj "tërmetit" të viteve 2011-2012 përforcoi

këtë zhvillim duke i dhënë fund idilit filozofik me demokracinë. Forcat e opozitës kërkojnë së pari shpartallimin e të gjitha strukturave të ekonomisë së vjetër politike, që gjenerojnë pabarazi dhe padrejtësi. Gratë luajnë tani një rol më të rëndësishëm në këto lëvizje të reja popullore, pra kritika radikale kundër rendit të vjetër shënjestron gjithashtu patriarkatin.

Edhe regjimet autoritare kanë mësuar nga ngjarjet e dhjetëvjeçarit dhe nga fati i ish-presidentit Zine El-Abidine Ben Ali në Tunizi dhe homologut të tij Ahmad Ali Saleh në

Jemen. Tani janë më të kujdesshëm kur bëjnë premtime demokratike. Kur sistemi sulmohet nga lëvizjet popullore, pushtetet nuk e tolerojnë disidencën si më parë për të fituar kohë, por tani përkundrazi qeveritë përgjigjen në mënyrë më racionale duke e vazhduar represionin.

Fati i disidentëve sauditë në ekzil është emblematic dhe procedurave ekstreme të përdorura përballë çdo gjëje që paraqet kërcënim. Përdorimi i kësaj dhune u përforcua nga një fakt tepër cinik: regjimeve iu sigurohet pandëshkueshmëria. "Komuniteti ndërkombëtar" vazhdon t'i denojë shkeljet e të drejtave të njeriut, por në fakt fuqitë e huaja përshtaten me trajtimin e opozitës demokratike në shtetet arabe. Regjimi i marshallit dhe presidentit të Egjiptit, Abdel Fatah Al-Sisi, aleat i çmuar i perëndimit, nuk dha asnjë llogari për përmbysjen e qeverisë së votuar, as për vrasjen e disa qindra njerëzve gjatë demonstratave në sheshin Rabia-El-Adouia në Kajro, në vitin 2013. Nuk dha llogari as për vdekjen në rrethana të dyshimta të ish-presidentit Mohamed Morsi gjatë gjyqit të tij në qershor 2019.

As vrasja e gazetarit saudit Jamal Khashoggi brenda konsullatës së vendit të tij në Stamboll, më 2 tetor 2018, nuk i prishi marrëdhëniet midis

* Hulumtues i asociuar në universitetin Harvard (États-Unis), autor i *Journal d'un prince banni. Demain, le Maroc*, Grasset, Paris, 2014.

Rijadit dhe pjesës tjetër të botës. Në Siri, z.Bachar Al-Asad qeveris akoma megjithë kërdrinë e luftës civile. Në janar 2011, një skandal u shkaktoi kur Ministria franceze për Punë të Jashtme Michèle Alliot-Marie ofroi ta ndihmoj regjimin tunizian të Ben Ali; por kur Franca e mbështeti ndërmjetësimin e Organizatës të Kombeve të Bashkuara (OKB) në Libi dhe në të njëjtën kohë i armatosi trupat e marshallit Khalifa Haftar, kjo kaloi në heshtje.

Sudani është një rast i veçantë i përgjigjes ndaj “pranverës arabe”. Vetëm në këtë vend mund të ketë negociata paqësore për t’i hapur rrugë demokracisë. Mobilizimi është i tillë që liderët e opozitës mund ta nxisin opinionin popullor në kohën kur pushtetarët nuk kanë mbështetje ndërkombëtare. Por, ky është rast i veçantë. Sudani dallohet nga vendet e tjera arabe: shoqëria civile është plot vitalitet. Ekziston një rrjet shumë aktiv i shoqatave profesionale dhe aktivistët shprehin gatishmëri për t’i sjellur udhëheqësit ushtarakë në tryezën e bisedimeve. Për dekada të tëra, në këtë vend, sindikatat, organizatat joqeveritare etj, janë të gatshëm të përfshihen në jetën politike.

Kurse, në Irak, Liban dhe Algjeri, përgjigjia aktuale ndaj “pranverës arabe” shënohet nga një dëshirë për “pastrime” të gjëra, për t’i larguar elitat e vjetra politike. Por, për tu ballafaquar me regjimin, asnjë strukturë politike nuk e mbështet këtë kërkesë radikale: protestuesit qëndrojnë larg arenës politike, nga frika se do t’i diskreditonte kontakti me i vogël me klasën qeverisëse. Organizimi horizontal i mobilizimit parandalon shfaqjen e liderëve, zëdhënësve. Fillimisht, kjo ishte një përparësi

pasi që e zvogëlonte efikasitetin e represionit, por kjo situatë tani komprometon mundësinë e daljes nga kriza. Kjo rrymë e “pastrimeve” çon ndonjëherë në qorrsockak.

Në disa vende, demonstruesit nuk kanë asnjë ndikim ekonomik për t’i bërë presion autoriteteve. Regjimi algjerian dhe irakian varen nga eksporti i hidrokarbureve. Përpunimi i këtyre lëndëve bëhet në industri sociologjikisht të mbyllura dhe të larguara gjeografikisht. Në këto vende “hirakët” (lëvizjet popullore) nuk mund të veprojnë në bërthamën ekonomike të regjimit.

Përtej mësimave të nxjerra prej “pranverës arabe” nga regjimet dhe opozita, peizazhi fetar dhe situata gjeopolitike kanë ndryshuar shumë. Tani përplasjet në mes pushteteve dhe popullsisë nuk janë më pjesë e rivalitetit midis kampit iranian dhe sunizmit kundër-revolucionar të përfaqësuar në veçanti nga disa monarki të Gjirit.

Për ta ngadalësuar valën e protestave të viteve 2011-2012, blloku kundër-revolucionar i udhëhequr nga Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA) i përkeqësoi qëllimisht konfliktet sektare. Kështu shpresonte në copëtimin e shoqërive dhe në shuarjen e kundërshtimit demokratik ndaj kampit iranian. Teherani dhe vartësit e tij - Hezbollahu Libanez, regjimi i Z. Al-Asad, grupet e armatosura houthiste (në Jemen) dhe irakiane - kanë kontribuar në masë të madhe në këtë thyerje: shovinizmi sunit i promovuar nga Rijadi dhe Abu Dhabi ndikoi në disa konflikte kombëtare dhe arsyei mbështetjen e akterëve përkrahës të kampit shiitë.

Kufijtë e ndikimit saudit

Këto strategji rajonale janë ndalur tani. Brenda boshtit iranian, narracioni fetar nuk i tërheq aktivistët e rinj. Në Liban dhe Irak, rryma e “pastrimit” nuk kursen asnjë fe. Në Irak, protestuesit shiitë i kanë sulmuar edhe misionet diplomatike iraniane. Situata ka ndryshuar tani në Teheran, me dy lloje valësh të protestave, me protesta të rregullta kundër regjimit teokratik brenda vendit si dhe në sferën e ndikimit të tij.

Ka dështuar gjithashtu fushata kundër-revolucionare e bllokut të emirateve saudite. Çeqet e bardha të nënshkruara për disa udhëheqës arabë nuk garantojnë stabilitetin e regjimit të tyre. Në Egjipt, megjithë ndihmën e vendeve të Gjirit, z.Al-Sissi nuk arriti ta imponoj një model të ri të një regjimi të forte, ku bashkëjetojnë autoritarizmi, zhvillimi i shpejtë ekonomik dhe stabiliteti politik. Përkundrazi: Egjipti përfaqëson një antimodel që nuk dëshiron ta imitojë asnjë vend arab, nga fakti se ushtria e tij është bërë një forcë grabitqare që qeveris të gjithë sektorët e ekonomisë.

Dështimet e koalicionit sunit tregojnë kufijtë e ndikimit saudit. Shembulli i fundit: shumë kryeqytete arabe kanë kundërshtuar “marrëveshjen e shekullit” të përpiluar nga z.Donald Trump për t’i dhënë fund konfliktit

Gjatë viteve të fundit, mënyra e qeverisjes ka qenë gjithnjë e më e kontestuar në nivel kombëtar. Dhe as Rabati dhe as Amani nuk kanë treguar fleksibilitet dhe reaktivitet, si në të kaluarën, kur i zbusnin krizat, veçanërisht duke e zgjedhur bashkërisht një pjesë të opozitës

publicitet, por në fakt nuk rezultoi në privatizimin apo në diversifikimin e ekonomisë, por ilustroi kontrollin e monarkisë mbi ekonominë.

Ndryshimet thelbësore që ndodhën në strategjinë gjeopolitike të Shteteve të Bashkuara duhet të merren parasysh nga kampi kundër-revolucionar sunit. Në cilësinë e superfuqisë, Uashingtoni nuk e llogarit më botën arabe si thelbësore. Ekonomia amerikane, si dhe tregjet kryesore botërore, mund t’i rezistojnë çdo ndërprerje të prodhimit të naftës në Lindjen e Mesme falë burimeve të reja të furnizimit. Për më tepër, kundërshtarët si Organizata e Shtetit Islamik (ISIS) ose Irani nuk paraqesin kërcënime ekzistenciale, si dikur Al-Kaida. Dhe opinioni publik i cili është lodhur nga konfliktet e përsëritura në Lindjen e Mesme refuzon ndërhyrjen e Shteteve të Bashkuara në rajon, përveç në rastin e një sulmi iranian kundër Izraelit.

Është e qartë se administrata e z.Trump e ka braktisur pothuajse rolin e mbrojtësit të vendeve të Gjirit kundër Iranit. Në janar, vrasja e gjeneralit iranian Ghassem Soleimani kishte më shumë për qëllim demonstrimin e qëndrueshmërisë së Uashingtonit përballë trazirave irakiane që e kërcënonin ambasadën amerikane në Bagdad. Deri atëherë, Shtetet e Bashkuara nuk kishin dashur të përfshiheshin në një operacion ushtarak anti-iranian, edhe pas sekuestrimit të anijeve të naftës nga pasdaranët (rojet e revolucionit) në Gji, shkatërrimit të një droni amerikan dhe sulmit ndaj rafinerive saudite të naftës. Po kështu, ketë ndryshim strategjik e tregon fakti që Uashingtoni i ka braktisur aleatët kurdë në verilindje të Sirisë dhe ka qëndruar pasiv ndaj ndërhyrjes ushtarake turke në rajon.

Shtetet e Bashkuar kanë hyrë në një fazë ‘jacksoniane’ të politikës së jashtme: ndërhyrjet e tyre të jashtme kanë për qëllim vetëm ruajtjen e sigurisë së brendshme dhe nuk parashohin angazhime afatgjata. Kjo rënie

e intensitetit të hegjemonisë amerikane detyron Arabinë Saudite dhe Iranin ta analizojnë situatën. Rijadi tani e di se mbështetja amerikane nuk është më e pakushtëzuar. Tani që sulmi ndaj rafinerive saudite nuk ka ndikuar fare në çmimin e arit të zi, Teherani e ka të qartë se e ka të kufizuar ndikimin në rajon, si dhe mundësinë e veprimeve qëllimkëqija. Sigurisht, situata në rajon mund të ndezet përsëri rreth çështjes së sigurisë të Izraelit. Mund të ketë gjithashtu raste sporadike të konfrontimeve midis Shteteve të Bashkuara dhe Iranit. Kjo do të kontribuojë në destabilizimin e rajonit, por jo me përmasa të një konflikti madhor me betejë të hapura midis forcave amerikane dhe iraniane.

Rendi rajonal që e përcaktonte Lindjen e Mesme në vitet 2010 tani është i organizuar sipas një logjike të re. Arabia Saudite po e rishikon embargon kundër Katarit, të cilin e kishte dekretuar në pranverën e vitit 2017 - gabimi më i madh që ishte bërë në politikën e jashtme brenda një gjenerate. Nga ana tjetër, Emiratet e Bashkuara Arabe po i shfuqizojnë angazhimet e tyre ushtarake ndaj Jemenit. Për t’i lehtësuar tensionet rajonale, Riadi dhe Abu Dhabi shprehin gatishmërinë për të biseduar drejtpërdrejt me Iranin. Por kjo nuk do të thotë se Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe do ta braktisin afërsinë e tyre me Izraelin, për arsye kryesisht të lidhura me sigurinë e tyre. Teknologjitë izraelite të mbrojtjes si dhe të inteligjencës, përfshirë teknologjinë kompjuterike, kanë shumë peshë në këtë martesë interes. Aftësia e shtetit hebraik për të goditur ushtarakisht (kudo) interesat e Iranit dhe të aleatëve të tij është një tjetër faktor që merret parasysh.

Arabia Saudite (partnerët e saj rajonal) dhe Irani i kanë kuptuar kufijtë e strategjisë shtrënguese në Gjir dhe natyrën iracionale të konfliktit latent të tyre në rajon. Këta akterë përballen tani diku tjetër me rivalitete gjeopolitike në rajonin lindor mesdhetar. Këtu formohen dy aleanca të reja. Nga njëra anë, Egjipti, Izraeli, Qiproja dhe Greqia: interesat e tyre të përbashkëta në shfrytëzimin e rezervave të gazit natyror offshore arsyetojnë praninë e tyre detare dhe bashkëpunimin në rritje ushtarak. Në anën tjetër, Katari, Turqia dhe qeveria e Libisë e vendosur në Tripoli. Në këtë konfigurim, Libia është arena e fundit ku mund të shënohet dhuna midis këtyre dy blloqeve. Ky vend i ndarë, në prag të një lufte civile në mes disa akterëve, është shndërruar në një zonë të anarkisë, ku mercenarët dhe dronët e huaj veprojnë në vijat e frontit dhe forcat e huaja e mbështesin hapur njërin kamp apo tjetrin. Në pikëpamje të ndryshme, Libia është ndoshta viktima kryesore e ripërcaktimit të vazhdueshëm të rivaliteteve gjeopolitike në Afrikën e Veriut dhe në Lindjen e Mesme.

Në këtë rimodelim, Rusia përfaqëson një rast të veçantë. I pranishëm në Siri, aktiv në Libi, ky vend vepron nga impulse kundër-revolucionare, por kjo nuk është pjesë e një strategjie globale. Moska i konsideron disa regjime autoritare para se gjithash si partner, që i shërbejnë interesave të saj në rrethana specifike.

Në këto raste, Rusia bën ndërhyrje ushtarake me kosto të ulta, por shumë efikase, për të cilat nevojiten baza të vogla dhe shpesh edhe partnerë privat. Operacionet e kompanisë ushtarake Wagner shtrihen nga Siria në Republikën Qendrore të Afrikës. Kjo kompani po korrë sukses aty ku kishte dështuar Blackwater Amerikan. Moska nuk ka vizion afatgjatë të rendit rajonal. Ajo i shfrytëzon konfliktet ekzistuese që i mundësojnë përfitime gjeopolitike me kosto të ulët. Pra, vizioni rus është taktik dhe jo strategjik.

Përveç Sudanit, të gjitha lëvizjet protestuese janë bllokuar. Kjo rikthen pyetjen e zakonshme: a do të ishin monarkitë zgjidhje ideale për stabilitetin politik? Kjo pyetje ishte shtruar qysh në fillim të viteve 2010 pas rënies së presidentit tunizian Ben Ali dhe të homologut të tij egjiptian Hosni Mubarak. Monarkitë do ta gëzonin një legjitimitet më të madh për shkak të rrënjëve të tyre të thella kulturore dhe shoqërore në popullatë. Gjithashtu do të ishin më të afta për ndërmjetësimin e konflikteve dhe për të udhëhequr vendin në rast krize, për shkak të gatishmërisë dhe fleksibilitetit të tyre si institucione politike që mund t’i kalojnë grindjet partizane.

Ndryshe nga mbretëritë dhe emiratet e Gjirit, ku nuk ka aktivitet politik (përveç në Kuvajt), në Marok dhe në Jordani, dy vende ku mbahen zgjedhjet parlamentare, prej kohësh avokohet në favor të monarkive në botën arabe. Pushteti aktiv mbretëror kombinohet me disa parti politike, disa prej të cilave deklarojnë opozitare, por megjithatë nuk e sfidojnë monarkinë. Sidoqoftë, gjatë viteve të fundit, mënyra e qeverisjes ka qenë gjithnjë e më e kontestuar në nivel kombëtar. Dhe as Rabati dhe as Amani nuk kanë treguar fleksibilitet dhe reaktivitet, si në të kaluarën, kur i zbusnin krizat, veçanërisht duke e zgjedhur bashkërisht një pjesë të opozitës.

Në anën tjetër, protestuesit e kuptuan se monarkia nuk duhet vërë në pyetje. Për sa kohë që ata përmbahen, regjimet e monarkive mund të përshtaten dhe t’i vazhdojnë zakonet e tyre të vjetra konservatore. Për ta përdorur një metaforë ekonomike, një produkt që gëzon monopol të tregut mund të mos ndryshojë kurrë, por nëse një produkt konkurrues shfaqet, ai duhet të evoluojë për të mbijetuar. Në këtë rend idesh, lëvizjet protestuese tani po i tejkalojnë kufijtë e autorizuar duke i përdhosur monarkitë. Kjo mund të rezultoj me kërkesa republikane. Sapo status quo-ja të bëhet e papërballueshme, çështja për këto mbretëri do të jetë si ta përdorin në mënyrën më të mirë legjitimitetin e tyre dhe burimet politike që do t’u mbeten për ta pamundësuar zgjidhjen republikane.

1 Banka Botërore, <https://data.worldbank.org>

2 «Arabs are losing faith in religious parties and leaders», Arab Barometer, 5 dhjetor 2019, www.arabbarometer.org

3 Lexo Alain Gresh, «En Égypte, la révolution à l'ombre des militaires», *Le Monde diplomatique*, gusht 2013.

4 «Égypte: les forces de sécurité ont recouru à une force meurtrière excessive», Human Rights Watch, New York, 19 gusht 2013.

5 Lexo Akram Belkaid, «L'affaire Kashoggi met Riyad sous pression», Horizons arabes, Les Blogs du Diplo, 15 tetor 2018, <https://blog.mondediplo.net>

6 Lexo Feurat Alani, «Les Irakiens contre la mainmise de l'Iran», *Le Monde diplomatique*, janar 2020.

7 Lexo Ibrahim Warde, «Singulière amitié entre Riyad et Washington», *Le Monde diplomatique*, dhjetor 2017.

PROTESTA DHE KRITIKA NGA BAMAKO DERI NË DAKAR

Prania franceze në Afrikë: Mjaft më!

Parrulla “Francë, shporru!” po përhapet në ish-kolonitë franceze, gjashtëdhjetë vjet pas pavarësimit të tyre. Protestuesit dhe intelektualët kërkojnë fundin e monedhës së frangut CFA ose ndërprerjen e operacionit ushtarak “Barkhane” që zhvillohet në Mali nga viti 2013. Një lëvizje e tillë protestuese e ka zënë Parisin në befasi.

NGA FANNY PIGEAUD*

Një gjel me ngjyrat e flamurit francez duke çukitë në një thes të mbushur me fara, ku thesi e ka formën e kontinentit afrikan. Kjo karikaturë ishte në të gjitha rrjetet sociale afrikane, në veçanti në vendet frankofone, në fund të vitit 2019. Sukses i saj simbolizon një valë kritikash të papara kundër Francës përsa i përket zonës së ndikimit ekskluziv të quajtur deri vonë ‘*pré carré*’.

Në të gjithë Afrikën Perëndimore, artikuj të shtypit, debate televizive, deklarata dhe mitingje janë bërë jehonë e kësaj rryme. Në fund të vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020, parrulla “*Poshtë Franca!*” mund të dëgjohet në rrugët e Bamako-së në Mali, ku qindra protestues kërkojnë largimin e trupave të operacionit “Barkhane”, të cilat luftojnë kundër lëvizjeve xhihadiste. Në të njëjtën kohë, studentët e shqyen një flamur francez në Niamey në Nigeri.

Përballë kësaj situatë, zyrtarët francezë, përfshirë vetë Presidenti Emmanuel Macron, denoncojnë një “*keqkuptim*”, madje edhe një “*fushatë dezinformimi*” të udhëhequr nga një fuqi konkurruese, duke e inkriminuar Rusinë, pa e emëruar. Është e vërtetë që Moska përfitoi nga kjo klimë e pafavorshme ndaj Parisit për ta marrë një pjesë të tregut të sigurisë në Republikën Qendro-afrikane në vitin 2018. Disa nga informacionet e përhapura janë të trilluara ose keqdashëse, si një foto-montazh i dhjetorit 2019, që sugjeronte (rrejshëm) se ushtria franceze i kishte furnizuar me motoçikleta xhihadistët në Mali. Por acarimi në rritje buron nga politika franceze në Afrikë. “*Është mbushur kupa. Është një revoltë, një refuzim të kontrollit të shtetit francez ndaj autoriteteve tona dhe rrjedhimisht ndaj ekonomisë sonë dhe popullit tonë*”, përmbledh në një video Mamadou Koulibaly, ekonomist dhe opozitar i Bregut të Fildishtë, ish-kryetar i Ku-vendit në vendin e tij.



Kritikët acarohen nga fakti se grupet e armatosura zgjerojnë aktivitetet e tyre me veprime vdekjepruese në Mali dhe në Burkina Faso. Një pjesë e popullsisë së Malit mendon që “Franca ndërhyt vetëm për interesa të fshehta ekonomike dhe strategjike duke marrë pjesë në destabilizimin e vendit për ta legjitimuar praninë e saj; por mbi të gjitha ajo është kthyer në anën e ish-rebelëve tuareg”

Edhe pse nuk është risi, denoncimi i imperializmit francez dhe “*Francafrikës*” del nga qarqet intelektuale dhe militante për t’u bartur në rrugë. Ky zhvillim shpjegohet me “*pjekurinë e një brezi që nuk ndihet i përfshirë në atë që Franca mund të ketë përfaqësuar për gjeneratat e kaluara, një brezi që gjithnjë e më pak shikon në drejtim të Francës*”, shpjegon shkrimtari Boubacar Boris Diop, i cili është bashkëautor me Aminata Dramane Traoré, ish-ministre e Malisë dhe aktiviste anti-globalizim, të një pamfleti me titullin elokuent: *La Gloire des imposteurs (Lavdia e mashtruesve)* (Philippe Rey, 2014). Rrjetet sociale, si gjithmonë, luajnë një rol forcues dhe përshpejtues.

“NJË LUFTË PËR BURIMET E MINIERAVE”

Ndër ankesat drejtuar ish-pushtetit kolonial figuron “bashkëpunimi monetar” me katërmëdhjetë vendet afrikane që nga viti 1960. Duke përdorur një kritikë

deri tani konfidenciale, aktivistët e shoqateve, ekonomistët dhe kundërshtarët tani haptazi bëjnë fushatë për fundin e monedhës së trashëguar nga kolonizimi, e cila aktualisht ndahet në dy zona: franga CFA e Afrikës Perëndimore dhe franga CFA e Afrikës Qendrore.

E lidhur me euron, monedha mbetet nën tutelën e Francës, e cila garanton konvertibilitetin e saj. Sipas kundërshtareve, franga CFA e pengon zhvillimin e vendeve duke i privuar fillimisht nga sovraniteti i tyre. Ata avokojnë për krijimin e monedhave rajonale ose kombëtare. Në Senegal, për shembull, Fronti për një revolucion anti-imperialist popullor dhe panafrican (Frapp) vepron me një parrullë të qartë: “*Francë, shporru!*”

Ky mobilizim e detyroi z.Macron, i cili thoshte edhe në vitin 2017 se franga CFA “*nuk ishte temë për Francën*”, ta ndryshojë rrënjësisht diskursin e tij. Në dhjetor 2019, gjatë një vizite në Abidjan, ai paralajmëroi për habinë e

të gjithëve një reformë të frangës CFA të Afrikës Perëndimore. Tetë shtetet në fjalë nuk do të detyrohen t’i plasojnë 50% të devizave të tyre në thesarin francez. Megjithatë, rreth pesëdhjetë intelektualë afrikane denoncojnë vazhdimin e “*lidhjeve të subordinimit monetar*”, në veçanti mbajtjen e paritetit fiks me euron.

Me rritjen e numrit të atentateve në Sahel, është shfaqur një tjetër temë polemikash që mobilizon publikun e gjerë: prania ushtarake franceze në Afrikë. Që nga viti 1960, Franca ka baza të përhershme dhe të përkohshme në ish-kolonitë e saj. Ushtria tringjyrëshe është përdorur shpesh për t’i sjellë në pushtet ose për t’i mbrojtur udhëheqësit aleatë, sikurse Omar Bongo në Gabon në vitin 1990 ose z.Idriss Déby Itno në Çad në vitin 2008. Në vitin 2011, ndërhyrja e Francës për t’i mundësuar z. Alassane Ouattara ta merr presidencën në Bregun e Fildishtë, pas një krize vdekjeprurëse pas zgjedhjeve, u perceptua si larje hesapësh ndaj kreut të shtetit në largim Laurent Gbagbo. Në qytetin Duala në Kamerun, qindra shoferë të mototaksive patën shprehur mosmiratimin e tyre ndaj “*përzierjes franceze*”.

Që nga viti 2013 dhe operacioni “*Serval*” i cili i dha fund ofansivës xhihadiste në Bamako, kritikët acarohen nga fakti se grupet e armatosura zgjerojnë aktivitetet e tyre me veprime vdekjepruese në Mali dhe në Burkina Faso. Një pjesë e popullsisë së Malit mendon që “*Franca ndërhyt vetëm për interesa të fshehta ekonomike dhe strategjike duke marrë pjesë në destabilizimin e*

*Gazetare. Autore, me Ndongo Samba Sylla, të *L’Arme invisible de la Françafrique. Une histoire du franc CFA*, La Découverte, Paris, 2018.

vendit për ta legjitimuar praninë e saj; por mbi të gjitha ajo është kthyer në anën e ish-rebelëve tuareg”, analizon Boubacar Haidara, studiues i asociuar në laboratorin ‘Les Afriques dans le monde’ (LAM), në Institutin e Studimeve Politike në Bordeaux. “Më habit fakti që Francezët nuk kanë qenë në gjendje t’i shkatërrojnë këto banda terroriste. (...) A e dëshirojnë vërtetë atë, apo kanë ndonjë agjendë tjetër?”, thoshte Ministri i Mbrojtjes në Burkina, Chérif Sy, në një intervistë në të përjavshmen e Afrikës së Jugut Mail & Guardian, në qershor 2019.

Aleancat e ushtrisë franceze nxisin mosbesim, si ajo me Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Azawad (MNLA). Ky grup i armatosur bashkë me islamistët e Ansar Dine kishin nisur sulmet e para kundër kampeve ushtarake në veri të Malit më 2012. Pak më vonë, ushtria franceze i bëri partner në luftën kundër xhihadistëve. Franca iu “dhuroj” qytetin e Kidalit, të cilin e kishte çliruar në vitin 2013, sipas fjalëve të Nicolas Normand, ish-ambasador francez në Bamako. Këto dyshime u përforcuan nga fakti se ishte z.Macron ai i cili ishte i pari që njoftoi në nëntor 2019 se kreu i qeverisë maliane do ta vizitonte qytetin së shpejti, kur qyteti ende ishte i kontrolluar nga MNLA dhe aleatët e saj. “Për disa malezë, kjo është dëshmia që ai e mban çelësin e problemit Kidal”, komenton Haidara. “Malezët shohin vetëm joefikasitetin – të vërtetë apo të supozuar - të forcave të huaja, pa e marrë çdoherë parasysh vështirësinë e madhe në trajtimin e problemit të sigurisë, faktorët e të cilit janë shumë të gërshetuar”, shtoi ai, duke theksuar se mosbesim ngjallin edhe forcat e tjera të armatosura të huaja, përfshirë ato të Kombeve të Bashkuara.

Deri tani e heshtur, bota e kulturës po fillon të përfshihet. Në një letër të hapur drejtuar z.Macron, Cheick Oumar Sis-soko, kineast dhe ish-Ministër i kulturës i Malit kritikoi “shprehjet kolonialiste”, një “disponim shpirtëror i përbërë nga kompleksi i superioritetit dhe nga përbuzja sovranë ndaj popujve të dominuar, të shfrytëzuar nga kolonizimi francez, disponim i ngulitur thellë, i kultivuar dhe i mirëmbajtur (...) brenda klasës udhëheqëse franceze”. Këngëtari malez Salif Keita shkaktoi zemërimin e francezëve kur tha se nuk ka “xhihadistë në Afrikë, por vetëm mercenarë të paguar nga Franca”. Ai e akuzoi Presidentin e Malit, z.Ibrahim Boubacar Keita, duke thënë se “vazhdimisht po i nënshtrohet vocërrakut Emanuel Macron, një çunit”. Muzikanti i cili i kishte bërë këto deklarata derisa ishte jashtë vendit u prit në mënyrë triumfale kur u kthi në Bamako. “Presidenti francez nuk ishte



Tanimë, Presidentët e Afrikës frankofone, disa prej të cilëve janë në detyrë për disa dekada me radhë, gjinden në mes kërkesës popullore për rritje të emancipimit dhe nga ana tjetër presionit të autoriteteve franceze që janë të përkushtuar në interesat e tyre ekonomike dhe të sigurisë. Disa prej tyre e dinë se nuk do të ishin në pushtet pa Parisin zyrtar

thirrur kurrë “çun”. Madje të gjithë e miratuan këtë emërtim!” thotë Boubacar Boris Diop.

Të tejkaluar nga këto zhvillime, autoritetet franceze po i shumëfishojnë demantet. «Franca nuk është këtu me synime neokoloniale, imperialiste, apo qëllime ekonomike. Jemi këtu për sigurinë kolektive të rajonit dhe për sigurinë tonë», tha z.Macron më 4 dhjetor 2019. «Franca nuk ka asnjë interes në Mali. Nuk mbron asnjë kalkulum ekonomik ose politik», kishte theksuar më parë Presidenti François Hollande në vitin 2013. Por këto deklarata nuk kanë peshë përballë komenteve, të përsëritura rregullisht në rrjetet sociale nga Z Hama Ag Mahmoud, një ish-anëtar i MNLA dhe ish-Ministër i Malit: «Ekziston një luftë për burimet e minierave».

Z.Macron vështirë fsheh zemërimin e tij. Në fund të vitit 2019, ai u ankua në lidhje me “sjelljet e paqarta” të “liderëve politikë” afrikanë për “rrymat anti-franceze». Duke iu drejtuar udhëheqësve të vendeve të G5 Sahel (Burkina Faso, Mali, Mauritania, Niger, Çad), ai dha një ultimatum: “Pres të sqarohen dhe t’i zyrtarizojnë kërkesat e tyre në lidhje me Francën dhe bashkësinë ndërkombëtare», para se të shtoj: «Kam nevojë që të deklarojnë politikisht para opinionit të tyre publik». Këto komente u interpretuan menjëherë si thirrje për t’i heshtur kritikët. “Ne jemi në demokraci” iu përgjigj Roch Marc Christian Kaboré, President i Burkinas përmes mediave. «Nuk mund t’i ndalojmë njerëzit të kenë mendimin e tyre».

Përballë kritikëve, autoritetet franceze duken gjithnjë më të brishta nga fakti se përveç Rusisë, shtetet e fuqishme, përfshirë Kina dhe Turqia, po kërkojnë ta zgjerojnë ndikimin e tyre tregtar dhe ushtarak në kontinent, duke shumëfishuar partneritetet bilaterale. Kështu që Parisi po shkundet nga të gjitha anët, në një kohë kur po zvogëlohen mjetet e tij financiare.

PRESIDENTËT ME DUART E LIDHURA

«Çfarë duhet të bëjnë francezët? Ta pranojnë heqjen dorë nga dekolonizimi. Po e shtyejnë kënaqësinë deri në fund - ose dhimbjen, në fakt. Duhet pranuar verdikti i historisë. ‘Ik para se të bëhet vonë’, i kishte thënë Salif Keita Ibrahim Boubacar Keita-s. Kjo vlen edhe për Francën, edhe pse e dimë se nuk është aq e thjeshtë», thekson Boubacar Boris Diop. Është edhe më e komplikuar për shkak se «kupës së mbushur të të gjithëve», pasi që një gjë nuk ndryshon, thotë shkrimtari: «pavarësisht se a janë në pushtet apo në opozitë, me disa përjashtime, politikanët kanë frikë të flasin keq për Francën».

Tanimë, Presidentët e Afrikës frankofone, disa prej të cilëve janë në detyrë për disa dekada me radhë, gjinden në mes kërkesës popullore për rritje të emancipimit dhe nga ana tjetër presionit të autoriteteve franceze që janë të përkushtuar në interesat e tyre ekonomike dhe të sigurisë. Disa prej tyre e dinë se nuk do të ishin në pushtet pa Parisin zyrtar. Të gjithë i kanë parasysh hakmarrjet që

i pësuan paraardhësit e tyre që kundërshtuan Francën, sikurse Ahmed Sékou Touré, viktimë e përpjekjeve të shumta për destabilizim, apo Thomas Sankara, i cili u largua me grusht-shtet dhe u vra në vitin 1987.

Më 2 dhjetor 2019, autoritetet e fildishtë parapëlqyen ta dëbonin një zvicëro-kameruneze, znj.Nathalie Yamb, e cila jetonte në Abidjan dhe ishte anëtare e partisë opozitare të fildishtë ‘Liri dhe Demokraci për Republikën’, nën akuzën për «aktivitete të papërpunshme me interesin kombëtar». Në fund të tetorit, në samitin ruso-afrikan në Soçi, znj.Yamb kishte akuzuar Francën se e konsideron Afrikën “si pronë të saj” dhe i kishte quajtur udhëheqësit e zonës frangë “servilë të Francës”. Vitet e fundit, vetëm udhëheqësit e Kamerunit kanë përdorur levën “anti-Francë” si pjesë e një përballje me Parisin për të ardhmen politike të vendit e tyre: për disa muaj, mediat e afërta me presidencën kanë zhvilluar një diskurs të ashpër kundër autoriteteve franceze.

Edhe në anën e opozitarëve, të rrallë janë ata që e kritikojnë imperializmin francez për t’i ringjallur idealet e zhvillimit kombëtar, siç e kishin bërë më parë malezi Modibo Keita ose burkinabeu Sankara. Në ndërkohë, qeveria franceze nuk po e ndryshon kursin: më 2 shkurt 2020, duke injoruar shumë aktorë dhe vëzhgues që thoshin se “siguria mbi gjitha” nuk do të mjafton për ta stabilizuar Sahel-in, qeveria franceze njoftoi përf forcimin e njësiteve në operacionin «Barkhane» prej 4500 në 5,100 sosh.

KUR MENAXHIMI I POPULLSISË E ZËVENDËSON KUJDESIN SHËNDETËSOR

Psikiatri, koha e jelekëve shtrëngues

Braktisja e vizionit humanist të çmendurisë dhe të kujdesit, vizion i periudhës së pasluftës, ka përshpejtuar krizën në psikiatri. U kthi koha e shtrengimeve dhe izolimit, me shkelje serioze gjithnjë e më të shpeshta të të drejtave të pacientëve. Staf i spitalor kërkon mjete për t'i dhënë fund abuzimit.

NGA PATRICK COUPECHOUX*



Zakonisht janë dy dyer përballë njëra tjetrës për ta nxënë «në sendviç» pacientin kokëfortë ose të dhunshëm. Shtrati është i fiksuar në dysheme; ndonjëherë ka lavaman, ndonjëherë nuk ka; ndonjëherë ka tualete, ndonjëherë nuk ka, vetëm “një kovë higjienike pa kapak nga e cila del një erë e rëndë urine dhe jashtëqitje”; sidoqoftë, kur pacienti është i lidhur, ai shpesh e kryen nevojën ndër veti. Kohë pas kohe, mund të ketë marrëveshje të vogla, si në rastin e kësaj paciente të re të pranishme në repart për një vit, “gjymtyrat e të cilës janë të shtrënguara me katër lidhësa, por lidhësa e njërit krah është rregulluar në mënyrë që ajo të mund ta lëshojë legenin në tokë pa ndihmën e askujt”. Zakonisht nuk ka asnjë pullë për thirrje: pacienti detyrohet të bërtasë që të dëgjohet, ose nëse nuk është i lidhur, të “trokasë në derë madje derisa të lëndohet”.

Ai ushqehet shpesh i ulur në dysheme, me shtratin në vend të tryezës dhe përballë tij qëndrojnë dy kujdestarë, në këmbë. Ndonjëherë është lakuriq, për shkak të frikës, siç thuhet, nga “rreziku vetëvrasës”; përndryshe qëndron ditë e natë në pizhame. Me pizhamet e spitalit, sepse nuk ka qasje në gjërat e tij personale. Ndodh që nuk dihet kur është internuar: «Personeli mjekësor i cili punon për një kohë të gjatë thotë se pacienti ka qenë gjithmonë aty». Vizitat i ka të ndaluara. Në disa institucione, vëzhgimi me video, mikroфона dhe kamera termike janë duke u testuar në dhomat e izolimit. Tani e tutje, asgjë nuk do t'i shpëton tjetrit, i cili është ulur para ekranit.

Nuk është trillim. Këto fakte janë marrur nga tre raporte të znj. Adeline Hazan, mbikëqyrëse e vendeve të ndalimit të lirisë. Ajo publikoi tre “rekomandime urgjente”, në lidhje me qendrën e psikoterapisë në Ain (Bourg-en-Bresse), në mars 2016; në qendrën spitalore universitare në Saint-Etienne (Loire), në mars 2018; dhe në qendrën spitalore Rouvray, në Sotteville-lès-Rouen (Seine-Maritime), në nëntor 2019. Këto fakte dramatike - znj. Hazan flet për “shkelje serioze të të drejtave të pacientëve” - tregojnë se para së gjithash të sëmuret vuajnë më së shumti nga kriza e psikiatrisë. Sapo folëm për shtrengimet dhe izolimin; mund të vazhdojmë duke përmendur të çmendurit e rrugëve - 30% e të pastrehëve (SDF) paraqesin patologji të rënda mendore - apo të çmendurit që jetojnë në gjendje të mjerueshme nëpër burgje - 35 deri 40% të të burgosurve konsiderohen si shumë të sëmurë mendor. Mund të përmendim gjithashtu braktisjen që përjetojnë ata, qoftë në familje, të cilët nuk dinë më çfarë të bëjnë, apo në spitale, ku mungesa e mjeteve dhe obsesioni për siguri i privojnë nga aktivitetet, ku si pasojë jetojnë një jetë të kotë, të mërzi dhe të “kronicitetit”, domethënë një mbyllje psikike.

«Ç'RREGULLIME» QË DUHEN ASGJËSUAR

Çuditërisht, mediat e përmendin pak këtë aspekt mizor dhe demaskues të krizës. Ata preferojnë të flasin për muajt e pritjes për ta caktuar një takim në një Qendër mjeko-psikologjike

(CMP), vendi bazik i pranimit të pacientëve; ata flasin për pamundësinë për pacientët që të zgjedhin mjekun e tyre, ose për mungesën e shtretërve - pa i analizuar shumë arsyt - dhe në fund thonë se sektori e ka fajin. Në realitet, kriza vjen nga braktisja graduale e psikiatrisë të sektorit, e cila duhet kuptuar jo si një organizim administrativ, por si një filozofi e cila e ka revolucionuar historinë e psikiatrisë.

Për të kuptuar, fillojmë nga çmenduria. Psikiatria e sektorit e konsideron të çmendurin si një qenie njerëzore në tërësi. Psikoterapisti italian i psikozës Gaetano Benedetti shkroi: «*Ne mund të bëjmë gabime, por pacienti do të na falë nëse e respektojmë mënyrën e tij të të qenurit njeri*». Nëse çmenduria është “një mënyrë e të qenurit njeri”, ajo ka të bëjë me individin në tërësinë e tij, emocionet, ankthet, dëshirat, dhimbjet, historinë e tij personale, gjithçka që e bën atë një qenie unike. Pra, çmenduria nuk është një sëmundje si çdo tjetër: është një patologji e personit. I përket njerëzimit; prandaj duhet të mirëpritet në botën njerëzore.

Për këtë qëllim, duhet të shkëputemi nga shekuj të historisë ku ka qenë e përjashtuar, e dëbuar, e persekutuar, e djegur, e mbyllur. Këtu shihet guximi i themeluesve të këtij sektori gjatë çlirimit; një guxim i ngjashëm me atë të Philippe Pinel, i cili gjatë Revolucionit liroi nga zinxhirët e tyre të çmendurit e spitalit Bicêtre dhe themeloi psikiatrinë franceze. Sipas tij tek i çmenduri gjithmonë mbetet një pjesë e arsyes të cilës duhet t'i drejtohem. Prandaj propozon atë që e quan “*trajtimin moral*”, paraardhës i psikoterapisë.

Kështu, kujdesi lidhet me vizionin tonë për çmendurinë. I çmenduri ka nevojë për ndihmë për të jetuar në shoqërinë e njerëzve. Nuk mjafton të rrëzohen muret e spitalëve, nuk mjaftojnë “shërbimet ambullantore” - siç propozohet në një raport parlamentar të ri - ku mungojnë zyret e pranimit dhe personeli i mirëtrajnuar, ku për t'i qetësuar pacientët ka vetëm injeksione, pacienta të cilët rrezikohen të braktisen dhe të përfundojnë në rrugë ose në burg.

Kujdesi është një marrëdhënie dhe asgjë tjetër. Ilaçi është vetëm ndihmë. Për ta mirëpritur një burrë, një grua në vuajtje të madhe, është dashur të shpikët një psikiatri të re që funksiononte brenda dhe me qytetin: shoqata, kryetarë komunes dhe zyrtarë të zgjedhur, punonjës socialë dhe klube sportive, gjyqtarë, zjarrfikës dhe policë, organizata banesore me kosto të moderuar (HLM), qendra kulturore, familje... gjithçka që e bën shoqërinë. Kjo psikiatri nuk ishte më e mbyllur në bindjet e saj mjekësore. U shkëput nga spitalocentrizmi.

Gjithçka duhet të mendohet dhe të zbatohet në funksion të pacientit: “*Në fakt pacienti është drejtori i spitalit*”, thoshte psikiatri Philippe Koechlin. Për pacientin duhet të trajnohet personeli mjekësor, të krijohen ekipe të afta për ta siguruar vazhdimësinë e kujdesit brenda

dhe jashtë spitalit, për të ushtruar psikiatri të përshtatur, për të krijuar vende të pranimit të shpërndara në qytete, afër vendbanimeve... Në fund të fundit, pasi që shkon përtej çmendurisë dhe ka të bëjë me të gjitha marrëdhëniet shoqërore, “*kujdesi është humanizëm*”, formulë kjo e filozofës Cynthia Fleury.

Çfarë ndodhi që një reflektim i tillë novator, i krijuar në vitet 1960-1970, të mos i rezistonte kohës? Ndër arsyt që mund të përmenden është mungesa e angazhimit të shumicës së psikiatërve, të cilët e kuptuan si kërcënim për statusin e tyre; pastaj kundërshtimi i psikiatrisë universitare, e mbështetur në pozicione biologjike; burokratizimi, nën ndikimin e menaxherëve, me mungesën mizore të mjeteve, mbylljen e mijëra shtretërve spitalorë, ku nga mungesa e investimeve, munguan zyret e pranimit për t'i zëvendësuar.

Ekzistojnë edhe shkaqe më të përgjithshme, që kanë të bëjnë me vizionin e çmendurisë. Shtytja neoliberalë, e cila nënkupton individualizmin, konkurrencën, konsumerizmin, frikën e shumëfishitë, parimin e kujdesit dhe masave shtrenguese - kaq shumë “vlëra” në kundërshtim me vlerat e sektorit. Është dashur të veprohet me të gjitha, siç mundej - sa mundej.

Vizioni mbizotërues sot ka tre fytyra. Fytyra e një shkencëtari: sëmundja mendore është një sëmundje si çdo tjetër. Është vetëm produkt i një mosfunksionimi të trurit, të sistemit nervor ose të sistemit gjenetik dhe ky pohim nuk kërkon diskutim. Psikiatria, pohonin të parët e psikiatrisë së sektorit, është në kryqëzimin e disa fushave: mjekësisë, psikologjisë, sociologjisë, antropologjisë, politikës. Tani mbetet vetëm një zë, dhe vazhdimisht përsëritet që nuk ka si shkenca, më efikase, më pragmatike sesa ideologjitë e vjetra si psikanaliza e cila duhet të marginalizohet.

Kjo rezulton në sendërtimin e pacientit. Psikiatri, i cili është shndërruar në ekspert, nuk e ka më përballë tij një qenie njerëzore të veçantë, madje as një pacient, por një sëmundje. Nuk përballet më me dikë që vuan i cili duhet prouvar të kuptohet, por me një seri “ç'rregullimesh” të cilat duhet të asgjësohen - termi, që ka të bëjë me sjelljen, dhe rrjedhimisht me funksionimin e rendit social, nuk është i rastësishëm. Logjikisht, ilaçi është në qendër të kujdesit, i cili tani quhet “tretman”. Dhe i gëzohen kësaj kompanitë e mëdha farmaceutike të cilat po e mbajnë timonin.

Megjithatë shkenca nuk është në gjendje të jep një shpjegim gjithëpërfshirës të çmendurisë. Edhe psikiatria amerikane e pranon. Këtë e dëshmon një artikull i fundit i studiuesve Caleb Gardner dhe Arthur Kleinman në revistën e famshme amerikane, *New England Journal of Medicine*. “*Zbulimet e reja në gjenetikë dhe neuroshkencë janë pasionante*”, shkruajnë ata, “por janë ende larg ofrimit të mbështetjes reale për njerëzit e vërtetë nëpër spitale, klinika dhe këshillimore. Duke pasur parasysh kompleksitetin e qenies njerëzore, ky fakt nuk na befason”. Dhe, për të qenë absolutisht të qartë, ata shtojnë: “*Psikiatria biologjike deri më tani nuk ka arritur të prodhojë një model të plotë teorik të një çrregullimi psikiatrik madhor*”. Në vitin 2013, versioni i fundit i biblës së psikiatrisë amerikane, *Doracaku diagnostik dhe statistikor i çrregullimeve mendore* (DSM-5), zëvendësoi versionin e vitit 2000, me shpresë se do të figuroheshin aty treguesit e skizofrenisë. Më kot. Nga njëra anë, shkenca supozohet të shpjegojë gjithçka; nga ana tjetër, ajo nuk zgjidh asgjë, pra e ushqen sjelljen arkaike ndaj çmendurisë dhe veçanërisht frikën.

Pas fytyrës së shkencëtarit vjen fytyra menaxheriale. Për dekada të tëra, sëmundja mendore konsiderohet si një barrë financiare: nuk “riparohet” një punëtor i prekur nga skizofrenia Atëherë pse të harxhohen kaq shumë para për

të, kur vështirë do të ketë “kthim të investimit”? Pra psikiatria është riorganizuar me kalimin e viteve. Për shembull, shumë shpesh pranimi i pacientëve bëhet sipas patologjive - ndërsa më parë sektori i pranonte njerëzit, pavarësisht nga gjendja e tyre dhe pastaj iu bënte diagnozën. Po kështu, sektorët janë fuzionuar për t'i “bërë bashkë” burimet, për të krijuar “territore” domosdoshmërisht më të populluara dhe ... më larg nga të sëmuret. Spitalit i është besuar menaxhimi i krizës së pacientit, kjo metodë çoi në politikën e platëformës rrotulluese: shtrimi në spital, dalja nga spitali gjithnjë e më shpejtë, kthimi pak më vonë dhe kështu me radhë ... “Menaxhimi” i të sëmurëve kronikë gjithnjë e më shumë i është besuar shoqatave. Shpresohet në mbështetjen e mjekëve familjar.

Drejtorët e institucioneve nuk janë më psikiatra, por menaxhera, “*patrona*”, sipas fjalëve të z.Nicolas Sarkozy gjatë një fjalimi në një spital në Antony, në vitin 2008, kur ai ishte Presidenti i Republikës. Si mund t'i ipet kujdesi pacientëve, në kuptimin humanist të termit, kur institucioni nuk merret me kujdes, por i kushtohet vetëm menaxhimit financiar? Deliriumi menaxherial i ngulfat ekipet mjekësore, të cilët janë të lodhura nga shënimi i të dhënave pa e kuptuar dobinë e tyre. Kohë e humbur larg pacientëve.

FRIKA ARKAIKE NGA I ÇMENDURI

Dhe në fund, kemi fytyrën e sigurisë. Rrezikshmëria rishfaqet. Në fjalimin e tij në Antony, z.Sarkozy këmbënguli që i sëmuri mendtor është i rrezikshëm. “*Detyra ime*”, ju kishte thënë ai personelit mjekësor të pranishëm, “*detyra jonë është gjithashtu ta mbrojmë shoqërinë dhe qytetarët tanë*” - pasardhësit e tij nuk e kanë kundërshtuar. Pasojat ishin të tmerrshme. Nga njëra anë, 70 milion euro janë ç'bllokuar për të vendosur sisteme të sigurisë, për të punësuar roje dhe për të krijuar...dhoma të reja të izolimit. Akoma më keq, të sëmuret mendorë konsiderohen tani si njerëz prej të cileve duhet të ruhen, të cilët mund të shfaqin “*në çdo moment dhunë shpërthyesë dhe të paparashikueshme*”, sipas fjalëve të ish-Presidentit. Kaq mjaftonte për ta ringjallur frikën arkaike ndaj të “çmendurit”.

Tani, kur dikush pranohet në spital, pasi të jetë qetësuar kriza - me injeksione - personeli mjekësor e pyet atë se cili është “*plani i tij i jetës*”. Më pas do t'i kërkojnë të përpiqet që të “shërohet” duke zbatuar këtë projekt. Nëse nuk ia del dhe ky është rasti për shumicën e pacientëve, veçanërisht ata që vuajnë nga një patologji serioze, nëse është “*joadekuat*”, siç thonë menaxherët kur flasin për këta pacienta, ai do të bashkohet me pacientët që duhen mbikëqyruar. Nuk kemi të bëjmë me kujdes, por me menaxhim të popullsisë.

Shkencërizëm dhe psikiatri farmaceutike, braktisje dhe sendërtim i pacientit, delirium menaxherial, mjerim material, fund i reflektimit mbi çmendurinë ... gjithçka e humb kuptimin. Personeli mjekësor ndjehet i pafuqishëm dhe nuk e kupton se për çka punon; praktikantët nuk e zgjedhin më psikiatrinë; të tjerët preferojnë të ushtrojnë mjekësi liberale. Procesi i banalizimit të së keqes që çon në barbarizëm dhe tmerrret e denoncuar nga znj. Hazan po ndodhin para syve tanë.

Është kriza e botës sonë. Nuk është fjala vetëm për të çmendurit. Statusi i tyre, si gjithmonë, është një tregues i gjendjes së thellë në shoqëri. Negacioni i njeriut po vepron dhe po e hap humnerën para nesh. Siç ka shkruar filozofi Henri Maldiney, “*njeriu gjithnjë e më shumë qëndron larg nga psikiatria, por pak e kuptojnë, se njeriu gjithnjë e më shumë qëndron larg nga njeriu*”.

* Gazetare, autore e veprës «Un homme comme vous. Essai sur l'humanité de la folie», Seuil, Paris, 2014.

ISA QOSJA, REGJISOR

Nuk di të mendoj “komercialisht”

Mbi filmin që duhet të shërbejë si emancipim shpirtëror i njeriut. Konceptin “njeriu dhe natyra” si “huazim”, apo përvjedhje të vetes. Ndërlidhjen e kinematografisë me letërsinë, idealitetin përmes simbolikës dhe ritualin neorealist si shprehje e gjendjes së papërbalueshme sociale.

INTERVISTOI:
AG APOLLONI

- Për arsye triviale, do të doja ta nisnim këtë intervistë me një thënie të një regjisorit të madh italian. Meqenëse, thuajse gjithmonë ju kam takuar në lokalin që mban emrin Fellini, po e vazhdojmë traditën, duke mos u larguar prej tij. Fellini ka thënë: “Unë gjithmonë e bëj të njëjtin film. S’mund ta ndaj njerin nga tjetri.” Edhe mes filmave tuaj shoh një lidhje të fortë që vjen si rezultat i simbolikës vizuale. A e keni pranuar si aksiomatike thënien e regjisorit italian?

Isa Qosja: Ah, Fellini! “I mirë, i mençur, gjenial. Edhe filmat i ka ashtu siç është vetë”. Kështu thoshte Andrei Tarkovsky për të. Po. Fellini ka jetuar me personazhe të filmave të vet, është ushqyer si ata, ka vepruar si ata. Jeta e tij projektohet në filmat e tij. Ai ka xhiruar pa ndërprerë dhe prandaj i dukej se ishte duke i vazhduar ngjarjet e një filmi në tjetrin. Pra, sikur është duke e bërë të njëjtin film. Kështu, edhe pse ka shumë vite, muaj e ditë në kohën e tij reale, ai kohën filmike e shndërron në një ditë dhe në një natë që ndërrohen mes tyre, a thua se janë shumë net e shumë ditë e në të vërtetë është vetëm një ditë dhe një natë. Dhe duhet t’i besojmë Fellini-t. Nuk mund të mos i besohet çdo thënieje të tij, sepse me magjinë e filmit e shndriti vendin e vet, kinemanë italiane, evropiane dhe artin kinematografik në përgjithësi. Ndërsa, një arsye pse filmat e mi ngjajnë sikur janë një rrëfim i gjatë, apo një film i gjatë, është më tepër rezultat i asaj që thoni ju: simbolika vizuale. Të gjithë filmat i kam xhiruar pothuajse në të njëjtin ambient, me kompozicion të ngjashëm të pamjeve dhe në bazë të kësaj na duket që koha ndalon në kodrinat kosovare. Por nëse koha ndalon për ambientin, karakteret ndryshojnë dhe marrin me vete fatin e vet nëpër kohë të ndryshme. Më duket se nuk mund t’i ik idesë se fatin e njeriut e përcakton vendi, natyra. Dhe natyrisht që unë e dua natyrën edhe për faktin e kontrastit në film: për të ardhur në shprehje marrëdhënia mes bukurisë dhe neverisë. Më duket që ne mbajmë qëndrim të caktuar në vend të caktuar, apo se fati ynë lidhet me një ambient të caktuar. Shpesh kemi dëgjuar të thuhet: ky vend e ka ujin e egër. Eh, unë pra mendoj që ne vetë nuk kemi mundur e as nuk mund të jemi farkëtues të fatit tonë. Nëpër vite ishte dikush që e caktonte fatin

tonë dhe këtë e trajtoj në të gjithë filmat. Unë mendoj që të katër filmat e mi janë një omnibus me titullin “Na ishte njëherë në Kosovë”. Koncepti “njeriu dhe natyra”, që tek unë është kthyer në obsesion, është në të njëjtën kohë edhe “huazimi”, apo përvjedhja e vetes sime në filmat e mi.

- Pra, ka të drejtë Hitchcock-u kur thotë se vjedhja nga vetvetja quhet stil?


Isa Qosja: Po. Hitchcock-u ka jetuar edhe privatisht, edhe artistikisht duke i befasuar të tjerët dhe veten. Ai nuk mund të jetonte pa këtë ritëm. Kur thoshte p.sh. që “Psycho” është komedi, atëherë të gjithë shtangeshin dhe ai shpjegonte që ky është humori i tij, humor që i ndihmon që filmi të mos jetë i neveritshëm. Por jo vetëm Hitchcock-u, edhe shumë të tjerë i kanë “huazuar” shumë veti të vetat në veprat e tyre. Zaten kështu funksionon arti, posaçërisht filmi.

- Në një libër autobiografik të regjisorit Sidney Lumet kam lexuar një mendim shumë inkurajues për regjisorët e rinj. Aty ai thotë: “bëjeni filmin e parë, çfarëdo qoftë ai! Të gjithë do t’ju mirëkuptojnë, se është i pari.” Filmi juaj i parë, “Proka”, nuk pati nevojë për mirëkuptim ngushëllues, pasi rezultoi i suksesshëm jo vetëm në Kosovë, por edhe në festivale ndërkombëtare, siç ishte Festivali i Kanës, ku në kategorinë e të rinjve fitoi disa çmime. Si erdhi “Proka” te ju dhe sa e vështirë ka qenë ta sillni atë në ekran?

Isa Qosja: Sapo e kisha përfunduar Akademinë e Filmit dhe kisha tre vjet që punoja në një emision të gjatë dokumentaro-artistik në RTP (Radio Televizionin e Prishtinës). Nga Kosovafilmi më bënë ftesë për të qenë pjesë e këtij institucioni, konkretisht përgjegjës i prodhimit, por me prioritet të regjisorës. Unë u inkudrova në këtë institucion dhe aty i gjeta të depozituara ca sinopse, tretmanë, skenarë. Një prej tyre ishte edhe “Proka”, që ngjante më shumë me tretman sesa me skenar. Tema ishte ajo që mua përherë edhe si student me ka interesuar: pra një lloj ballafaqimi i individit me mjedisin. Individit që dallon nga të tjerët. Pasi ky tretman i bazuar në novelën e Filip Papajanit, u shndërrua në skenar, atëherë ishte kërkesa ime që filmi të pasurohej në përmbajtje përmes vendit të xhirimit dhe dimensionit ideo-estetik. Kështu bëra dhe doli një tregim ikonografik në kuptimin vizual. Ky tregim e gjeti admiruesin e vet në skenën ndërkombëtare dhe nuk mbeti pa u vërejtur ideja, qëllimi dhe estetika, edhe pse ishte filmi im i parë. Pra, nuk është për t’u çuditur që filmi im i parë nuk pati nevojë për mirëkuptim ngushëllues, siç thotë Lumet. Kemi raste të shumta kur filmi i parë i regjisorit ka qenë edhe më i miri. Mendoj se te filmi i parë investohet më shumë përkushtim dhe singleritet.

- Çka ju tërhoqi te “Proka”?

Isa Qosja: “Proka” është një rrëfim baladik për njeriun e vogël që ia mësyn kësaj bote, pa e ditur se është plotësisht vetëm. Vetëdijeshohet sapo nis stuhia e persekutimeve.



Isa Qosja

“MARRËZIA DHE MELANKOLIA JANË SHPESHHERË NJË, SEPSE VETËM NË MELANKOLI NJERIU BËN ‘MARRËZIRA’ TË MENÇURA, SHPIRTËRORE, NJERËZORE. ËSHTË KJO GJUHA TË CILËN E KUPTOJ MË SË MIRI DHE NATYRISHT, NËSE KËTË DUAM TA MANIFESTOJMË NË NJË MËNYRË MË TË QARTË, ATËHERË PROTESTOJMË GATI NË FORMË TË AUTIZMIT”

Persekutesit e tij janë bjerrakohës, ndryshe nga ai që dëshiron ta farkëtojë fatin e vet me mund të vetin. Kështu, vijnë te dy konfliktet: social dhe shpirtëror. Konflikti shpirtëror i Prokës është një zanore e humbur. Kjo fabul më ka inspiruar për këtë arsye dhe për faktin e instalimit të fuqisë së natyrës në anën e njeriut të vogël. Pra, në anën e Prokës hallmadh e të pashpresë. Kjo e ka motivuar edhe këngën që gjendet në film: *nuk kam dert nga Perëndia/ ku më shpie, ku më qet/ këtë botë kur e nisa/ nuk e dita që jam vetë*.

RITUALI NEOREALIST

- Të kthehemi pak para “Prokës”. Si dhe kur vendosët ta studionit regjinë? Ishte profesioni i aktorit që ju drejtoi kah regia, apo kishte ndonjë film a regjisor në veçanti që e pëlqenit dhe që dëshironit t’i ngjasonit?

Isa Qosja: Do të thosha që përcaktuese për aktrim dhe për regi ka qenë vendlindja ime e bukur, magjike. Bukuria gjithmonë kërkon që të arkivohet diku: në kokë, në zemër, në ndjenja, apo diku ku e sheh sa herë të duash. Pra, unë doja që pamjet e vendlindjes t’i ndaja me dikë. Dhe natyrisht ishte filmi ai që e kishte këtë mundësi. Në fillim s’e dija mënyrën, por pas gjimnazit e kisha plotësisht të qartë. Kështu që, fillimisht e kreu aktrimin këtu në Prishtinë, ku edhe qëndrova për dhjetë vjet duke luajtur role të ndryshme. Për disa nga këto role u vlerësova edhe me çmime. Pas dhjetë vitesh m’u shpenzua kureshtja për paraqitjen në skenë. Ndërkohë shihja filma dhe e shihja hapësirën time, ambientin tim, veten time në përmbajtje të ndryshme. Shihja edhe situata që nuk më pëlqenin, që kishin gabime. Dua t’i shoh ëndrrat e mia në ekran thashë dhe e regjistrova Regjinë e Filmit në Beograd. Më

tutje gjërat sa vinin e qartësoheshin në kuptimin e motivimit dhe ambicies për ta parë “veten” në ekranin magjik.

- Te “Proka” vërehet një gërshe-tim i dy llojeve të filmave: western dhe neorealist. Çfarë ju pëlqente më shumë te këto lloje të filmave dhe si erdhët te ky kombinim?

Isa Qosja: Gjithmonë kam pasur përshtypjen se ne shqiptarët jetën e kemi ritual. Posaçërisht pjesa rurale e vendit tonë, atje ku unë xhiroj kryesisht. Duke menduar që ky ritual i të jetuarit tonë është i lidhur ngushtë me natyrën: tokën, ujin, drurin etj, kam dashur që rituali të jetë i besueshëm, të xhirohet ashtu siç është dhe siç zhvillohet, në eksterier dhe enterier. Kam përshtypjen se rituali vjen si pasojë e dëshirave të njerëzve, e pamundësisë së tyre për të pasur atë që e dëshironin, pra si pasojë e ekzistencës. Njerëzit e kanë krijuar ritualin për të thirrur në ndihmë fatin dhe natyrën. Natyrisht që rituali shpesh i përjashton planet e afërta, sepse korrespondon me natyrën, lëvizjen, gjestin. Neorealizmi e pranon ritualin si shprehje të gjendjes së papërbalueshme sociale. Neorealizmi i shqiptarëve është i ngjashëm me neorealizmin e italianëve, edhe pse flitet për vende dhe kohë të ndryshme. Pra, neorealizmi ishte, është dhe mbetet gjithmonë i pranishëm në këtë vend dhe në punën time, ndërsa *westerni* është zhanri që e adhuroja në rini dhe natyrisht objektivi i *westernit* është më i përshtatshmi në këto hapësira ku unë frymoj artistikisht.

- Filmi i dytë, “Rojet e mjegullës”, solli të njëjtin aktor në rol kryesor, por tashmë si intelektual. Pavarësisht dallimeve mentale dhe ambientale, dy protagonistët e dy filmave i bashkon fati i keq: përndjekja. Pse ky inkuizicion (nga shoqëria dhe pushteti) është kaq i pranishëm në filmat tuaj të paralufës?

Isa Qosja: Përndjekja. Ishte fati ynë nëpër vite, dekada. Por e keqja asnjëherë nuk vjen vetëm dhe vetëm nga një anë. E keqja jonë nganjëherë vjen edhe nga vetë ne dhe në mënyrë permanente nga të tjerët. Nëse ne me vlerat tona dallojmë nga mjedisi ku jetojmë, atëherë përndiqemi nga po i njëjti mjedis, e nëse dallojmë nga ata që bashkëpunojnë me pushtetin, atëherë përndiqemi nga pushtetet, regjimet. Kjo ishte e modifikuar në dy mënyra, në atë të mjedisit patriarkal dhe në atë të pushtetit të rafinuar, apo thënë më qartë, të pushtetit represiv. Do të thosha që nga këto histori nuk kemi mësuar shumë dhe prandaj jemi sot kështu siç jemi.

- Jo vetëm te personazhi Trashja dhe jo vetëm te “Rojet e mjegullës”, në krijimtarinë tuaj ka gjithmonë diçka ekzotike për publikun kosovar. Ky element ekzotik mund të jetë edhe referencë nostalgjike për vendlindjen tuaj. Çfarë kujtoni nga vendlindja, përveç atyre që i keni paraqitur në film? Si ka qenë fëmijëria dhe rinia juaj?

Isa Qosja: Fëmijëria – ekzotike, por e vështirë, rinia – e mundimshme. Gjithë fëmijërinë e kam kaluar në Vuthaj. E vetmja qytezë që kam parë

dhe përjetuar në 14 vitet e fëmijërisë sime është Gucia. E atje kam përjetuar dimra të acartë dhe të gjatë, verë të lodhshme me punët e fushës, pranverë kushtuar shkollës dhe shkollimit dhe vjeshtë ekzotike. Plot ngjyra, pemë dhe peshkim. Ardhja në Prishtinë ishte një thyerje e dyfishtë: në moshë dhe në përjetim. Prishtina në fillim më gëlltiste, ishte e paqartë, kërcënuese. Nuk gjendesha mirë, sepse nuk isha shumë social, nuk e njihja hapësirën, por edhe këpucët më shtrëngonin dhe më dukej sikur nuk mund të ecja normalisht. E shihja në ëndërr vendlindjen dhe të nesërmen hipja në një tren që villte tym të dendur të zi. Udhëtoja me të deri në Pejë dhe prej aty vazhdoja në këmbë për dy ditë deri në Vuthaj. Flas për stinën e dimrit kur ishte pushimi i gjysmëvetorit. Pra, rinia ime në Prishtinë nuk ishte si e moshatarëve të tjerë, meqë e kërkoja diellin e Vuthajve, hënën, ujin, drunjtë, njerëzit. Atëherë isha vuthjan në Prishtinë, tani jam prishtinas në Vuthaj. Eh, kështu është kjo. Vendlindje të bëhet vendi ku punon e jo vendi ku ke lindur.

- Pra, mund të thuhet se ardhja nga Vuthaj në Prishtinë ka ndikuar që ambientet rurale t’i paraqisni sipas modelit të vendlindjes, ndërsa ambientet urbane sipas modelit të kryeqytetit, apo qyteteve që i frekuentonit dhe i preferonit.

Isa Qosja: Dua të them diçka për vendlindjen dhe nostalgjinë. Nostalgjia është gjendje e brendshme, shpirtërore. Është kujtesë dhe mall. Tipike për njeriun që ëndërron vendin e vet dhe mënyrën e jetesës atje ku është farkëtuar. Kur erdha në Prishtinë isha katërmëdhjetë vjeç, me mentalitet vuthjan. Ismajl Dumoshi, shok i vëllait tim, më mori dhe më çoi në një byrektore. Më porositi byrek dhe jogurt. Në Guci, prej nga vija unë, nuk kishte diçka të tillë atëherë. Kur hanim pite në shtëpi, hanim të gjithë nga një enë. Kush mbërrinte, sa mbërrinte. Këtu, kur e pashë që unë e kisha përpara “piten” time vetëm për mua, u turpërova aq shumë sa që u ngrita dhe u largova me vrap. Pasdite udhëtova për Pejë me trenin e “zi” dhe natën e vazhdova rrugën për në Vuthaj. Ishte ky një moment nostalgjie që as sot nuk di ta shpjegoj dot. Kur i përfundova studimet dhe nisa të bëja filma, ishte plotësisht e natyrshme që vendxhirimet t’i kërkoja sipas modelit të vendlindjes sime, e cila aq shumë më “gërryente” sa isha i ri në Prishtinë. Ajo më inspironte për ta vendosur ngjarjen filmike pikërisht si kontrast në mes të së bukurisë dhe të së keqes. Kam përshtypjen se drama bëhet më e rëndë nëse ndodh në ambient të bukur e jo në ambient të zymtë. Kështu mendoj dhe kështu realizohem në film.

- Pas luftës, realizuat filmin “Kukumi”, ku marrëzia e personazhit nuk arrin ta zhdukë melankolinë e peizazhit. Që në skenën e parë ne e kuptojmë që Kukumi dhe kavalli janë marrëzia dhe mërzia, apo melankolia, që do ta përcjellin filmin deri në fund. Nga ju erdhi ideja për ta alternuar elegjinë me protestën?

Isa Qosja: Filmi kur nuk është dokument, është ëndërr thotë Bergman-i. “Kukumi” është ëndërra ime.

Nëse “Rojet e mjegullës” e kam punuar me kokë, “Kukumini” e kam punuar me zemër. I dua dhe më duhen këto personazhe të “Kukumi”. Shpesh në jetë doja të isha Kukum. Siç thoni ju, këtu janë marrëzirat melankolike, qofshin ato në karaktere apo në hapësirë. Marrëzia dhe melankolia janë shpeshherë një, sepse vetëm në melankoli njeriu bën “marrëzira” të mençura, shpirtërore, njerëzore. Është kjo gjuha të cilën e kuptoj më së miri dhe natyrisht, nëse këtë duam ta manifestojmë në një mënyrë më të qartë, atëherë protestojmë gati në formë të autizmit. Dhe të gjithë ne, jemi nga pak autistë në jetë. Unë doja që miksin mes natyrës dhe gjendjes shpirtërore ta mpiks në melankoli të peizazhit. Pos njerëzve, doja ta përjetoja një hapësirë të pikëlluar. Si duket arrita ta bëja këtë, sepse reagimet e njerëzve ishin “ku-ku”.

- Pas tragjedisë së çmendjes nga lufta, ju trajtuat një tragjedi tjetër që vinte si pasojë e luftës: fatin e gruas së përdhunuar në ambient patriarkal, ku përdhunimi nuk konsiderohet tragjedi, por turp. Çfarë ju tërhoqi më shumë gjatë realizimit të këtij filmi: dokumentimi i rasteve, apo sfidimi i mentalitetit patriarkal?

Isa Qosja: Unë do të thosha që mua edhe kësaj radhe më mori peng mentaliteti. Gjykimi dhe fajësimi i atyre grave të pafajshme, të cilat ishin të lënduara rëndë, shpirtërisht dhe fizikisht. Ato e kishin përjetuar ferrin shpirtëror dhe ne edhe njëherë i kalonim përmes atij ferri duke i gjykuar si të fajshme. Praktikisht i dhunonim përsëri. Sado që filmat që përkojnë me kohë të caktuar sjellin me vete edhe dokumentin e identifikimit të kohës dhe vendit, unë doja që këtë fakt ta “neglizhoj” në favor të trajtimit të mentalitetit patriarkal. Dhe ky mentalitet është shpeshherë fajësia jonë në pritë. Kur vepron kanuni e jo zemra, atëherë vendimet janë të pashpirta dhe më së paku ligjore.

- Në krijimtarinë tuaj është e dukshme lidhja e letërsisë me film-in: tre filmat tuaj të parë bazohen në vepra letrare. Cili është raport-i juaj me letërsinë dhe si e shihni raportin letërsi – kinematografi?

Isa Qosja: Si art gjithëpërfshirës, ose universal, filmi ka mbështetje intelektuale në letërsi. Natyrisht që kjo është një mundësi më shumë për krijuesin dhe kjo mundësi duhet shfrytëzuar. Dy koka mendojnë më mirë se një. Jemi dëshmitarë të kryeveprave kinematografike të bazuara në letërsi. “Doktor Zhivago” është kryevepër dhe dëshmi. “Pritja e madhe” apo “Brigjet e Orkanit”, ose “Fluturimi mbi follenë e qyqes”... Janë shumë kryevepra kinematografike të bazuara në letërsi. Jam i prirë që këtu ta përfshij edhe film-in biografik, sepse edhe biografitë e emrave të mëdhenj të botës së artit janë një gjini letrare që ofron shumë. Mendojeni filmin “Amadeus”!



ARTI SINTETIK

- Dihet që filmi është art sintetik. Ju në cilat arte të tjera fokusoheni më shumë kur bëni film?

Isa Qosja: Në letërsi dhe në pikturë. Letërsia na jep qartësinë intelektuale, ndërsa piktura kompozicionin, ngjyrat, ritmin.

- Filmat tuaj nuk synojnë sukses komercial. Çfarë lloj suksesi synoni me to?

Isa Qosja: Edhe po të donim, filmi te ne, në Ballkan dhe në Europë, çfarëdo qoftë ai, nuk mund të marrë vëmendje komerciale. Atëherë, pse të mendohet për këtë mundësi, gjegjësisht pamundësi komerciale, kur jemi të paragjykuar si humbës. Unë, edhe po të kisha një mundësi të tillë, nuk do ta aplikoj. Nuk di të mendoj “komercialisht”. Nëse duhet menduar, atëherë është më logjike të mendojmë për vlerat që komunikojnë me mjedisin kulturor dhe diskriminimin pozitiv.

- Cilët janë filmat që ju kanë formuar?

Isa Qosja: Janë shumë: “Andrei Rublev”, “Amarkord”, “Kohët moderne”, “Qytetari Kejn”, në radhë të parë. Por ka edhe një mori filmash të tjerë nga zhanre të ndryshme që i doja, i shikoja disa herë dhe i lakmoja si model për motivimin tim. “Pritja e madhe” e Lean-it, apo “Shejn” që është një *western* i paharruar, “Lorenci i Arabisë”, “Rruga”, “Roko dhe vëllezërit e tij”, “Vjedhësi i biçikletave”, “Rashomoni”, “Vula e shtatë”, “Fani dhe Aleksandri”, “Dyluftimi te O. K. Koral”...

- Çfarë ju impresionon më shumë sot nga kinematografia botërore?

Isa Qosja: Kushtet e punës dhe vlerësimi i filmit si art suprem.

- “Kinemaja është çështje e asaj çfarë shihet në frema dhe çfarë mbetet jashtë”, thotë Scorsese. Cili është relacioni i filmit me atë që mbetet jashtë (pra relacioni i filmit me jetën)?

Isa Qosja: Varet ku xhirohet dhe varet sa jemi të prirë për ta lënë jetën jashtë fremave. Ne, ne këtu

dhe rrethina ballkanike, lëmë shumë jetë jashtë fremave. Arsytet janë të shumta, por edhe pasojat evidente. Ne ende nuk jemi në gjendje ta bëjmë një film organik dhe kjo është arsyeja që shumëçka nga jeta mbetet jashtë. Unë do të thosha se niveli intelektual është përcaktuesi i parë i filmit organik. Pastaj vijnë në pah vlerat dhe vetitë e tjera. Por nuk duhet ta humbim shpresën. Bergman-i, kur tashmë ishte emër në orbitën kinematografike, deklaroi për Tarkovsky-n: “Kur e kam njohur veprën e Tarkovsky-t, ajo ka ndikuar në mua si rrufe. Jam ndier si një njeri para pragut të një dhome, çelësat e së cilës deri atëherë nuk m’i kishin dhënë. Në atë dhomë unë përherë kam dashur të hyj, por nuk kam ditur se si, ndërsa Tarkovsky është ndier komod atje brenda. Pra, ai ishte njeriu i cili dinte të shprehej ashtu siç unë gjithnjë dëshiroja, por nuk dija. Kjo nuk më ka dëshpëruar, por më ka trimëruar dhe inspiruar”.

- Filmat tuaj janë konsideruar art që shqetëson politikën. A është kjo arsyeja dhe shkaku i përdorimit të një simbolike të theksuar, apo thjesht çdo film duhet të ketë simbolikë?

Isa Qosja: Dikur, kur ishim të okupuar, simbolika ishte metodë për t’u mbrojtur nga ata që duhej ta “lexonin” filmin. Pra, ne përpiqeshim që para “autoriteteve” ta komentim këtë simbolikë si shprehje filmike, jo si qëllim politik. Kështu edhe i shpëtonim censurës. Megjithatë, mendoj që arti filmik është më i bukur kur ka simbolikë. Jo në të gjithë filmat mbijeton simbolika, por ata që shprehen në mënyrë poetike, arrijnë idealitetin përmes simbolikës. “Sakrifica” e Tarkovsky-t a do të ishte film i tillë pa simbolikën brenda?! Apo “Vula e shtatë” e Bergman-it? Çka mendoni ju për letërsinë: a duhet vepra letrare të ketë simbolikë?! Besoj që po. Si filmi, ashtu edhe letërsia. Ato udhëtojnë në të njëjtën kupë sa i përket simbolikës.

- Si e shihni kinematografinë tonë dikur dhe sot?

Isa Qosja: Plotësisht ndryshe. Dikur ishte më e politizuar dhe më politike. Me mundësi të madhe për censurë dhe autocensurë. Me klishe në kuptimin teknik. Më e vlerësuar dhe më e qëllimtë në synime të porositura. Më obligative. Sot autorët janë më të pavarur, mundësitë ideore dhe teknike janë pa limite, ndërsa distribuimi apo menaxhimi i filmit në skenat e rëndësishme ndërkombëtare është më i mundur.

- Tani jeni duke e xhiruar një film të ri. Si ndiheni kur e filloni një film dhe si pasi e mbaroni atë?

Isa Qosja: Kur e filloj një film jam plot kureshtje, energji dhe ritëm. Për një vit apo edhe më shumë nuk e ndal ritmin e të vrapuarit pas

vendxhirimeve, bisedave, konsultimeve, provave, fotografimit dhe organizimit. Është fazë që më mobilizon, më jep infuzion për fazën e xhirimeve. Për përfundimin do të shërbehesha me thënien e Bergman-it: kur e përfundoj një film, jam si njeriu që del nga spitali ku ka qëndruar një vit. E saktë. Kështu më duket edhe mua. Megjithatë është një frymëmarrje e thellë e liritimit nga ngufatja e dilemave të shumta gjatë xhirimit, por edhe një ankth për atë se çka do të dalë.

- Me çfarë kriteresh e zgjidhni temën për ta shndërruar në film?

Isa Qosja: Me kriterin e ndjenjës për ta rrëfyer një tregim në mënyrë ideo-estetike. Nëse arti është provë, atëherë dua të sfidohem me përmbajtje të cilat di më së miri t’i rrëfej, t’i përjetoj, t’i “përkthej” në ndjenja dhe në pamje. Patjetër që tregimi im duhet të shërbejë si emancipim shpirtëror i njeriut. Dua të flas edhe për veten time, të shfaq qëndrimin tim për një çështje, problem apo qëllim. Pra, nëse një përmbajtje (skenar, vepër letrare) i ka këto provokime, nëse këto i shoh qartë përmes pamjeve, para se të filloj me xhirimin, atëherë vendos të punoj më tutje.

- Filmat tuaj kanë zgjuar reagime të shumta, ashtu siç kanë marrë vlerësime të larta nga kritikët dhe juritë e ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Cili është qëndrimi juaj ndaj kritikës dhe cili mendoni se duhet të jetë funksioni i saj?

Isa Qosja: E vlerësoj syrin tjetër, zërin tjetër, gjykimin tjetër për një film. Filmi nuk është vetëm çka duam ne, por çka duan edhe të tjerët. Filmi duhet të nxisë dialog, mohim apo admirim, pajtim apo mospajtim. Kritika është e para që e fillon këtë fushatë artistike. Kritika shpesh i rizbulon disa vlera, apo të meta të filmit. Gjithnjë flas për njohësit e filmit. Ju e keni parë që shpeshherë në festivalet prestigjioze, kritika i prin shpalljes së fituesve. Kjo do të thotë se leximin e parë dhe më profesional e bën kritika. Për mua kritika është sovranë në funksionin e saj, kur atë e bëjnë ata që e kanë të njohur alfabetin e filmit.

- Si profesor i regjisë, çfarë do t’u sugjeroni regjisorëve të rinj?

Isa Qosja: Kështu e përshekruan Bergman-i aktoren Bibi Andersson: “Ajo është e bukur, e ngrohtë dhe e çuditshme. E kthyer kah realiteti. Gjithçka ka rëndësi për të. Edhe objektet që shihen, edhe ato përtej. Ajo dëshiron të komunikojë me shikuesin dhe t’ia bëjë përjetimin të jashtëzakonshëm”. Pra ky është filmi sipas saj dhe sipas Bergman-it. Bëjeni që të duket kështu edhe regjia e filmit tuaj!

(Botuar në revistën “Symbol”, nr. 16, 2019)

LE MONDE diplomatique

REDAKSIA E BOTIMIT NË SHQIP

Botues: Instituti “Musine Kokalari” - Prishtinë (Kosovë)

Drejtor: Belgzim Kamberi

Kryeredaktor: Ardit Rada

Redaksia: Leart Kola, Shkodran Hoti

Përkthimi: Lemanë Muriqi

Layout design: Dritan Lleshi

Tirazhi: 1000

Email: botadiplomatie@gmail.com

Botimi i “Le Monde Diplomatique” në gjuhën shqipe mbështetet nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë- SDC

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Kosovo

Édité par la SA Le Monde diplomatique.
Actionnaires: Société éditrice du Monde,
Association Gunter Holzmann,
Les Amis du Monde diplomatique
1, avenue Stephen-Pichon, 75013 Paris
Tél.: 01-53-94-96-01. Télécopieur: 01-53-94-96-26
Courriel: secretariat@monde-diplomatique.fr
Site Internet: www.monde-diplomatique.fr

Directoire: Serge HALIMI,
président, directeur de la publication
Autres membres: Vincent CARON, Bruno LOMBARD,
Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Directrice des relations et des éditions internationales:
Anne-Cécile ROBERT

Secrétaire générale:
Anne CALLAIT-CHAVANEL

Directeur de la rédaction: Serge HALIMI
Rédacteur en chef: Benoît BRÉVILLE
Rédacteurs en chef adjoints:
Martine BULARD, Renaud LAMBERT
Cheffe d’édition: Mona CHOLLET
Rédaction: Akram BELKAÏD, Philippe DESCAMPS,
Evelyn PIELLER, Hélène RICHARD,
Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Cartographie: Cécile MARIN
Site Internet: Guillaume BAROU, Thibault HENNETON

Conception artistique:
Maria HERARDI, Boris SÉMÉNIAKO
(avec la collaboration
de Delphine LACROIX pour l’iconographie)
Rédacteur documentaliste: Olivier PRONET
Mise en pages et photographie:
Jérôme GRILLIÈRE, Patrick PUECH-WILHEM
Correction: Xavier MONTHEARD, Sarah ZHIRI

Directeur de la gestion: Bruno LOMBARD
Directeur commercial,
chargé de la diffusion numérique: Vincent CARON
Contrôle de gestion: Zaïa SAHALI
Secrétariat: Yuliya DAROUKA (9621),
Sophie DURAND-NGÔ, attachée communication
et développement (9674), Eleonora FALETTI (9601)
Courriel: prenom.nom@monde-diplomatique.fr
Fondateur: Hubert BEUVE-MÉRY. Anciens directeurs:
François HONTI, Claude JULIEN, Ignacio RAMONET

Publicité: Hélène FAVERIE (01-57-28-38-03)

Diffusion, mercatique: Brigitte BILLIARD, Saveria COLOSIMO-MORIN, Sophie GERBAUD, Sabine GUDE, Carole MERCERON, Christiane MONTILLET

Relations marchands de journaux (numéro vert):
0805-050-147

Service relations abonnés
● Depuis la France: 03-21-13-04-32 (non surtaxé)
www.monde-diplomatique.fr

● Depuis l’étranger: (33) 3-21-13-04-32

Reproduction interdite de tous articles,
sauf accord avec l’administration

© ADAGP, Paris, 2019,
pour les œuvres de ses adhérents

Prix de l’abonnement annuel à l’édition imprimée:
France métropolitaine: 59 €

Autres destinations: www.monde-diplomatique.fr/abo

FAQE 2-3
Një Brexit për asgjë?, **NGA SERGE HALIMI**
/ Pasojat e pritshme të një virusi të papritur,
NGA ARDIT RADA / I rrëzuar, por jo i mposhtur,
NGA BESNIK PULA

FAQE 4-5
Kurti, një rënie false anti-imperialiste,
NGA ZGJIM HYSANI / Ekologjia si mjet kundër
pandemive, **NGA SONIA SHAH**

FAQE 6-7
Shteti, tregu dhe e fundit krizë e tillë,
NGA ARTAN SADIKU

FAQE 8-9
Autokrati serb që përkëdhelet Nga Brukseli,
NGA JEAN-ARNAULT DÉRENS
DHE LAURENT GESLIN / Mos u dashuro me
pushtetin as Nga karantina, **NGA LEART KOLA**

FAQE 10
E djathta latino-amerikane në qorrsoak,
NGA RENAUD LAMBERT

FAQE 11-12
Klithmat kundër Bernie Sanders,
NGA JULIE HOLLAR / Fushata anti-Sanders
e mediave mainstream

FAQE 13
Faktet e rreme rreth xhihazizmit
NGA LAURENT BONELLI DHE
FABIEN CARRIÉ

FAQE 14-15
Izrael-Palestinë, një plan luftem,
NGA ALAIN GRESH

FAQE 16-17
Prej Algjerisë në Sudan, përgjigjet ndaj
“pranverës arabe”
NGA HICHAM ALAOUI

FAQE 18
Prania franceze në Afrikë: Mjaft mël,
NGA FANNY PIGEAUD

FAQE 20
Psikiatri, koha e jelekëve shtrëngues,
NGA PATRICK COUCHEUX

FAQE 21-22
Nuk di të mendoj “komercialisht”,
NGA AG APOLLONI